



STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

RAPORTI VJETOR 2025

STRUKTURA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJJE

Hyrje.....	6
Problematikat që duhen adresuar.....	11
Rekomandimet e Bashkimit European.....	12
Rekomandimet e Kuvendit për vitin 2025	17
Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave	22

SITUATA E KRIMINALITETIT

Situata e kriminalitetit.....	26
Krimi i organizuar	26
Trafiku i narkotikëve.....	27
Vrasjet.....	28
Trafiku i armëve.....	29
Emigrimi i paligjshëm.....	29
Mashtrimi përmes mikrokredive.....	30
Kontrabanda e cigareve.....	30
Pastrimi i parave.....	31
Matja e riskut	33
Korrupsioni	36
Korrupsioni i të zgjedhurve vendorë.....	38
Matja e riskut	39

ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT

Analiza krahasimore e efektivitetit 2025.....	41
Procedime me kallëzime dhe referime nga individë dhe institucione.....	41
Efektiviteti në hetim.....	42
Masa e sigurimit për personat e regjistruar.....	43
Volumi i punës në mbylljen e hetimeve.....	45
Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të veprave penale.....	49
Efektiviteti në gjykim.....	53

ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2025

Volumi i punës në hetim.....	54
Volumi i punës në gjykim	58
Ekzekutimi i vendimeve penale 2025.....	59
Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta.....	61
Bërthama Komanduese.....	74
Spektori i Ekspertizës.....	75
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit.....	77

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës gjatë vitit 2025.....	78
Kompetenca e Institucionit të ish- Komisionerëve Publikë.....	80
Koordinatori për marrëdhënien me mediat dhe e drejta e informimit	82
Dokumentacioni i klasifikuar dhe i paklasifikuar.....	86
Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve.....	87
Spektori i Raportimeve pranë BE, gjatë vitit 2025.....	95
Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH).....	97
Treguesit e buxhetit për vitin 2025 dhe plani i shpenzimeve për vitin 2026 Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.....	101

TABELA E AKRONIMEVE

AAPSK	– Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara
AKSHI	– Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit
AKSIK	– Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
ASPA	– Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AIF	– Agjencia e Inteligjencës Financiare
BKH	– Byroja Kombëtare e Hetimit
BE	– Bashkimi European
CEPOL	– Akademia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit (ILEA – Budapest)
CISA	– Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Infrastrukturës
DPD	– Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DTI	– Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
DVP	– Drejtoria Vendore e Policisë
DIA (EUROPOL)	– Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes
EU4FAST	– Mbështetja e BE-së për forcimin e luftës kundër trafikimit dhe kontrabandës së migrantëve në Ballkanin Perëndimor
EU4FOCAL	– Lufta kundër krimit të organizuar në Shqipëri përmes hetimeve penale dhe financiare
EU4LEA	– BE për Zbatimin e Ligjit në Shqipëri
Eurojust	– Agjencia e Bashkimit European për Bashkëpunimin në Drejtësi Penale
Europol	– Qendra Evropiane për Krimin e Rëndë dhe të Organizuar
FATF	– Task Forca e Veprimit Financiar
FBI	– Byroja Federale e Hetimeve
GJAKKO	– Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GJKKO	– Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
ICITAP	– Programi Ndërkombëtar i Trajnimit për Hetime Penale
ICRG	– Udhëzuesi Ndërkombëtar i Riskut të Vendit
ILEA – Budapest	– Akademia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit në Budapest
ILDKPKI	– Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
IPA 2019	– Lufta kundër Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor 2019
Interpol	– Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
ISSH	– Instituti i Sigurimeve Shoqërore
JIT	– Ekipet e Përbashkëta të Hetimeve
KBLKPP	– Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave
MATRA	– Program Bashkëpunimi i Ambasadave Evropiane
MONEYVAL	– Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
OFL	– Operacioni Forca e Ligjit
OPDAT	– Zhvillimi i Zyrave Prokuroriale Jashtë Vendit, Ndihmë dhe Trajnim
OPGJ	– Oficer i Policisë Gjyqësore
PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
PP/FT	– Pastrimi i Parave / Financimi i Terrorizmit
Prokuroria e Posaçme	– Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
PSHSH	– Policia e Shtetit Shqiptar
SHISH	– Shërbimi Informativ i Shtetit
SPAK	– Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPH	– Skuadrat e Përbashkëta Hetimore
TIK	– Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
WBCJ	– Drejtësia Penale në Ballkanin Perëndimor

HYRJE

Në përmbushje të detyrimeve për raportimin vjetor, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) paraqet raportin për vitin 2025. Përgatitja e tij bazohet në nenin 148/dh, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹, në nenin 15/2, shkronja “d”, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, si dhe në nenet 103, 104 dhe 105, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky raport evidenton arritjet dhe sfidat me të cilat është përballur institucioni, problematikat të cilat duhen adresuar, zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE), të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër korrupsionit dhe kriminalitetit. Ai përfshin gjithashtu, analizën krahasimore të efektivitetit në hetim dhe gjykim, situatën e kriminalitetit në vend dhe analizën e volumit të punës të SPAK për vitin 2025.

Në përmbushje të rolit të saj, SPAK ka marrë vlerësime pozitive nga institucione vendase dhe ndërkombëtare. Raporti mbi Shtetin e së Drejtës i Komisionit Evropian për vitin 2025, thekson: (...) SPAK gëzon një nivel të lartë të besimit publik (...) ² dhe se (...) është arritur përparim i prekshëm nga SPAK drejt ndërtimit të një rekordi të fortë në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë dhe është përmirësuar përdorimi i hetimeve financiare dhe konfiskimeve të pasurive (...) ³.

Po kështu, Progres Raporti i Komisionit Evropian, i publikuar më 4 nëntor 2025, nënvizon: (...) SPAK konsolidoi më tej rezultatet e saj pozitive në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe bëri përparim të prekshëm drejt krijimit të një bilanci të qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit (...) ⁴. Sa i takon luftës kundër krimit të organizuar thuhet se: (...) Kapaciteti dhe efektiviteti i SPAK për të goditur grupet e krimit të organizuar janë rritur dhe përdorimi i hetimeve financiare është përmirësuar (...) ⁵.

SPAK ka forcuar besueshmërinë dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë Eurojust, Interpol, Europol, SHBA-në, autoritetet homologe rajonale dhe të Amerikës Jugore, çka

¹ Prokuroria e Posaçme është organ kushtetues i pavarur i cili ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë për veprat penale të parashikuara në nenin 75/a, të Kodit të Procedurës Penale.

² Po aty, faqe 8.

³ Komisioni Evropian (2025). *Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti mbi Shtetin e së Drejtës. Kapitulli i Shtetit mbi situatën e sundimit të ligjit në Shqipëri 2025. Shoqëruar me Komunikatën për Situatën mbi Shtetin e së Drejtës në Bashkimin Evropian*. Marrë nga: https://commission.europa.eu/document/download/3732ae59-5ab4-48a6-a3e6-0ef9aa593863_en?filename=2025+Rule+of+Law+Report+-+Country, fq. 9.

⁴ Komisioni Evropian (2025). *Dokument i Punës i Stafit të Komisionit: Raporti i Shqipërisë 2024. Shoqëruar me Komunikatën për Politikën e Zgjerimit të BE-së*. Marrë nga https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf, faqe 5-6.

⁵ Po aty, faqe 8.

reflektohet në rritjen e aktivitetit ndërkombëtar të Prokurorisë së Posaçme. Krahasuar me vitin paraardhës, në vitin 2025, kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit u rritën me 35.7% (nga 70 në 95), prej të cilave 63 apo 66.3% e tyre u ekzekutuan brenda vitit raportues.

Gjatë vitit 2025, SPAK ka vijuar zbatimin e strategjisë institucionale në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe pastrimit të parave, duke miratuar dokumente strategjike si: Strategjinë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, Strategjinë e Komunikimit 2025-2028, si dhe akte nënligjore si: Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave të Përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Gjithashtu, janë hartuar dhe priten të përfundojnë në vitin 2026 akte nënligjore si: Udhëzimi për qarkullimin e brendshëm të dosjeve, Protokollin për komunikimin gjatë krizave, Udhëzimi mbi masat për financimin e terrorizmit sipas rekomandimeve të MONEYVAL, si dhe Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale.

SPAK ka vijuar të ketë në vëmendje, krahas hetimit penal edhe hetimin pasuror dhe financiar. Në këtë kontekst, është forcuar Sektori i Hetimit Financiar përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore kryesisht në hetimet financiare dhe pasurore me veprime komplekse brenda dhe jashtë vendit ku përfshihen edhe hetimet që përfshijnë kriptovaluta. Gjatë vitit 2025, vlera totale e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara është rreth 45.4 milionë euro, prej të cilave rreth 43.49 milionë euro, është vlera e aseteve të sekuestruara (rreth 96% e totalit) dhe rreth 1.91 milionë euro përfaqësojnë vlerën e aseteve të konfiskuara (rreth 4% e totalit). Në vlerën e aseteve të sekuestruara përfshihet dhe sekuestrimi i kriptovalutave të llojit TETHER, USDT, me vlerë ekuivalente prej 14.5 milionë dollarë ose rreth 12.4 milionë euro (vendimi nr.583, date 04.09.2025).

Vlera e pasurive të sekuestruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar është rreth 42.4 milionë euro, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara për këtë kategori veprash penale është rreth 1.8 milionë euro. Sa i përket çështjeve që lidhen me zyrtarët e lartë, vlera e pasurive të sekuestruara është rreth 1.1 milion euro, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara është rreth 100,000 euro.

Volumi i hetimeve penale është rritur edhe gjatë vitit 2025 krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2025, janë hetuar gjithsej 871 procedime penale, nga të cilat 294 janë procedimet të reja, të regjistruara gjatë vitit 2025 dhe 39 prej të cilave janë bashkuar, ndërsa 577 janë të mbartura nga viti 2024. Krahasuar me vitin 2024, kjo përfaqëson një rritje prej 4.9% të volumit të hetimeve penale (nga 793 në 832). Po ashtu, raporti mes procedimeve penale të reja dhe çështjeve/hetimeve të përfunduara u rrit me rreth 6.67% gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024.

Sa i përket *volumit të punës në mbylljen e hetimeve*, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të tregojë qëndrueshmëri me 216 çështje/hetime të përfunduara në vitin 2025, duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin 2024.

Edhe pse numri i çështjeve të dërguara në gjykatë ka rënë me 19.5%, numri i personave të përfshirë në këto çështje është rritur me 13.5%, çka tregon se, hetimet janë fokusuar tek çështje më komplekse, që përfshijnë më shumë individë. Kjo e dhenë, një reflektim të qasje më strategjike dhe të fokusuar të SPAK në ndjekjen penale gjatë këtij viti raportues.

Gjatë vitit 2025, rreth 29% e çështjeve dhe hetimeve të përfunduara janë transferuar tek prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, një rënie e ndjeshme krahasuar me mesataren e periudhës 2021–

2024. Ky zhvillim tregon se, çështjet janë adresuar kryesisht brenda juridiksionit të Prokurorisë së Posaçme, duke konfirmuar konsolidimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në ndjekjen penale, gjatë këtij viti.

SPAK ka shënuar një rritje të ndjeshme të *qasjes proaktive në hetime*. Nga 294 procedime penale të reja të regjistruara në vitin 2025, 109 janë nisur kryesisht nga Prokuroria e Posaçme, që përfaqëson rreth 37% të totalit, duke u rritur ndjeshëm krahasuar me 19.8% në vitin 2024 (65 hetime kryesisht nga 328 procedime të reja). Kjo tregon një fokus më të madh të institucionit në nisjen e hetimeve kryesisht, duke forcuar kontrollin dhe drejtimin strategjik të çështjeve. Ky fokus është mbështetur edhe nga aksesit i sigurt në 22 sisteme dhe databaza shtetërore, përfshirë 3 sisteme të reja, që kanë përmirësuar ndjeshëm shpejtësinë, sigurinë dhe eficiencën e proceseve hetimore.

Në luftën kundër krimit të organizuar, gjatë vitit 2025 edhe pse numri i *çështjeve dhe hetimeve të regjistruara* është më i ulët, krahasuar me vitin 2024, çështjet dhe hetimet e përfunduara kanë shënuar një rritje me rreth 3.4% (nga 58 në vitin 2024, në 60 në vitin 2025). Ky tregues konfirmon vijimësinë e një trendi rritës (gati të dyfishuar) që dëshmon përmirësim të qëndrueshëm, krahasuar me të dhënat statistikore të viteve 2022 dhe 2023. Këto të dhëna tregojnë rritjen e angazhimit të Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2025, për përfundimin e hetimeve në çështjet e lidhura me krimin e organizuar, duke reflektuar një qasje të vendosur ndaj veprave penale, që lidhen me grupet kriminale të strukturuar, si dhe luftën ndaj krimit të organizuar. Të dhënat krahasuese për periudhën 2024 dhe 2025 tregojnë gjithashtu një rritje me 11.5% të personave në hetim dhe 36.6% të personave të dërguar në gjykatë, çka tregon një orientim më cilësor të hetimeve drejt strukturave më të gjera dhe më të organizuara kriminale. Nga ana tjetër, rritja e pezullimeve me 93.7% dhe ulja e lehtë e çështjeve të dërguara në gjykatë me 14.3% evidentojnë sfidat procedurale dhe nivelin e kompleksitetit të çështjeve. Megjithatë në tërësi treguesit paraqesin një qasje më të thelluar dhe më të fokusuar të ndjekjes penale.

Në vitin 2025, SPAK ka vijuar të intensifikojë **luftën kundër korrupsionit**, duke regjistruar një rritje prej 17.7% të çështjeve/hetimeve të reja dhe 12.2% të çështjeve/hetimeve të përfunduara. Ky aktivitet i shtuar reflektohet në dërgimin në gjykatë të 24 procedimeve me 147 të pandehur për korrupsion *jo të nivelit të lartë*, si dhe 10 procedimeve me 13 të pandehur për korrupsion të nivelit të lartë. SPAK ka vijuar me vendosmëri hetimin e *zyrtarëve të nivelit të lartë*, me 6 procedime të reja dhe 16 persona nën hetim. Nga 30 zyrtarë dhe ish zyrtarë ta lartë nën hetim gjatë vitit 2025, mbi 50% e tyre (18) **janë dërguar në gjykatë** me kërkesë për gjykim, ndërsa 10 prej tyre janë dënuar me *vendim të formës së prerë*, duke treguar qëndrueshmëri dhe efektivitet në ndjekjen penale në nivelet më të larta të administratës publike.

Sipas të dhënave statistikore evidentohet niveli i lartë të besimit të publikut tek SPAK. Në vitin 2025, hetimet e filluara me kallëzim nga shtetas, zënë rreth 33,5% të totalit të procedimeve të filluara gjatë vitit 2025.

Bashkëpunimi me institucionet publike dhe personat juridik ka shënuar një përmirësim relativ gjatë vitit 2025. Kështu hetimet e filluara me referime nga Policia e Shtetit janë rritur me rreth 70%, ndërsa hetimet e nisura me referime nga institucionet publike kanë shënuar një rritje me rreth 15%. Nga ana tjetër, hetimet e filluara me kallëzime nga subjekte politike dhe personat juridikë kanë pësuar një rënie përkatësisht me rreth 50% dhe 75%.

Në lidhje me *masat e sigurimit*, SPAK ka aplikuar një politikë penale në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kështu, për llojin e kërkesave të *masave të sigurimit* rezulton se, numri i të paraburgosurve me kërkesë nga SPAK, që ndodhen pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) përbën vetëm rreth 12% të totalit të paraburgosurve. Ndërkohë, numri i të burgosurve, që janë dënuar me *vuajtje dënimi me burg* nga hetimet e SPAK përbën vetëm rreth 11% të numrit total të tyre.

Gjithashtu, ka një rënie me rreth 53,4 %, të përdorimit të masës “arrest me burg” dhe zhvendosje drejt masave alternative. Edhe në raport me totalin e personave nën hetim, vihet re, gjithashtu një rënie krahasuar me vitin paraardhës. Për vitin 2025, lidhur me veprat penale të korrupsionit, kjo masë zë vetëm rreth 3.45% të totalit të personave nën hetim (rreth 5% në vitin 2024), ndërsa për krimin e organizuar, kjo masë sigurie zë 21.4% të personave nën hetim (nga rreth 31% në vitin 2024).

Efektiviteti i SPAK në gjykim ka mbetur në nivele të qëndrueshme, gjatë periudhës 2021–2025. Krahasuar me vitin 2024, numri total i vendimeve të GJKKO-së është rritur lehtë me 5.5%, duke reflektuar stabilizim të volumit të çështjeve të përfunduara. *Vendimet e fajësisë përbëjnë rreth 87% të totalit*, ndërsa *vendimet e pafajësisë rreth 13%*, duke treguar nivelin e lartë të efektivitetit të Prokurorisë së Posaçme në fazën e gjykimit. Gjatë vitit 2025, numri i rekurseve të paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Gjykatës së Lartë për çështjet e hetuara nga SPAK është ulur ndjeshëm, me rreth 63%. Për këto çështje, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar dhe marrë 59 vendime përfundimtare, ndërsa 1 vendim është marrë nga Gjykata Kushtetuese.

Gjatë periudhës 2022–2025, *Spektori i Ekspertizës* pranë SPAK ka shënuar një rritje të qëndrueshme prej rreth 31% të akteve të ekspertimit, duke reflektuar zgjerimin e kapaciteteve teknike të laboratorëve të BKH-së, si dhe rritjen e kërkesave për analiza digjitale të thelluara. Telefonat celularë përbëjnë vazhdimisht rreth 70–75% të provave totale, duke nxjerrë në pah rëndësinë e analizës së metadata-ve, komunikimeve online dhe aplikacioneve të enkriptuara, ndërsa analizat mbi pajisjet kompjuterike janë rritur me 62%, duke pasqyruar shtimin e dokumenteve financiarë dhe atyre elektronikë në hetime.

Gjatë vitit raportues, SPAK ka konsoliduar Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve, i cili ka ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit të proceseve hetimore dhe raportimin statistikor. Modulet kryesore të këtij sistemi janë finalizuar, përfshirë, protokollin, regjistrimin e kallëzimeve dhe raportimin, ndërsa për vitin 2026 parashikohet zgjerimi i funksionaliteteve për një ndërveprim të plotë me proceset kryesore hetimore dhe procedurale.

Volumi dhe efektiviteti i analizave të brendshme ka qenë gjithashtu i konsiderueshëm. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka zhvilluar rregullisht mbledhje me prokurorët, për çështje që lidhen me funksionin e Prokurorisë së Posaçme, si dhe analiza të brendshme me stafin administrativ. Për gjatë vitit 2025, janë organizuar gjithashtu, edhe analiza me secilin prokuror dhe grupin e hetuesve përkatës, përfshirë dhe analiza tematike me Sektorin e Ekspertizës dhe Sektorin e Hetimit Financiar.

Gjatë vitit 2025, në Prokurorinë e Posaçme kanë ushtruar detyrën 124 punonjës (20 prokurorë, 12 hetues financiarë, 92 punonjës administrativë dhe 4 punonjës me kontratë të përkohshme).

Gkithashtu, janë zhvilluar dhe procedurat për punësimin e 4 hetuesve financiarë, me qëllim përforcimin e kapaciteteve në këtë fushë. Për zhvillimin profesional, i gjithë stafi ka ndjekur rreth 58 tema të ndryshme trajnimi të zhvilluara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke forcuar ekspertizën dhe efikasitetin e institucionit.

Gjatë vitit 2025, SPAK ka kryer raportime të vazhdueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke kontribuar në Raundin VI-të të vlerësimit të MONEYVAL, koordinimin me AIF, si edhe me institucione të tjera, për përmbushjen e standardeve të FATF. Sektori i Raportimeve ka menaxhuar një volum të lartë pune, duke përgatitur materiale analitike dhe përditësuar të dhëna për Raportet e Progresit, Kapitujt 23 dhe 24, Pikat e Ndërmjetme dhe Raportin e Sundimit të Ligjit, duke garantuar koordinim të ngushtë me institucionet vendase dhe ato të BE-së.

SPAK ka kryer ndjekjen penale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar, duke përfunduar trajtimin dhe përfaqësimin e rreth 68% të ankimeve të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm të Apelimit (KPA). Përgjatë këtij procesi janë zhvilluar 107 seanca gjyqësore, duke garantuar përfaqësimin efektiv, profesionalizëm dhe ruajtjen e integritetit të standardeve në mbrojtje të interesit publik. Katër çështje mbeten ende në shqyrtim, të parashikuara të përfundojnë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit në SPAK ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në zbatim të ligjit nr. 95/2016 dhe legjislacionit në fuqi, mbi deklarinë e pasurive dhe konfliktin e interesit. Numri total i zyrtarëve me detyrim deklarinë ka qenë 151, prej të cilëve 33 kanë paraqitur deklaratën si kandidatë, 22 deklaratën para fillimit të detyrës, 93 deklaratën periodike vjetore dhe 3 deklaratën pas largimit nga funksioni.

SPAK ka dëshmuar bashkëpunim të lartë me publikun dhe institucionet shtetërore, duke u angazhuar kryesisht në raportime dhe në koordinimin për strategjitë kombëtare kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave, si dhe në përmbylljen e kapitujve 23 dhe 24 me BE. Gjatë vitit 2025, numri total i shkresave hyrëse dhe dalëse ka qenë 44,392. Nga 914 kërkesa të ardhura nga institucione shtetërore, rreth 97% kanë marrë përgjigje, duke përcjellë mendime dhe të dhëna për projekt-akte ligjore, nënligjore dhe strategji ndërsektoriale me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme, Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Volum të konsiderueshëm pune ka pasur edhe në lidhje me kontrollin e integritetit të punonjësve të SPAK dhe gjykatave të posaçme. Gjatë vitit 2025, Komisioni ka përfunduar verifikimin e Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 49 kandidatë të personelit administrativ dhe 7 kandidatë për Drejtor të BKH-së, ndërsa vazhdojnë verifikimet për 46 subjekte të tjera. Po ashtu, janë paraqitur 38 kërkesa të reja për personelin administrativ në Prokurorinë e Posaçme, GJKKO dhe GJAKKO.

Gjatë vitit 2025, SPAK ka forcuar ndjeshëm komunikimin me qytetarët, gazetarët, median, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, duke garantuar trajtim korrekt dhe në kohë të kërkesave për informacion dhe zbatimin e Strategjisë së Komunikimit 2025–2028. Publikimi i 114 njoftimeve për shtyp, trajtimi i 170 kërkesave për informacion reflekton angazhimin e SPAK për transparencë dhe përpjekjen e pandërprerë për forcimin e besimit të publikut tek institucioni. Sa i përket vizitorëve të faqes zyrtare të SPAK (www.spak.gov.al), numri i vizitorëve unikë u rrit me 32.3%, nga 82,766 në 109,496; ndërsa numri i shikimeve u rrit me 28.7%, nga 437,882 në 563,453.

Viti 2025 shënoi një zhvillim të rëndësishëm për BKH-në duke mbajtur në vëmendje jo vetëm aktivitetin administrativ të institucionit, por me zgjedhjen e Drejtuesit të ri u hap një kapitull i ri për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme.

Gjatë vitit 2025, BKH ka shënuar përparim të dukshëm në fuqizimin e kapaciteteve të saj dhe zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian. Veprimtaritë kryesore përfshijnë rritjen e numrit të referimeve, finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Policinë e Shtetit sipas nenit 29, të ligjit nr. 95/2016, si dhe procesit vijues të rekrutimit të 10 oficerëve të shërbimeve gjyqësore dhe të Zëvendës drejtorit, në të cilën kanë aplikuar 67 kandidatë për oficerë dhe 11 kandidatë për Zëvendës drejtor.

Në aspektin struktural, BKH ka ngritur Seksionin e Përgjimit Parandalues, ndërsa dy njësitë e tjera të vlerësimit të riskut dhe bashkëpunimit ndërkombëtar janë në proces vlerësimi me SPAK. Hetuesit e BKH-së kanë rritur aksesin në 22 databaza kombëtare dhe 3 të huaja, në negociata për të shtuar 14 institucione të tjera dhe një agjenci të huaj (EMPACT). BKH ka vazhduar gjithashtu, pjesëmarrjen në platformën EMPACT dhe ka siguruar trajnime të vazhdueshme për hetuesit e saj. Këto përparime janë ndërlidhur me adresimin e prioriteteve të integritetit evropian, Rezolutën e Kuvendit dhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave. Për më tepër, raporti i SPAK ofron një pasqyrë të kriminalitetit, të efektivitetit në hetim dhe gjykim, si dhe të volumit të punës në të gjithë sektorët, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve hetimore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

PROBLEMATIKAT QË DUHEN ADRESUAR

Problematikat dhe Sfidat

SPAK ka identifikuar disa sfida kryesore në funksionimin e saj, të cilat kërkojnë ndryshime ligjore të mundshme në Kushtetutë, ligjin organik nr. 95/2016 dhe ligje të tjera, për të garantuar cilësinë dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, si më poshtë:

1. **Sfidat në hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë** - Hetimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivele të larta paraqet sfida të rëndësishme për SPAK. Gjithashtu, retorika politike dhe mediatike mund të ndikojë në perceptimin publik dhe në autoritetin e institucionit, si dhe mund të shërbejë edhe si faktor nxitës për rritjen e nivelit të kërcënimeve nga krimi i organizuar. SPAK do të konsideronte veçanërisht shqetësuese ato nisma ose masa me karakter ligjor dhe institucional, që do të synonin kufizimin e mjeteve procedurale dhe pavarësinë e saj. Ndërhyrje të tilla do të përbenin rrezik serioz për funksionin kushtetues të SPAK dhe për vetë shtetin e së drejtës.
2. **Statusi i prokurorëve të posaçëm pas përfundimit të mandatit** – Mospërcaktimi i qartë ligjor kërcënon vijimësinë e hetimeve dhe standardet profesionale, duke ndikuar në besimin e publikut dhe në përmbushjen e kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. **Këshilltarët ligjor pranë SPAK** - Mungesa e këshilltarëve ligjorë me përvojë krijon vështirësi në cilësinë e hetimeve dhe ndjekjes së çështjeve në të gjitha shkallët e gjyqimit, përfshirë edhe në Gjykatën Kushtetuese.

4. **Bashkëpunimi me institucionet publike** - Edhe pse ka rritje të referimeve dhe shkëmbimit të informacionit, niveli i bashkëpunimit duhet të intensifikohet më tej, veçanërisht me Policinë e Shtetit, për të garantuar hetime më të koordinuara dhe efikase.
5. **Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve (Case Management System)** - Konsolidimi i mëtejshëm i moduleve ekzistuese dhe integrimi i funksionaliteteve të reja mbetet prioritet për të përmirësuar ndërveprimin me proceset hetimore dhe procedurale të të dhënave, duke siguruar monitorim më të mirë të progresit të çështjeve.
6. **Njësia e analizës** - Ngritja e një strukture të specializuar për mbështetjen e hetimeve komplekse, matjet e riskut dhe raportimet kombëtare dhe ndërkombëtare vazhdon të mbetet sfidë, duke kërkuar bashkëpunim të vazhdueshëm me ekspertë ndërkombëtarë.
7. **Specialisti Ndërlidhës** - Statusi i specialistit ndërlidhës si nëpunës civil nuk përputhet plotësisht me funksionet, që duhet të kryejë sipas ligjit nr. 95/2016, duke e bërë të nevojshme përcaktimin e qartë të pozicionit dhe kompetencave për të garantuar efektivitetin e rolit.
8. **Shqyrtimi i kërkesave nga autoritetet e huaja** - Mungesa e kompetencës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, përfshirë procedurat e ekstradimit, mbetet problematike dhe ndikon vijimësinë e hetimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.
9. **Kompetenca e Gjykatave të Posaçme** - Mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale për subjektet e posaçme detyron që këto çështje të trajtohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, duke rritur kohëzgjatjen dhe kompleksitetin procedural.
10. **Ekstradimi/deportimi i shtetasve shqiptarë** - Edhe pse ka përmirësime në bashkëpunimin me disa shtete, përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe, procesi i ekstradimit vazhdon të jetë sfidues dhe kërkon nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për të garantuar ekzekutimin e vendimeve penale jashtë vendit.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, SPAK gjatë vitit 2025, ka pasur në vëmendje të veçantë dhe është angazhuar maksimalisht në përmbushjen e rekomandimeve të BE-së.

Siç u përmend në pjesën hyrëse të këtij raporti, si Progres Raporti ashtu edhe Raporti mbi Shtetin e së Drejtës i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, kanë theksuar përparimin e dukshëm nga SPAK në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e kapacitetit dhe efektivitetit institucional, për të goditur grupet e krimit të organizuar.

Sipas Progres-Raportit, rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme për vitin 2026, duke përfshirë konkretisht:

➤ *Shqipëria duhet të sigurojë një procedurë konkurruese dhe me standard të lartë për vlerësimin dhe emërimin e Drejtuesit të SPAK-ut në Prokurorinë e Posaçme, në përputhje me parimet më të larta të meritës dhe pavarësisë. Ndërkohë që, procesi i emërimit të Drejtorit të ri të Byrosë Kombëtare të Hetimeve ka qenë deri tani i hapur dhe konkurrues, ka pasur vonesa në*

emërimin përfundimtar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të miratojë rregulla dhe procedura të qarta për rastet e ardhshme.

E gjithë procedura e përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së u administrua nga Komisioni i Përzgjedhjes në Prokurorinë e Posaçme, i ngritur sipas parashikimeve të ligjit nr. 95/2016 dhe u zhvillua në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe me standardet e transparencës dhe konkurrueshmërisë. Nga 13 kandidatë aplikantë, 6 u skualifikuan në fazën e parë, ndërsa 7 të tjerë vijuan garën deri në përfundim të procedurës. Kandidatët iu nënshtruan një procesi të plotë vlerësimi, i cili përfshinte: testet fizike, provimin me shkrim, intervistën me gojë, testin e poligrafit, si dhe verifikimin nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve i kushteve të sigurisë dhe pasurisë, sipas nenit 6, të ligjit nr. 95/2016. Në përfundim, Komisioni i Përzgjedhjes i rekomandoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Joni Keta për emërim në pozicionin e Drejtorit të BKH-së.

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme, procesi për përzgjedhjen e Drejtorit të ri të BKH-së nisi në fillim të vitit 2025, përmes komunikimeve zyrtare me Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe me ish-Drejtoreshen e BKH-së, në respekt të dispozitave ligjore që parashikojnë të drejtën e rikandidimit për një mandat të dytë 5-vjeçar. Në funksion të përmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore, procesi i komunikimit dhe shpalljes së rikandidimit mori një kohë gati tre mujore.

Pas përfundimit të procesit të rikandidimit, në mungesë të dorëzimit të dokumentacionit për këtë proces, Prokuroria e Posaçme nisi në muajin prill 2025, procedurën e re të përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së, gati pesë muaj përpara përfundimit të mandatit të Drejtorit në detyrë. Pavarësisht planifikimit paraprak, procedura u shtri përtej afatit të përfundimit të mandatit edhe për shkak të nevojës për verifikime të thelluara të kushteve të sigurisë dhe figurës të shtatë kandidatëve, të kryera nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Kushteve të Sigurisë dhe Figurës së Kandidatëve, procesi i komunikimit dhe shpalljes së rikandidimit mori një kohë gati tre mujore.

Në këtë kuadër, çdo zgjatje kohore e procesit nuk ka qenë pasojë e mos nisjes në kohë, mungesës së rregullave apo transparencës, por si rezultat i zbatimit rigoroz të detyrimeve ligjore dhe procedurave të verifikimit, të domosdoshme për garantimin e pavarësisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë së drejtimit të BKH-së.

➤ ***Ekziston më tepër hapësirë për transparencë dhe verifikim edhe më të madh të marrjes në pyetje, veçanërisht përmes dhomave të reja të marrjes në pyetje, në nivelin e SPAK-ut.***

Në përputhje me këtë rekomandim, SPAK në godinën e re ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke parashikuar një infrastrukturë të dedikuar për marrjen në pyetje të personave dhe dëshmitarëve. Janë parashikuar dhoma të veçanta për marrje në pyetje dhe dhoma për procedurat e njohjes. Çdo dhomë marrjeje në pyetje është e pajisur me pika të integruara në dyshe me furnizim me energji elektrike dhe lidhje interneti, si dhe me sistem të instaluar kamerash dhe regjistrimi audio, për të garantuar monitorim dhe dokumentim të plotë të procedurës sipas standardeve me të mira ndërkombëtare.

➤ ***Numri i referimeve nga autoritetet e tjera për në SPAK duhet të rritet dhe gjithashtu kërkon vëmendje kapaciteti dhe organizimi i brendshëm i SPAK-ut për të përballuar volumet e punës në rritje.***

Bashkëpunimi me institucionet publike dhe referimet e ardhura prej tyre, është përmirësuar krahasuar me vitin e mëparshëm. Gjatë vitit 2025, vihet re se, numri i hetimeve të filluara me referime nga Policia e Shtetit ka pasur një rritje me rreth 70%. Po kështu, hetimet e filluara me kallëzime nga institucionet publike kanë shënuar një rritje me rreth 15%, krahasuar me të njëjtin tregues të vitit 2024.

Nga ana tjetër, vihet re, edhe një rritje e ndjeshme e procedimeve penale të nisura kryesisht, bazuar në analizën proaktive të informacionit, hetimet financiare dhe përdorimin e inteligjencës kriminale. Hetimet e nisura kryesisht për vitin 2025, përfaqësojnë rreth 37% të totalit të procedimeve të reja për vitin 2025, ndërkohë që kjo vlerë për vitin 2024, ishte në masën 19.8%.

Në lidhje me përballimin e volumit të punës, SPAK ka ndërmarrë masa konkrete për forcimin e kapaciteteve hetimore dhe organizative, si një komponent kyç për hetimin e veprave penale komplekse dhe ndjekjen e pasurive me origjinë kriminale. Po ashtu, prej muajit Maj 2025 është hapur procedura konkurruese për përzgjedhjen e 4 hetuesve financiarë, në Sektorin e Hetimit Financiar (aktualisht janë të emëruar 12 hetues), ndërkohë që kandidatët e përzgjedhur aktualisht janë në fazën e verifikimit të thelluar të kushteve të sigurisë, figurës dhe pasurisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në një afat të afërt është parashikuar dhe pritët të hapet procedura konkurruese për rekrutimin e 40 hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, masë kjo që synon rritjen e ndjeshme të kapaciteteve operacionale të BKH-së dhe çuarjen e numrit total të hetuesve nga 60 në 100. Kjo rritje pritët të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e ngarkesës të hetuesve dhe në rritjen e eficiencës së hetimeve.

Në funksion të forcimit të mbështetjes operative dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndër-institucional, SPAK ka nisur gjithashtu, procedurën për rekrutimin e 10 oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore pranë BKH-së, të cilët do të përzgjidhen nga institucione të ndryshme shtetërore, përfshirë Policinë e Shtetit, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky mekanizëm synon të rrisë kapacitetin analitik dhe hetimor të BKH-së, si dhe të forcojë koordinimin praktik me organet e tjera ligjzbatuese.

➤ ***SPAK miratoi Strategjinë e Reduktimit të Çështjeve të Mbartura (Backlog) për periudhën 2025-2027, e cila kontribuon në zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë Ndërsektoriale dhe Strategjisë Kombëtare kundër Krimin të Organizuar. Megjithatë, mbetet i nevojshëm fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale, planifikimi, koordinimi dhe mekanizmat e monitorimit.***

Strategjia e SPAK për Reduktimin e Çështjeve të Mbartura (Backlog) 2025–2027 është hartuar dhe po zbatohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (OPDAT dhe projektin EU4LEA dhe është në fazën e dytë). Kjo strategji ka dhënë rezultatet e para të saj, me arritjen e objektivave të përkohshme për uljen e çështjeve të regjistruara në vitet 2020 dhe 2021, përpara afatit të caktuar në dhjetor 2025. Bazuar në të dhënat paraprake të muajit Tetor 2025, numri i çështjeve të mbartura është reduktuar nga 83 në 71 për vitin 2020 ose më herët se ky vit dhe nga 62 në 50 për vitin 2021, ndërsa norma paraprake e reduktimit ka arritur 78%, duke reflektuar një përparim të dukshëm dhe efektivitet në trajtimin e çështjeve të prapambetura.

Monitorimi i progresit dhe zbatimi i kësaj strategjie realizohet nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar mujore dhe tremujore, që përfshijnë mbledhjet e Grupit të Punës, tabelat e standardizuara të raportimit dhe verifikimin e kryqëzuar të të dhënave mes Sektorit të Regjistrimit dhe ai i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

➤ ***SPAK të vazhdojë forcimin e mbajtjes së të dhënave për hetimet, ndjekjet penale dhe dënimet e formës së prerë në të gjitha fushat e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë trafikimin e drogës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së, si dhe duke rritur kapacitetet për parandalimin e krimit të organizuar dhe duke siguruar përafrim të mëtijshëm me acquis të BE-së, veçanërisht në lidhje me kriminalizimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, online dhe offline.***

SPAK ka forcuar historikun e hetimeve, ndjekjes penale dhe të dënimeve me vendim të formës së prerë për secilën kategori të veprave penale, që janë në kompetencën e saj. Ajo ka paraqitur në raportet e saj vjetore edhe analiza krahasimore ndër vite në fushën e veprave penale të rënda dhe ato në kuadër të krimit të organizuar, përfshirë trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Konsolidimi i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në vitin 2026, pritet të rrisë ndërveprimin e tij, me proceset kryesore hetimore dhe procedurale, duke forcuar më tej mbajtjen e të dhënave të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare për të gjitha veprat penale në kompetencë të SPAK. Gjithashtu, është intensifikuar bashkëpunimi me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë ligjzbatuese të BE-së, si dhe janë rritur kapacitetet logjistike dhe ato të burimeve njerëzore përmes trajnimeve për parandalimin e krimit të organizuar. Nga ana tjetër, SPAK ka marrë pjesë në grupet ndërsektoriale të punës, me qëllim rishikimin e legjislacionit në fushën e saj, të kompetencës. Të dhëna të detajuara për këtë qëllim janë përfshirë në sektorët përkatës të këtij raporti.

➤ ***SPAK duhet të zhvillojë më tej përdorimin sistematik të hetimeve financiare në trajtimin e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë trafikimin e paligjshëm, terrorizmin dhe pastrimin e parave.***

SPAK ka vijuar të zbatojë ndjekjen sistematike të hetimeve financiare dhe pasurore paralelisht për secilën kategori të veprave penale, që janë në kompetencën e saj, përfshirë trajtimin e veprave penale të rënda dhe ato në kuadër të krimit të organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore, terrorizmin dhe pastrimin e parave, në përputhje me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024 “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar gjithsej 32 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*”. Këto procedime lidhen kryesisht me çështje me kompleksitet të lartë, vlera të mëdha financiare dhe skema të sofistikuara pastrimi, të ndërlidhura me krimin e organizuar. Fokusi nuk ka qenë tek sasia, por tek goditja e strukturave dhe transaksioneve me impakt të madh penal dhe financiar. Në bashkëpunim me projektin EU4LEA (faza e dytë), ka filluar puna për udhëzimin mbi masat për financimin e terrorizmit, sipas rekomandimeve MONEYVAL. Vlera e pasurive të sekuestruara për vepra penale, që lidhen me krimin e organizuar është rreth 42.4 milionë euro, ndërkohë që, vlera e pasurive të konfiskuara për këtë kategori veprash penale është rreth 1.8 milionë euro.

➤ ***SPAK duhet të vazhdojë forcimin e hetimit, ndjekjes penale dhe gjyqimit të çështjeve të korrupsionit dhe të sigurojë më shumë dënime të formës së prerë, veçanërisht në nivelet e larta, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin përfundimtar të pasurive kriminale që rrjedhin nga veprat penale të lidhura me korrupsionin, si dhe të rrisë referimet proaktive nga institucionet shtetërore përkatëse dhe agjencitë ligjzbatuese drejt SPAK.***

Sikundër është evidentuar në pjesën hyrëse të këtij raporti, krahasuar me vitin 2024, vihet re një rritje në masën 17.7% e numrit të çështjeve/hetimeve e regjistruara për veprat penale që lidhen me korrupsionin. Ky tregues për vitin 2025, rezulton më i larti krahasimisht edhe me vitet paraardhëse. Për sa i përket veprave penale që lidhen me zyrtarë të nivelit të lartë, gjatë vitit 2025, në SPAK janë regjistruar 6 procedime të reja me 16 persona nën hetim. Për vitin 2025, rezultojnë gjithsej (të mbartura + të regjistruara) 27 procedime penale me 30 persona në hetim/të pandehur, zyrtarë dhe ish-zyrtarë të nivelit të lartë (nga 33 në vitin paraardhës). Nga 30 ish-zyrtarë të lartë për vitin 2025 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, 18 prej tyre (ndërkohë që për vitin 2024 ishin 19).

Po ashtu, tendenca rritëse kanë shënuar dhe çështjet/hetimet e përfunduara gjatë vitit 2025, duke evidentuar një rritje prej 12.2%, krahasimisht me të njëjtin tregues për vitin 2024. Nga ana tjetër, për vitin 2025, nga 215 hetime të përfunduara janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 24 procedime penale me 147 të pandehur, akuzuar për veprat penale të korrupsionit jo të nivelit të lartë. Për veprat penale të korrupsionit të nivelit të lartë gjatë vitit 2025, janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, 10 procedime penale me 13 persona të pandehur. Gjithashtu, gjatë vitit 2025, janë ekzekutuar 70 vendime penale të formës së prerë me 251 të pandehur dhe 226 të dënuar, prej të cilëve 10 janë për ish zyrtarë të lartë. Krahasuar me vitin 2024, gjatë të cilit ishin ekzekutuar gjithsej 79 vendime penale të formës së prerë, me 235 të dënuar, prej të cilëve 10 janë ish zyrtarë të lartë. Pavarësisht uljes së lehtë në numrin e vendimeve të ekzekutuara vihet re se, numri i përgjithshëm i të pandehurve dhe kompleksiteti i çështjeve është rritur dhe se, SPAK ka në fokus goditjen e korrupsionit të nivelit të lartë, me të njëjtin numër ish-zyrtarësh të dënuar.

Përgjatë vitit 2025, nuk janë dhënë vendime për sekuestrimin e pasurive në lidhje me vepra penale të korrupsionit të thjeshtë. Vlera e pasurive të sekuestruara të zyrtareve të lartë është rreth 1.1 milion euro, ndërkohë që, vlera e pasurive të konfiskuara është rreth 100,000 euro.

Sipas Raportit të Shtetit të së Drejtës, rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme për vitin 2026, konkretisht:

➤ ***Ngarkesa në rritje e vazhdueshme e punës në SPAK, si dhe mungesa e stafit dhe infrastrukturës së mjaftueshme, mbeten çështje që kërkojnë adresim të menjëhershëm.***

Për vitin 2025, ngarkesa në rritje e punës në SPAK ka reflektuar angazhimin e vazhdueshëm të Prokurorisë së Posaçme për të adresuar çështjet më komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Megjithatë, kapacitetet aktuale të stafit dhe infrastruktura nuk janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur në mënyrë optimale volumit të çështjeve, duke e bërë të domosdoshëm përforcimin e strukturave administrative dhe hetimore, rekrutimin e personelit të specializuar dhe përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, për sigurimin e efikasitetit operativ dhe respektimit të afateve ligjore. Sa i përket infrastrukturës, aktualisht jemi në përfundim të godinës së re të SPAK, e cila pritet të inaugurohet brenda vitit, duke mundësuar akomodimin e gjithë stafit dhe të pajisjeve të reja, gjë që do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetet operative dhe efektivitetin e veprimtarisë.

Sa u përket kapaciteteve njerëzore, gjatë gjashtë mujorit të dytë, të vitit 2025, SPAK ka ndërmarrë masa konkrete për përballimin e ngarkesës në rritje dhe për forcimin e kapaciteteve hetimore. Janë në përfundim të procesit të rekrutimi 4 (katër) hetues të tjerë financiarë, të cilët aktualisht po i nënshtrohen procesit të verifikimit të integritetit dhe pasurisë. Gjithashtu, në muajin Nëntor 2025, BKH ka hapur procedurën për përzgjedhjen e 10 (dhjetë) oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore, procedurë e cila, është përfunduar dhe kandidatët aktualisht po i nënshtrohen fazës së verifikimit të integritetit dhe pasurisë.

Me synim forcimin më tej të kapaciteteve, për vitin 2026, është planifikuar nisja e procedurës për përzgjedhjen e 40 hetuesve të rinj të BKH-së, duke garantuar që, struktura hetimore të jetë e aftë të përballojë ngarkesën në rritje të çështjeve dhe të rrisë efektivitetin e veprimtarisë së SPAK-ut në hetime financiare dhe operatione komplekse.

➤ ***Përdorimi sistematik i masave të veçanta hetimore është përmirësuar, megjithëse hendeuku midis sekuestrimeve dhe konfiskimeve vijon të mbetet.***

SPAK ka rritur dhe konsoliduar ndjeshëm përdorimin e masave të posaçme të hetimit, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së provueshmërisë në çështjet komplekse të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Megjithatë, diferenca mes masës së pasurive të sekuestruara dhe atyre të konfiskuara përfundimisht mbetet e ndikuar nga faktorë objektivë, si kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, deri në vendim të formës së prerë dhe kompleksiteti i hetimeve financiare. Në këtë drejtim, është forcuar qasja ndaj hetimit financiar paralel dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për gjurmimin dhe rikuperimin e pasurive, me synim reduktimin gradual të këtij hendeuku dhe rritjen e efektivitetit të konfiskimeve përfundimtare.

REKOMANDIMET E KUVENDIT PËR VITIN 2025

Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, e miratuar në datë 30.10.2025, la disa rekomandime për SPAK, për vitin 2025. Për realizimin e tyre dhe garantimin e zbatimit të strukturuar dhe efektiv të këtyre rekomandimeve, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar edhe asistencën e partnerëve ndërkombëtarë (BE-së, SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar) që mbështesin SPAK. Kështu më datë 14.1.2026, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zhvilloi një mbledhje të posaçme me përfaqësuesit e partnerëve, gjatë së cilës u diskutuan mënyrat konkrete të zbatimit të rekomandimeve dhe u arrit dakordësi mbi angazhimin e tyre për ofrimin e ekspertizës dhe mbështetjes teknike. Partnerët ndërkombëtarë konfirmuan gatishmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë aktive në këtë proces, duke siguruar një asistencë të strukturuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Është e rëndësishme të theksohet se rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit janë miratuar më datë 11 nëntor 2025, çka i ka dhënë institucionit realisht vetëm një muaj kohë, konkretisht muajin dhjetor, për të ndërmarrë hapat e parë drejt realizimit të tyre.

Ecuria e zbatimit të rekomandimeve dhe masat e ndërmarra për secilin rekomandim, gjenden të shpjeguara si vijon:

Rekomandimi nr. 1 - Ngritjen e një grupi pune në bashkëpunim edhe me Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për përgatitjen e një analize për Grupet e Krimit të Organizuar aktive në aktivitetin e tyre brenda e jashtë vendit dhe strategjinë e thellimit të luftës kundër tyre.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 1, Prokuroria e Posaçme ka marrë masa organizative dhe koordinuese për zbatimin e këtij rekomandimi, me synim forcimin e analizës strategjike dhe intensifikimin e goditjes së krimit të organizuar. Janë caktuar përfaqësuesit përgjegjës të SPAK për ndjekjen e tij dhe ka filluar bashkëpunimi ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, përmes ngritjes së një grupi të përbashkët pune, të fokusuar në hartimin e një analize të plotë mbi grupet e krimit të organizuar, përfshirë shtrirjen dhe dimensionin e tyre ndërkombëtar.

Rekomandimi nr. 2 - Përgatitjen e një analize për masat e sigurisë të marra në këto 5 vjet (2021 - 2025), politikat e ndjekura, problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për reflektim në praktikën e vendeve evropiane në këtë fushë dhe standardet e rekomanduara nga KiE, BE, GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 2, Prokuroria e Posaçme ka ndërmarrë masat e nevojshme organizative për adresimin e këtij rekomandimi, duke ngritur një grup të posaçëm pune për përgatitjen e një analize të detajuar mbi masat e sigurisë të aplikuara gjatë periudhës 2021–2025. Ky grup pune, po analizon politikat e ndjekura, sfidat dhe problematikat e evidentuara në praktikë, si dhe masat që synohen të ndërmerren për harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet dhe praktikën më të mira evropiane, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe rekomandimet e institucioneve përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare.

Rekomandimi nr. 3 - Në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe KQZ-në, të zhvillojnë një analizë të përbashkët për zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025 dhe masat ligjore e institucionale që mund të ndërmerren për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të parandaluar e ndëshkuar çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 3, Prokuroria e Posaçme ka ndërmarrë masa të strukturuar organizative dhe koordinuese për zbatimin e këtij rekomandimi dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Me Urdhrin e Drejtuesit nr. 43645, datë 22.12.2025, është caktuar një prokuror i posaçëm si pikë kontakti për koordinimin dhe komunikimin institucional në realizimin e analizës së përbashkët mbi zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet 2025.

Është përfunduar analiza e brendshme paraprake e krimit zgjedhor për vitin 2025 nga ana e SPAK dhe është vendosur një mekanizëm bashkërendimi i drejtpërdrejtë e i vazhdueshëm me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për të garantuar qasje të unifikuar institucionale, reagim efektiv dhe standard të lartë ligjshmërie në mbrojtje të integritetit të proceseve zgjedhore dhe sundimit të ligjit.

Rekomandimi nr. 4 - Zgjerimin e përdorimit të teknologjive të avancuara për gjurmimin e pasurive dhe rrjeteve financiare për çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Rekomandimi nr. 5 - Vijimin e përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve teknike dhe logjistike për hetimet financiare, hetimin e krimeve kibernetike dhe pastrimit të parave, përfshirë kriptovalutat edhe përmes trajnimeve të specializuara dhe bashkëpunimit më të ngushtë me Europol dhe EMPACT.

Në zbatim të Rekomandimeve nr. 4 dhe nr. 5, Prokuroria e Posaçme ka vijuar dhe intensifikuar masat e forcimit të kapaciteteve teknike, logjistike dhe profesionale në funksion të hetimeve financiare, gjurmimit të pasurive, hetimit të krimeve kibernetike dhe pastrimit të parave, përfshirë kriptovalutat. Janë ndërmarrë veprime konkrete për zgjerimin e përdorimit të teknologjive të avancuara, përfshirë identifikimin dhe sigurimin e mjeteve moderne të analizës së të dhënave, platformave të inteligjencës nga burime të hapura, sistemeve të menaxhimit të çështjeve, si dhe rritjen e përdorimit të programeve për analizimin e transaksioneve financiare dhe të dhënave blockchain, në bashkëpunim me institucione partnere ndërkombëtare.

Paralelisht, SPAK ka investuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale përmes trajnimeve të specializuara, pjesëmarrjes në “workshop-e”, konferenca dhe seminare ndërkombëtare, si dhe forcimit të bashkëpunimit me struktura të BE-së, përfshirë “Europol” dhe “EMPACT”. Në këtë kuadër, vijon bashkëpunimi me Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ligjor (CILC) të Mbretërisë së Holandës për zbatimin e instrumentit elektronik BAT (Bank Analysis Tool), që synon analizën e shpejtë dhe efikas të të dhënave bankare në hetimet financiare dhe të pastrimit të parave.

Në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së hetimeve, është përmirësuar infrastruktura teknologjike dhe pajisjet kompjuterike, si dhe janë rritur kapacitetet e Sektorit të Ekspertizës, përmes modernizimit të teknologjive të ekstraktimit dhe analizimit të të dhënave digjitale, investimit në akreditimin e laboratorit të ekspertizës dhe planifikimit për rritjen e numrit të ekspertëve, me qëllim përballimin e volumit në rritje të çështjeve dhe shmangien e vonesave që cenojnë efikasitetin e hetimeve.

Një përbërës thelbësor i këtij procesi ka qenë edhe investimi në programe dhe licenca të reja që mundësojnë virtualizimin e pajisjeve të sekuestruara, analizimin e të dhënave financiare dhe digjitale në mënyrë të sigurt dhe efektive, si dhe mbështetjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të hetuesve për interpretimin e provave digjitale dhe financiare, përfshirë ato që lidhen me kriptomonedhat.

Në nivel strategjik, SPAK ka siguruar financimin e dy projekteve madhore për forcimin e kapaciteteve operative dhe teknike, konkretisht: prokurimin e pajisjes *IMSI Catcher* dhe modernizimin e sistemit të përgjimit përmes përditësimit në versionin më të fundit, rritjes së kapaciteteve të ruajtjes së të dhënave dhe shtimit të modulit për interceptimin e të dhënave IP. Këto projekte, me vlerë totale 5.1 milion euro, janë miratuar me vendimin nr. 188, datë 09.06.2025 të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

Rekomandimi nr. 6 - Të bëhen përpjekje për unifikimin/standardizimin e metodologjisë së hetimit lidhur me marrjen e provave dhe masat e sigurisë etj., bazuar edhe në vendimet njësoje të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet e GJEDNJ-së.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 6, Prokuroria e Posaçme ka ngritur një grup pune të posaçëm për unifikimin dhe standardizimin e metodologjive hetimore, veçanërisht në mbledhjen dhe administrimin e provave dhe aplikimin e masave të sigurisë, në përputhje me vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të gjitha këto masa, të kombinuara me angazhimin e partnerëve ndërkombëtarë për asistencë teknike dhe ekspertizë, synojnë të sigurojnë një zbatim efektiv dhe të strukturuar të rekomandimeve, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

Rekomandimi nr. 7 - Finalizimin e miratimit të akteve të mbetura nënligjore, përfshirë udhërrëfyesin për reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe aktet që lidhen me qarkullimin e brendshëm të dosjeve etj.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 7, Prokuroria e Posaçme pas një pune të koordinuar dhe të strukturuar me partnerët ndërkombëtarë që mbështesin SPAK, ka finalizuar dhe miratuar me urdhërin e Drejtuesit nr. 27061, datë 04.08.2025, “Strategjinë për Reduktimin e Çështjeve të Mbartura 2025–2027”. Strategjia ka hyrë në fazën e zbatimit praktik, duke dhënë tashmë rezultate konkrete dhe të matshme, në përputhje me objektivat dhe afatet e përcaktuara në të dhe konkretisht, norma e reduktimit që duhej të ishte 70%, në muajin nëntor 2025 arriti vlerën 126.3%.

Paralelisht me zbatimin e Strategjisë, Prokuroria e Posaçme ka vijuar procesin e finalizimit të udhëzimit për qarkullimin e brendshëm të dosjeve. Në këtë kuadër, udhëzimi është hartuar dhe pritët të miratohet në vijim, me qëllim rritjen e eficiencës administrative dhe përmirësimin e menaxhimit të procedimeve penale.

Rekomandimi nr. 8 - Zbatimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, përfshirë aktivizimin e moduleve të mbetura dhe përdorimin e sistemit për raportim të brendshëm dhe gjenerim statistikash në kohë reale.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 8, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2025, vijoi zbatimin dhe konsolidimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, me synim aktivizimin e plotë të moduleve, rritjen e efikasitetit dhe gjenerimin e statistikave në kohë reale. Në vitin 2025 nisi zbatimi praktik i sistemit me përmirësime të vazhdueshme funksionale, ku u përfundua zhvillimi dhe implementimi i modulit të referimit dhe procedimeve pasurore, si dhe i modulit të statistikave sipas formatit zyrtar të raportimit, që mundëson edhe identifikimin e backlog-ut të çështjeve.

Për vitin 2026 parashikohet zhvillimi i moduleve të reja: integrimi elektronik i letërporosive hyrëse/dalëse për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe grupet hetimore të përbashkëta, konsolidimi i regjistrit të personave sipas statusit procedural, integrimi i hetimit financiar në procedimin penal, modulet për ekzekutimin e urdhrave, korrigjimin, auditimin dhe menaxhimin e logeve. Parashikohet rritje e sigurisë përmes enkriptimit të dokumenteve, përmirësim i funksioneve për hetuesit, zhvillim i statistikave sipas kërkesave të MONEYVAL, si dhe testim i ndërlidhjes me regjistra shtetërorë, përfshirë Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Këto masa synojnë, rritjen e transparencës së brendshme, efikasitetit operacional dhe cilësisë së raportimit statistikor.

Rekomandimi nr. 9 - Rritjen e efikasitetit institucional të Byrosë Kombëtare të Hetimit në zbatim të përcaktimeve të ligjit organik përmes plotësimit të vakancave dhe sigurimit të kushteve të nevojshme logjistike për funksionim të plotë të strukturës.

Në zbatim të Rekomandimit nr. 9, Byroja Kombëtare të Hetimit, ka ndërmarrë masa konkrete për konsolidimin e strukturës, plotësimin e pozicioneve kyçe dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Struktura organizative e BKH- së është riformatuar me Urdhrin e Përbashkët nr. 98/7 Prot., datë 14.11.2025, të Drejtorit të BKH-së dhe nr. 40232, datë 14.11.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke miratuar strukturën me gjithsej 178 pozicione pune, përkatësisht: 1 Drejtor të BKH, 100 hetues, 50 oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe 27 punonjës administrativë. Struktura është në përputhje me pozicionet specifike të parashikuara në ligjin nr. 95/2016, i ndryshuar.

Në drejtim të forcimit të drejtimit institucional, me Vendimin nr. 370, datë 09.12.2025, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e BKH- së, për një mandat 5-vjeçar. Pas krijimit të vakancës për pozicionin e Zëvendësdrejtorit, në Janar 2026, është shpallur thirrja për aplikim, në të cilën kanë aplikuar 11 kandidatë dhe kjo procedure është në proces të vlerësimit dhe përzgjedhjes.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve hetimore, gjatë vitit 2026 do të zhvillohet procesi i rekrutimit për 40 pozicione të reja hetues, të shpërndara në sektorët kundër korrupsionit, kundër krimit të organizuar, si dhe në seksionet e përgjimit procedural dhe parandalues, duke synuar rritjen e eficiencës dhe cilësisë së hetimeve.

Në lidhje me oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore, gjatë vitit 2025, është zhvilluar procesi i rekrutimit për 10 nga 50 pozicionet e miratuara në strukturë. Nga 67 aplikantë, 41 janë kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar me gojë, që është zhvilluar në datën 07.02.2026. Kandidatët e kualifikuar do t'i nënshtrohen më tej procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, në përputhje me ligjin nr. 95/2016.

Sa i përket administratës, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar procedura rekrutimi për disa funksione administrative, ku një pjesë e pozicioneve janë plotësuar, ndërsa disa procedura janë anuluar për mosplotësimin e kriterëve ligjore nga kandidatët. Aktualisht, rezultojnë 4 vende vakante në administratë, për të cilat do të vijnë procedurat përkatëse të plotësimit të tyre. Gjatë gjithë proceseve të rekrutimit dhe emërimit, BKH ka bashkëpunuar ngushtësisht me Prokurorinë e Posaçme dhe partnerët ndërkombëtarë, përfshirë ICITAP dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian, të cilët kanë asistuar dhe monitoruar këto procese.

Në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës dhe logjistikës, procesi për sigurimin e ambienteve të reja të punës për BKH ndodhet në fazat përfundimtare dhe parashikohet që brenda vitit 2026 stafi i BKH-së të akomodohet në ambientet e reja, të përshtatshme për natyrën e veprimtarisë hetimore.

Rekomandimi nr. 9 - Vazhdimin e përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatim edhe të rekomandimeve të BE-së duke intensifikuar bashkëpunimin me agjencitë e BE-së (Eurojust, Europol, OLAF) dhe vendet anëtare për ndjekjen e çështjeve transnacionale për

të përmbushur plotësisht rekomandimet e progresraportit të BE-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

Në zbatim të rekomandimit nr. 10, Prokuroria e Posaçme ka vijuar forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bashkëpunimin e ngushtë me agjencitë e BE-së, duke përfshirë diskutimet për vendosjen e një pike kontakti nga radhët e hetuesve të BKH-së me OLAF, me qëllim rritjen e koordinimit dhe efikasitetit operacional. Ka shënuar rritje të qëndrueshme të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë me autoritetet e huaja, çka reflekton një nivel më të lartë besimi dhe efektiviteti të bashkëpunimit ndërinstitucional. Kështu në mënyrë specifike, në vitin 2025, kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit u rritën me 35.7%, prej të cilave 66.3% e tyre u ekzekutuan brenda vitit raportues.

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMINALITETIT

Në funksion të zbatimit të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2025, Prokuroria e Posaçme sqaron si më poshtë:

Rekomandimi 1 - Sundimi i ligjit dhe të drejtave të njeriut, Prokuroria e Posaçme ka vendosur theks të veçantë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe garantimin e sundimit të ligjit në çdo veprim procedural duke u bazuar në parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve, sigurimin e drejtësisë të paanshme dhe trajtim të barabartë të të gjithë palëve.

Të dhënat statistikore tregojnë një qasje më të balancuar dhe më proporcionale të Prokurorisë së Posaçme në aplikimin e masave të sigurimit për veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit, në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë. Megjithatë, masa e arrestit me burg mbetet një instrument i rëndësishëm në çështjet me rrezikshmëri të lartë, vërehet rritje graduale e përdorimit të masave më pak kufizuese të lirisë, si detyrimi për paraqitje dhe ndalimi i daljes jashtë vendit, veçanërisht në vitet 2024–2025, si dhe një numër i konsiderueshëm procedimesh të ndjekura pa masë sigurimi. Kjo prirje dëshmon përpjekjet e prokurorisë për të individualizuar masën e sigurimit sipas rrethanave konkrete të çështjes dhe rrezikshmërisë reale të personit nën hetim, duke rezervuar masat më ekstreme për rastet kur ato janë realisht të domosdoshme dhe duke forcuar zbatimin praktik të parimit të proporcionalitetit dhe të prezumimit të pafajësisë.

Në vitin 2025 konstatohet një ulje e ndjeshme e përdorimit të masës së arrestit me burg, nga 236 raste në vitin 2024 në 110 raste në vitin 2025, një reduktim prej rreth 53%, duke reflektuar një qasje më të kujdesshme dhe proporcionale në aplikimin e masave më kufizuese të lirisë, në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë. Po ashtu, në vitin 2025 vërehet një ulje e përdorimit të masës së arrestit në shtëpi me rreth 37%, nga 46 raste në vitin 2024 në 29 raste në vitin 2025, duke reflektuar një vlerësim më të individualizuar të nevojës për masa kufizuese të lirisë dhe një orientim më të madh drejt masave alternative më pak restriktive, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Nga ana tjetër, lidhur me marrëveshjet për pranimin e fajësisë, gjatë vitit 2025 janë dërguar për gjykim 3 kërkesa për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, 2 prej të cilave janë refuzuar nga gjykata. Po kështu, për vitin 2024, ishin dërguar për gjykim 3 kërkesa për miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, 1 prej të cilave është refuzuar nga gjykata.

Rekomandimi 2 - Forcimi i luftës kundër kriminalitetit, Prokuroria e Posaçme ka ndërmarrë gjatë vitit 2025, masa konkrete për rritjen e rolit aktiv të prokurorit, përmirësimin e cilësisë së hetimeve dhe forcimin e ndjekjes penale për veprat penale më shqetësuese për rendin dhe sigurinë publike.

Në drejtim të rritjes së hetimeve të nisura kryesisht, nga 294 procedime penale të reja të regjistruara për vitin 2025, 109 procedime janë të regjistruara kryesisht. Kjo e dhënë përfaqëson rreth 37% të totalit të procedimeve të reja për vitin 2025. Kjo vlerë për vitin 2024 ishte në masën 19.8% (65 hetime të nisura kryesisht në 328 procedime penale të reja të regjistruara për vitin 2025).

Ky tregues pasqyron një angazhim të shtuar për të mos u kufizuar vetëm në referimet e institucioneve të tjera, por për të ushtruar një rol proaktiv në identifikimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Sa i përket luftës kundër korrupsionit, veçanërisht në nivele të larta, gjatë vitit 2025, janë hetuar nga SPAK (procedime të mbartura dhe të regjistruara rishtazi) 27 procedime penale me 30 persona nën hetim/të pandehur, të cilët janë zyrtarë dhe ish-zyrtarë të nivelit të lartë. Hetimet në këto çështje janë zhvilluar duke ndjekur standarde profesionale dhe duke synuar dërgimin për gjykim të rasteve të mbështetura në prova të plota dhe solide.

Sa i përket hetimeve financiare, Prokuroria e Posaçme ka konsoliduar praktikën e kryerjes së hetimit financiar krahas kryerjes së hetimit penal. Gjatë vitit 2025, pranë Prokurorisë së Posaçme janë regjistruar 13 procedime pasurore dhe janë trajtuar 18 referime pasurore, ndaj subjekteve që bien në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, për masat parandaluese kundër pasurisë.

Në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar, gjatë vitit 2025 janë hetuar gjithsej **261 procedime penale** (të regjistruara rishtazi apo të mbartura nga viti 2024), me 445 persona nën hetim. Këto hetime janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë edhe bashkëpunimin ndërkombëtar me shtetet anëtare të BE-së dhe partnerë të tjerë strategjikë, në funksion të goditjes efektive të strukturave kriminale.

Veprat penale që lidhen me zgjedhjet, për vitin 2025 janë hetuar gjithsej 70 procedime penale, me 27 persona nën hetim, duke dëshmuar vëmendjen e shtuar ndaj kësaj kategorie veprash. Për zgjedhjet e vitit 2025, janë regjistruar konkretisht: 46 procedime penale me 9 persona nën hetim që lidhen me zgjedhjet e vitit 2025 dhe 24 procedime penale me 18 persona nën hetim lidhen me zgjedhjet e viteve të mëparshme. Hetimi i këtyre rasteve është trajtuar me përparësi, me synimin për hetim të shpejtë dhe efikas, në funksion të garantimit të integritetit të proceseve zgjedhore.

Në lidhje me format e reja të kriminalitetit, si krimi kibernetik, pastrimi i parave përmes mekanizmave të rinj financiarë, trafiku i qenieve njerëzore, Prokuroria e Posaçme ka rritur vigjilencën hetimore dhe ka orientuar burime drejt ndërtimit të kapaciteteve profesionale dhe përdorimit të teknikave të avancuara të hetimit, përfshirë masat e posaçme hetimore.

Rekomandimi 3 – Rritja e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë, Prokuroria e Posaçme ka vijuar të theksojë rëndësinë e integritetit dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve, duke u mbështetur në normat ligjore dhe etike, që drejtojnë sjelljen profesionale dhe vendimmarrjen e tyre. Këto parime mbeten themelore për funksionimin efektiv të institucionit dhe për ruajtjen e besimit të publikut. Në lidhje me transparencën, është ruajtur një nivel i lartë komunikimi publik dhe informimi i vazhdueshëm. Përveç publikimit të rregullt të akteve, statistikave dhe njoftimeve zyrtare në faqen e internetit, transparenca është garantuar edhe përmes një komunikimi aktiv nga drejtuesi i institucionit. Kështu, gjatë vitit 2025, SPAK ka forcuar ndjeshëm komunikimin me qytetarët, median, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, duke garantuar trajtim korrekt dhe në kohë të kërkesave për informacion dhe zbatimin e Strategjisë së Komunikimit 2025–2028. Publikimi i 114 njoftimeve për shtyp, trajtimi i 170 kërkesave për informacion, si dhe rritja e vizitorëve unik të faqes zyrtare me 32.3% (nga 82,766 në 109,496) dhe e shikimeve me 28.7% (nga 437,882 në 563,453), reflekton një angazhim të fortë për rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit publik, tek SPAK.

Në kuadër të forcimit të integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale, Prokuroria e Posaçme ka vendosur në qendër të veprimtarisë së saj, mekanizma të qëndrueshëm të verifikimit të integritetit dhe transparencës. Në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 95/2016, për çdo të punësuar pranë SPAK kryhet në mënyrë të rregullt dhe korrekte **veting-u i pasurisë dhe integritetit nga Komisioni i Posaçëm** për Verifikimin e Figurës dhe Integritetit të Kandidatëve. Ky proces shërben si mekanizëm i vazhdueshëm kontrolli dhe parandalimi, duke garantuar që standardet e integritetit dhe profesionalizmit të mos kufizohen vetëm në procesin e veting-ut të reformës në drejtësi, por të jenë pjesë integrale e funksionimit të përditshëm të institucionit.

Rekomandimi 4 - Sigurimi i efijencës dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2025, filloi implementimin e **Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve Elektronike**, si një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të veprimtarisë së SPAK. Gjatë kësaj periudhe, u vunë re, përmirësime të vazhdueshme të funksionaliteteve të sistemit, bazuar në nevojat operationale të institucionit, si dhe përfundoi zhvillimi dhe implementimi i **modulit të referimit dhe procedimeve pasurore dhe modulit të statistikave**, i ndërtuar sipas formatit zyrtar të raportimit për kallëzimet dhe evidencën e procedimeve penale. Moduli i statistikave mundëson gjithashtu **identifikimin dhe monitorimin e backlog-ut të çështjeve**, duke kontribuar në rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe planifikimit më efikas të burimeve.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2025, ka miratuar dhe ka nisur zbatimin e Strategjisë për Uljen e Çështjeve të Mbartura, e cila tashmë ka dhënë rezultatet e para në reduktimin e backlog-ut. Kjo strategji ka orientuar punën drejt menaxhimit më efektiv të çështjeve, përmirësimit të organizimit të brendshëm dhe përdorimit më racional të burimeve. Gjithashtu, i është dhënë prioritet sigurimit dhe përmirësimit të mjeteve teknike të nevojshme për hetimin modern, si dhe përdorimit në rritje të teknikave dhe njohurive të posaçme që kërkohen për trajtimin e veprave penale komplekse, përfshirë korrupsionin, krimet financiare, krimet kibernetike dhe krimin e organizuar. Programet e trajnimit për prokurorët dhe hetuesit janë intensifikuar, duke përfshirë bashkëpunime me institucione dhe partnerë vendas dhe të huaj. Qëllimi i këtyre trajnimeve është, rritja e kapaciteteve profesionale, unifikimi i standardeve të praktikave hetimore dhe përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të procesit hetimor.

Rekomandimi 5 – Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit, Prokuroria e Posaçme ka shtuar përdorimin e teknikave bashkëkohore dhe metodave të posaçme të hetimit, veçanërisht në çështjet me kompleksitet të lartë, duke u orientuar drejt zbatimit të standardeve më të avancuara ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Prokuroria ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe ka aplikuar teknologji të reja, me qëllim analizimin dhe kryqëzimin e të dhënave në mënyrë më të shpejtë e më efikase. Gjithashtu, është zgjeruar përdorimi i metodave moderne si: hetimet proaktive të bazuara në inteligjencën kriminale, teknikat e mbikëqyrjes elektronike, përgjimet, analizat financiare dhe hetimi pasuror dhe teknologjitë digjitale për menaxhimin e provave. Njëkohësisht, po përdorën më shumë programet dhe sistemet për analizën e të dhënave, duke lejuar një përpunim më efikas të informacionit dhe një orientim më të saktë të hetimeve ndaj aktiviteteve kriminale.

Rekomandimi 6 - Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme gjatë periudhës raportuese, ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, duke mbuluar një gamë të gjerë fushash me rëndësi të veçantë për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe procesin e integritetit evropian të vendit. Prokuroria e Posaçme ka dhënë kontribut të rregullt në proceset e raportimit lidhur me integritetin në BE, duke ofruar të dhëna të sakta, analiza dhe komente mbi zbatimin e standardeve dhe kërkesave në fushën penale.

Një element i rëndësishëm i bashkëpunimit ka qenë, përfshirja aktive e Prokurorisë së Posaçme në hartimin e udhëzuesit për mbajtjen e statistikave të sistemit të drejtësisë dhe në zhvillimin e metodologjisë së përbashkët për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, duke kontribuar me ekspertizë praktike dhe institucionale. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka dhënë sugjerime dhe komente të detajuara, për akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore, si pjesë e procesit të hartimit dhe rishikimit të politikave të përgjithshme penale. Në vijim, ky bashkëpunim ka përfshirë edhe shkëmbimin periodik të të dhënave statistikore, me synimin e unifikimit të burimeve të informacionit dhe rritjes së cilësisë së vendimmarrjes strategjike. Njëkohësisht, është forcuar koordinimi me Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror për çështjet e ndihmës juridike ndërkombëtare, me synimin për të rritur eficiencën në ekzekutimin e kërkesave për ekstradime, letërporosi apo formave të tjera të bashkëpunimit penal ndërkombëtar.

Rekomandimi 7 - Sa i përket Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, Prokuroria e Posaçme ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, i cili ka qenë i fokusuar kryesisht në shkëmbimin e informacionit dhe adresimin e përbashkët të çështjeve prioritare. Po ashtu, është intensifikuar bashkëveprimi me organet shtetërore si, me Ministrinë e Brendshme dhe institucionet ligjzbatuese, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), çka ka sjellë rritje të efektivitetit në shkëmbimin e të dhënave, si edhe në analizën operative.

Gjatë këtyre muajve, rëndësi të veçantë ka zënë bashkëpunimi lidhur me përgatitjet për procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga MONEYVAL-i për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Prokuroria e Posaçme ka marrë pjesë aktive në përgatitjen e pyetësorëve teknikë dhe atyre të efektivitetit, si edhe në shkëmbimin e informacionit dhe statistikave përkatëse, në koordinim të ngushtë me AIF dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Gjatë hetimit të krimit zgjedhor, u zhvillua një bashkëpunim i ngushtë dhe i frytshëm me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përmes marrëveshjeve të posaçme. Këto dokumente lehtësuan trajtimin e çështjeve, shkëmbimin e të dhënave dhe reagimin në kohën e duhur.

Në tërësi, bashkëpunimi ndërinstytucional ka shënuar rritje të dukshme, si në aspektin e shkëmbimit të informacionit, ashtu edhe në ndërveprimin operativ, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit të punës, forcimin e kapaciteteve dhe realizimin e një politike penale më të qëndrueshme, të koordinuar dhe koherente.

Rekomandimi 8 - Bashkëpunimi ndërkombëtar, Prokuroria e Posaçme ka vijuar dhe forcuar ndërveprimin me autoritetet e huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndjekjen e krimit të organizuar dhe krimit ndërkufitar. Ky bashkëpunim përfshin shkëmbimin e informacionit, koordinimin e hetimeve dhe ndarjen e provave me shtetet anëtare të Bashkimit Europian agjencitë europiane, përfshirë Europol, Eurojust dhe platformën multidisiplinare EMPACT, me fokus të veçantë në krimin kibernetik, pastrimin e parave dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Për më tepër, është shtuar krijimi dhe funksionimi i skuadrave të përbashkëta hetimore ndërkombëtare, të cilat lejojnë bashkëpunimin në kohë reale në trajtimin e rasteve komplekse apo ndarjen e provave. Ky angazhim ka rritur kapacitetet operative dhe ka mundur një reagim më të shpejtë dhe të koordinuar në hetimin e çështjeve me karakter ndërkombëtar, ka rritur efektivitetin në ndjekjen e krimit të organizuar dhe fenomeneve kriminale transnacionale.

SITUATA E KRIMINALITETIT

Ky kapitull paraqet një vlerësim të përmbledhur të prirjeve kryesore të krimit të organizuar dhe korrupsionit të funksionarëve të lartë publikë. Në dallim nga raportimet e mëparshme, fokusi i këtij viti është vendosur tek format komplekse të veprave të rënda penale në kuadër të krimit të organizuar, të cilat sjellin pasoja të konsiderueshme për shoqërinë, si dhe tek disa nga mekanizmat më të spikatur të veprave penale në fushën e korrupsionit. Analiza mbështetet në të dhënat e hetimeve dhe çështjeve të dërguara për gjykim dhe synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe shpjeguese të tendencave kryesore dhe jo thjesht një paraqitje numerike të situatës së krimit të organizuar. Të dhënat e detajuara dhe treguesit statistikorë do të paraqiten në kapitujt vijues, sipas sektorëve përkatës.

KRIMI I ORGANIZUAR

Gjatë vitit 2025, vihet re se, aktiviteti i grupeve kriminale ka shfaqur një nivel të lartë organizimi, specializimi dhe të shtrirjes ndërkombëtare, veçanërisht në trafikimin e kokainës dhe drogave të tjera drejt tregjeve të BE-së. Këto grupe kanë operuar përmes zinxhirëve të mirëorganizuar të furnizimit, transportit, magazinimit, shpërndarjes dhe transferimit të përfitimeve financiare, duke shfrytëzuar rrugët detare, ajrore, tokësore dhe infrastrukturën financiare ndërkombëtare.

Veprimtaria kriminale karakterizohet nga një ndarje e qartë e roleve, përdorimi i komunikimeve të enkriptuara, krijimi i subjekteve tregtare fiktive. Po ashtu, trafiku i narkotikëve është ndërthurur me forma të tjera të korrupsionit, pastrimit të parave, duke rritur ndjeshëm rrezikshmërinë dhe

kompleksitetin e grupeve kriminale, që veprojnë në Shqipëri, apo atyre që drejtohen ose dominohen nga shtetas me kombësi shqiptare, jashtë vendit. Vihet re se, shumica e aktiviteteve të rënda kriminale të këtyre grupeve zhvillohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa Shqipëria përdoret kryesisht për pastrimin e produkteve të veprës penale, si vend tranziti, rekrutimi dhe qendër koordinimi, e aktiviteteve kriminale kryesore.

TRAFIKU I NARKOTIKËVE

Hetimet e SPAK për vitin 2025 tregojnë se trafiku i narkotikëve vijon të mbetet një aktivitet i rëndësishëm i drejtuar/kontrolluar nga grupe kriminale me shtetas shqiptarë dhe bashkëpunëtorë të huaj. Ky aktivitet kriminal përfshin trafik ndërkombëtar, shpërndarje dhe metoda të sofistikuar fshehjeje dhe transporti të sasive të mëdha të narkotikëve. Në seksionin e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje e *modus operandi* të grupeve kriminale dhe rolit të tyre në trafikun e narkotikëve.

Trafiku i kokainës

Edhe hetimet e këtij viti tregojnë se, grupet kriminale të trafikut të kokainës kanë sofistikuar metodat që lidhen me organizimin, ndarjen e qartë të roleve dhe mënyrat e transportit. Droga vinte në Kolumbia dhe Ekuadori dhe transportohej drejt Evropës, duke u shpërndarë më pas përmes porteve të Italisë, Spanjës, Belgjikës dhe Holandës, si dhe nëpërmjet rrugëve tokësore drejt Francës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Fshehja e sasive të mëdha të lëndës narkotike bëhej në kontenjerë, automjete me vende të përshtatura për të fshehur dhe maskuar mallin. Kokaina fshihej në paleta druri, kuti me fruta dhe thasë kakaoje dhe transportohej shpesh përmes subjekteve tregtare fiktive, me dokumente të falsifikuara. Veprimet hetimore kanë treguar se, aktivitet kriminale që e kishin origjinën nga Shqipëria, shtriheshin në disa qytete evropiane njëkohësisht, duke treguar ndarje funksionesh dhe shtrirje territoriale të rrjeteve.

Struktura operationale e grupeve ishte gjysmë-hierarkike dhe drejtuesit koordinonin financimin dhe rrugët e kalimit ndërkombëtar, ndërsa anëtarët e tjerë ishin përgjegjës për transportin, magazinimin dhe shpërndarjen e drogës në nivel lokal. Pagesat kryheshin kryesisht me *cash*, përmes sistemeve informale të transferimit të pagesave (Havala) dhe përdorimit të kriptovalutave. Të ardhurat shpesh maskoheshin përmes investimeve në kompani ndërtimi, subjekte tregtare të ndryshme, restorante dhe pasuri të paluajtshme. Komunikimi brenda rrjetit ishte i koduar nëpërmjet platformave të enkriptuara, duke përfshirë planifikimin e dorëzimeve dhe paralajmërimet për kontrollle.

Hetimet kanë evidentuar gjithashtu se, grupet kriminale të kontrolluara nga shtetas shqiptar kishin arritur të siguronin akses në porte dhe dogana përmes korrupsionit, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shtete të ndryshme të Evropës. Bashkëpunimi ndërkombëtar me Eurojust, Europol, si dhe me autoritetet e Italisë, Zvicrës, Francës, Holandës, Belgjikës, Malit të Zi, Turqisë dhe Ekuadorit, ka mundësuar sekuestrimin e sasive të konsiderueshme të drogës dhe aseteve financiare të lidhura me to. Hetimet kanë dokumentuar dhjetëra episode trafiku dhe qindra kilogramë kokainë, duke vënë në dukje rolet e drejtuesve, financuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë në rrjet.

Kultivimi dhe trafiku i kanabisit

Hetimet kanë treguar gjithashtu se, kultivimi dhe trafiku i kanabisit mbeten ende aktivitete të përhapura tek grupet kriminale të drejtuara nga shtetas shqiptarë, shpesh në bashkëpunim me shtetas të huaj dhe me përfshirje të punonjësve të policisë. Kultivimi realizohet në parcelat e brendshme dhe sera të izoluara në zona rurale, të ndara sipas funksioneve të mbjelljes, tharjes dhe përpunimit. Grupet kriminale përdornin banesa të marra me qira dhe sera të ndërtuara për këtë qëllim, ku për çdo parcelë kishte persona të caktuar për kultivimin e bimëve. Transporti bëhej përmes rrugëve alternative për të shmangur kontrollet kufitare, duke përdorur arka plastike dhe thasë të mëdhenj për paketimin dhe ruajtjen e drogës. Kultivimi i kanabisit ka qenë i përqendruar kryesisht në, Malësinë e Madhe, Sarandë dhe zonën Tepelenë/Gjirokastrë, ndërsa sasi të konsiderueshme janë trafikuar drejt Greqisë, Malit të Zi, Turqisë, Finlandës dhe Zvicrës.

Struktura e grupeve funksionon vertikalisht, me role të qarta, ku në krye qëndronte drejtuesi, financuesi, personat përgjegjës për kultivimin, transportuesit dhe shpërndarësit, ndërsa aktiviteti zhvillohet sipas fazave të qarta operacionale, mbjellje, kultivim, tharje, përpunim, transport dhe shpërndarje. Pagesat për qira dhe shërbime kryheshin fshehurazi, me para në dorë (*cash*) ose transferime të maskuara, ndërsa komunikimi brenda grupit realizohet kryesisht përmes platformave të enkriptuara, duke siguruar koordinim të transportit dhe shpërndarjes. Hetimet kanë treguar se, në disa raste, janë përfshirë edhe punonjës të policisë, të cilët merrnin pjesë në shkëmbimin e përfitimeve të paligjshme duke ofruar mbrojtje ose duke dhënë informacion mbi kontrollet e forcave të rendit.

Drogat sintetike

Drogat sintetike nuk janë ndër produktet kryesore të aktivitetit të grupeve kriminale shqiptare. Megjithatë, në episodet e pakta të evidentuar gjatë hetimeve të SPAK është vërejtur se, ato trafikoheshin kryesisht nga grupe kriminale me aktivitet ndërkombëtar të drejtuar nga shqiptarë, të cilët tregtonin droga të llojeve të ndryshme dhe nuk ishin të specializuar në trafikimin e një droge të fortë të vetme. Në një rast të dokumentuar, disa grupe të strukturuar kriminale shqiptare, në bashkëpunim me shtetas finlandezë, evropianë dhe aziatikë, trafikonin dhe shpërndanin lloje të ndryshme lëndësh narkotike si, kokainë, kanabis, përfshirë dhe droga sintetike, amfetaminë, ekstazi dhe substanca të tjera psikotrope. Lëndët narkotike transportoheshin nga Holanda dhe Spanja dhe shpërndaheshin në qytetin e Helsinkit dhe qytete të tjera të Finlandës, përmes një rrjeti të organizuar shpërndarësish, që siguronte dorëzimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Karakteristikë e këtyre grupeve ishte bashkëpunimi mes tyre për realizimin e qëllimeve kriminale, si dhe kryerja e veprimeve të disa anëtarëve edhe për llogari të grupeve të tjera.

VRASJET

Hetimet e përbashkëta me autoritetet ndërkombëtare kanë dokumentuar se, vrasjet e sofistikuara përbejnë një aktivitet tjetër karakteristik të disa grupeve kriminale shqiptare, të procedura gjatë këtij viti. Shpesh, vrasjet me pagesë ishin të lidhura me hakmarrje dhe konflikte mes grupeve kriminale. Struktura operative e këtyre grupeve ishte hierarkike, ku drejtuesi koordinonin planifikimin e ekzekutimeve dhe anëtarët siguronin ekzekutorë, armë, dhe mjete eksplozive për realizimin e krimeve. Veprimtaria e këtyre grupeve përfshinte: ekzekutime me armë zjarri,

shpërthime të automjeteve me eksploziv, tentativa për eliminimin e kundërshtarëve, fshehje të kufomave dhe sigurimin e mjeteve materiale.

Një aspekt i veçantë i hetimeve ka qenë dokumentimi i lidhjes mes vrasjeve me pagesë dhe pastrimit të parave të përftuara nga aktiviteti i trafikut të drogës, që vinte kryesisht nga Amerika e Jugut drejt Evropës dhe Shqipërisë. Paratë përdorshin për pagesa për ekzekutorët, blerje armësh, investime në sektorin a pasurive të patundshme dhe aktivitete private tregtare. Hetimet evidentuan gjithashtu, përdorimin e komunikimeve të koduara për planifikimin e ekzekutimeve, paralajmërimet për kontrole dhe koordinimin logjistik. Grupet kriminale kryenin veprime të koordinuara në kohë dhe vend të caktuar, duke rrezikuar jo vetëm jetën e kundërshtarëve, por edhe atë të personave të pafajshëm, që ndodheshin në vendngjarje.

TRAFIKU I ARMËVE

Trafiku i armëve vazhdon të mbetet një fenomen shqetësues, sidomos kur grupet kriminale të përfshira në këtë aktivitet janë të lidhura me rrjetet e trafikut ndërkombëtar. Një nga rastet e provuara nga SPAK ilustron qartë tipologjinë dhe sofistikimin e këtyre grupeve.

Hetimet zbuluan se, grupi kishte ndërtuar një skemë të sofistikuar logjistike dhe operacionale për të dërguar armë në Mbretërinë e Bashkuar. Disa ambiente në periferi të Tiranës shërbenin për fshehjen e armëve brenda pjesëve të mobilieve, ndërsa anëtarët e grupit kriminal siguronin që ato të mbeteshin të padukshme për kontrollet policore dhe doganore. Për të shmangur zbulimin, grupi përdorte dokumente dhe gjeneralitete të rreme gjatë transportit dhe dorëzimit të armëve, duke e mbajtur aktivitetin nën kontrollin e plotë të organizatorëve.

Struktura organizative e grupit ishte e ndarë në dy nëngrupe të qarta, njëri vepronte në Shqipëri dhe tjetri në Mbretërinë e Bashkuar. Nēngrupi shqiptar ishte përgjegjës për mbledhjen, fshehjen dhe transportin e armëve, ndërsa nëngrupi i vendosur në Mbretërinë e Bashkuar merrej me pritjen dhe shpërndarjen e tyre. Bashkëpunimi mes nëngrupeve garantonte suksesin e veprimeve dhe të organizimit dhe shmangien e kapjes nga agjencitë ligjzbatuese. Çdo anëtar kishte role të qarta dhe të ndara, duke përfshirë drejtimin, mbikëqyrjen, transportin, pritjen dhe sigurimin e armëve gjatë gjithë zinxhirit të trafikut.

EMIGRIMI I PALIGJSHËM

Ky aktivitet kriminal (*ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*) përfaqëson një formë të krimit të organizuar me shtrirje ndërkombëtare, me shkallë të lartë planifikimi dhe përfitimi material. Hetimet e zhvilluara kanë provuar ekzistencën e disa grupeve të strukturuar kriminale, të përbëra nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, të cilat gjatë 4 viteve të fundit kanë organizuar kalimin e paligjshëm të kufijve për shumë persona, si shtetas të huaj nga kontinentet e Azisë dhe Afrikës drejt vendeve të Bashkimit Evropian, dhe shtetas shqiptar drejt Mbretërisë së Bashkuar, Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë.

Në rastet e emigrimit të paligjshëm të shtetasve të huaj, ata rekrutoheshin në vendet e origjinës, kryesisht nga vendet e Azisë së Jugut dhe Afrikës Qendrore, përmes agjencive që operojnë në Emiratet e Bashkuara (Dubai) apo edhe në Kamerun. Shqipëria është përdorur si vend tranzit, ku hyrja realizohej në mënyrë formalisht të ligjshme përmes vizave të tipit “D”, të siguruara mbi

bazën e dokumentacionit të falsifikuar për punësim, ndërsa vijimi i itinerarit bëhej në mënyrë të paligjshme përgjatë rrugës ballkanike. Shërbimet e këtyre grupeve kriminale kryheshin përgjatë ciklit të plotë të trafikimit. Skema kriminale përfshinte rekrutimin e personave në vendet e origjinës, ndërmjetësimin fiktiv të punësimit në shoqëri tregtare shqiptare, falsifikimin e kontratave dhe dokumenteve shoqëruese, planifikimin e udhëtimeve ajrore, akomodimin e përkohshëm dhe më pas transportimin tokësor drejt vendeve të BE-së.

Aktiviteti mbështetej nga agjenci udhëtimi që bashkëpunonin mes tyre dhe zyra të posaçme, që shërbenin për të pajisur me dokumente të falsifikuara, ku u sekuestruan vula, pajisje elektronike dhe shuma të konsiderueshme parash. Pagesat për këtë “shërbim” varionin nga 6.000 deri në 8.000 euro për person dhe realizoheshin kryesisht jashtë territorit shqiptar, me transferime të mëvonshme përmes sistemeve informale të pagesave.

Një tjetër formë lidhet me trafikimin e paligjshëm drejt SHBA-ve, ku grupet kriminale organizonin itinerare komplekse përmes Evropës dhe Amerikës Latine. Pagesat për këto skema arrinin deri në 40.000–45.000 dollarë amerikan për person dhe përfshinin sigurimin e dokumenteve false, transportin ajror dhe tokësor, si dhe akomodimin në vendet tranzit. Hetimet kanë dokumentuar gjithashtu, shmangien e qëllimshme të regjistrimit të hyrje-daljeve kufitare, duke evidentuar cenimin serioz të integritetit të sistemeve të kontrollit kufitar.

MASHTRIMI NËPËRMJET MIKROKREDIVE

Hetimet kanë treguar se kjo veprimtari kriminale ka aplikuar skema financiare të sofistikuar me pasoja të rënda për shtetasit, viktimat të këtij krimi. Në një rast të vitit 2024, skema e mikrokredive është zhvilluar përmes disa shoqërive që kanë vepruar në mënyrë të koordinuar si një strukturë e vetme, me tipare të qarta të grupit të strukturuar kriminal. Subjektet dyshohet se, ndanin të njëjtat ambiente, sisteme kompjuterike dhe burime njerëzore, financonin njëri-tjetrin dhe vepronin me të njëjtën strategji operacionale për më shumë se nëntë vite. Mekanizmi kryesor dyshohet se, konsistonte në shumëfishimin e paligjshëm të detyrimeve përmes interesave dhe kamatave shumë të larta, ristrukturimin fiktiv të kredive dhe transferimin e detyrimeve të familjarë apo të afërm që nuk kishin qenë palë në marrëdhënien fillestare kontraktore, si edhe përmes procedurave të ankandeve fiktive.

Zbatimi i skemës dyshohet se është mbështetur në presion sistematik ndaj debitorëve përmes njoftimeve të paligjshme, telefonatave kërcënuese dhe bllokimit afatgjatë të llogarive bankare. Paralelisht, janë përdorur procedura ankandi fiktive për kalimin e pasurive të paluajtshme në favor të subjekteve financiare të përfshira, edhe për detyrime minimale. Në tërësi, veprimtaria paraqet një model të organizuar abuzimi financiar me ndikim të gjerë ekonomik dhe social, që dyshohet se ka synuar përfitim të paligjshëm në dëm të një numri të madh qytetarësh.

KONTRABANDA E CIGAREVE

Kontrabanda e cigareve paraqitet si një fenomen me rrezik të lartë, sidomos kur realizohet në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, që kombinon aktivitetin prodhues, mbulimin tregtar dhe manipulimin e procedurave doganore.

Një nga rastet e hetuara gjatë vitit 2025 ilustron qartë tipologjinë dhe mënyrat e funksionimit të kësaj skeme. Ka dyshime për një mekanizëm të organizuar, që përdorte subjekte prodhuese të licencuara dhe regjime të veçanta doganore, për përpunim, për eksport, me qëllim shmangien e detyrimeve fiskale. Në dokumentacion dyshohet se, paraqiteshin kontrata fasonerie me porositis të huaj dhe destinacione eksporti, ndërsa në praktikë destinacioni ndryshohej pas deklarimit. Ngarkesat me cigare sipas dyshimeve shkarkoheshin në mënyrë të fshehtë ose ridrejtoheshin drejt vendeve fqinje, pa përmbushur detyrimet e akcizës dhe procedurat reale të eksportit. Për të mundësuar këtë skemë dyshohet se, përdorreshin deklarime të pasakta në sistemet doganore dhe mbulim dokumentar fiktiv. Struktura e grupit ishte e ndarë në role të specializuara, një pjesë merrej me prodhimin dhe dokumentacionin tregtar, një pjesë me procedurat doganore dhe transportin, ndërsa anëtarë të tjerë koordinonin devijimin e ngarkesave dhe shitjen e tyre.

PASTRIMI I PARAVE

Nga analiza e rasteve të hetuara mbi veprimtarinë e grupeve të strukturuar kriminale gjatë viteve të fundit, evidentohet një model i integruar i pastrimit të parave, i lidhur ngushtë me aktivitete kryesore kriminale nga të cilat kanë burimin këto të ardhura kriminale, si trafikimi i narkotikëve, trafikimi i armëve, emigrimi i paligjshëm, trafikimi i qenieve njerëzore dhe skemat mashtruese financiare. Skemat e pastrimit karakterizohen nga diversifikimi i kanaleve të transferimit dhe maskimit të fondeve, duke përfshirë sisteme informale të transferimit të vlerave (Havala), përdorimin e kriptovalutave, qarkullimin intensiv të parasë në dorë (*cash*) dhe fragmentimin e transaksioneve për të shmangur raportimin financiar. Në disa raste konstatohet përdorimi i rrjeteve ndërkombëtare me nyje operationale në disa shtete, ku ndahen funksionet e gjenerimit të të ardhurave kriminale, transferimit të tyre dhe riintegritimit në ekonomi përmes ndërmjetësve dhe strukturave mbuluese. Përdorimi i komunikimeve të enkriptuara dhe i ndërmjetësve të specializuar financiarë rrit nivelin e fshehtësisë dhe vështirëson gjurmimin e këtyre transaksioneve monetare.

Tipare të përsëritura në raste të ndryshme përfshijnë përdorimin e subjekteve tregtare formalisht të ligjshme, si mbulesë për qarkullimin dhe riciklimin e fondeve, ku janë përfshirë zyra të këmbimit valutor, shoqëri transfertash parash, agjenci udhëtimi, subjekte ndërtimi dhe tregtare, si dhe struktura financiare jobankare. Këto aktivitete shërbejnë jo vetëm për depozitimin dhe shpërndarjen e shumave, por edhe për krijimin e dokumentacionit fiktiv. Një karakteristikë e veçantë ishte shpërndarja e përfitimeve brenda rrjeteve; personat që realizojnë transferimin dhe transportin e parave zakonisht përfitonin nga 3 deri 10% të shumës së dërguar, me normë mesatare të zakonshme rreth 5–6% të ndara mes koordinatorëve të vendit të origjinës dhe atyre në vendin pritës, ndërsa transportuesit fizikë marrin shpërblim më të ulët, rreth 1–5% ose pagesë fikse për çdo dërgesë.

Faza përmbyllëse e pastrimit përfshin investime në pasuri të paluajtshme, biznese me qarkullim të lartë *cash* dhe aktivitete tregtare me kontroll të brendshëm të dobët, duke synuar integrimin e të ardhurave kriminale në ekonominë formale. Në tërësi, rastet tregojnë kalimin nga modele sporadike drejt arkitekturave të qëndrueshme dhe shumanshme të pastrimit të parave, të mbështetura nga organizim i sofistikuar, bashkëpunim ndërkombëtar dhe instrumente financiare alternative.

Tabelë Përmbledhëse

Tregjet kriminale	Struktura	Modus operandi	Karakteristikat
Trafiku i kokainës	Strukturë gjysmë-hierarkike; drejtues strategjik; koordinatorë ndërkombëtarë; qeliza logjistike dhe financiare	Sigurim burimi, transport ndërkombëtar, magazinim, shpërndarje me nëngrupe; përdorim komunikimesh të enkriptuara dhe ndërmjetësish	Ndërkombëtarizim i lartë; ndarje funksionesh; korrupsion i punonjësve në pikat kufitare hyrëse (porte, aeroporte, dogana etj.); kanale të shumëfishta të pastrimit të parave
Kultivim & trafik kanabisi	Rrjete më të decentralizuara; bërthama familjare/lokale; mbështetje nga ndërmjetës lokal	Kultivim në zona të izoluara ose ambiente të mbyllura; ruajtje dhe transport tokësor/detar; shpërndarje rajonale	Mbështetje në njohje lokale; përdorim prone private; cikël sezonal
Droga sintetike	Qeliza të vogla teknike; rrjetet shpërndarësish; lidhje fleksibël	Prodhim në laboratorë të fshehtë, shpërndarje përmes rrjeteve urbane, shitje me ndërmjetës	Fleksibilitet i lartë; zhvendosje e shpejtë e bazave; volum i vogël / vlerë e lartë
Trafiku i armëve	Strukturë e rrjetëzuar me ndërmjetës; ndarje furnizim–transport–pritje	Sigurim nga tregje sekondare, fshehje në dërgesa, transport i fragmentuar, dorëzim me pika takimi	Përdorim dokumentesh të falsifikuara; magazina periferike; porosi sipas kërkesës
Emigrimi i paligjshëm	Strukturë shërbimi kriminal; organizatorë, falsifikatorë dokumentesh, shoqërim gjatë lëvizjeve	Sigurim dokumentesh, organizim udhëtimit, kalim në faza	Paketë e plotë “shërbimi”; bashkëpunim me agjenci mbuluese
Mashtrimet financiare (mikrokredi)	Strukturë ligjore e kompanisë; drejtim qendror dhe staf operacional	Kontrata abuzive, shumëfishim detyrimesh, presion dhe njoftime masive, ankande fiktive	Mbulesë ligjore formale; përdorim sistemesh të përbashkëta IT
Vrasje me pagesë	Qeliza të mbyllura; ndarja - porositës, ndërmjetës, ekzekutor	Planifikim, vëzhgim, ekzekutim, tërheqje e shpejtë	Marrëveshje të fshehta; planifikim kompleks me role të ndara; pagesa indirekte

Tregjet kriminale	Struktura	Modus operandi	Karakteristikat
Kontrabanda e cigareve	Grup i strukturuar me ndarje-prodhim, dokumentacion, doganë, transport, shpërndarje	Përdorim subjektesh të licencuara dhe regjimesh përpunimi për eksport; deklarime fiktive; ndryshim destinacioni pas zhdoganimit; devijim ngarkesash dhe tregtim pa akcizë	Shmangie detyrimesh fiskale; manipulim dokumentacioni doganor; përdorim aktiviteteve tregtare (fasoneri) si mbulesë.
Pastrimi i parave	Qeliza financiare të specializuara; ndërmjetës profesionalë; Rrjet besimi, me nyje në disa shtete; koordinator qendror	Fragmentim transaksionesh, sisteme informale transfertash, investim në biznese me para në dorë (cash)	Shumëllojshmëri kanalesh; përdorim subjektesh mbuluese. Pagesa pa gjurmë bankare direkte; shpejtësi e lartë; komision në % për operatorët

MATJA E RISKUT

Analiza krahasimore e treguesve

Të dhënat për vitin 2025, krahasuar me vitin e mëparshëm, tregojnë një orientim më strategjik të hetimeve të SPAK në luftën kundër krimit të organizuar. Megjithatë, fluksi i çështjeve të reja dhe i personave të regjistruar ka pësuar një ulje, rritja e personave në hetim dhe e atyre të dërguar në gjykatë tregon një fokus më të madh tek procedimet më komplekse dhe me pasoja më të rënda për shoqërinë. Ngarkesa totale dhe stoku i çështjeve mbeten të qëndrueshme, ndërsa rritja e pezullimeve reflekton nivelin e lartë të kompleksitetit, për shkak të shtrirjes ndërkombëtare të veprimtarisë kriminale të krimit të organizuar, të drejtuar nga shtetas shqiptar.

Treguesit Kryesorë të Hetimit të Krimit të Organizuar 2024–2025

Të dhënat	2024 Çështje	2024 Persona	2025 Çështje	2025 Persona	Ndryshimi (%) Çështje/Persona	Treguesit kryesorë
Të regjistruara	101	263	74	185	 26.7%  29.7%	Rritje e fokusit tek çështjet ekzistuese dhe procedimet komplekse

Të dhënat	2024 Çështje	2024 Persona	2025 Çështje	2025 Persona	Ndryshimi (%) Çështje/Persona	Treguesit kryesorë
Totali i çështjeve në hetim (të transferuara nga viti paraardhës+ të regjistruara në vitin raportues)	266	400	261	446	 1.9% /  11.5%	Stabilitet në volum pune
Të bashkuara	21	–	15	–	 28.6%	Rritje e thellimit të hetimeve
Të hetuara gjithsej	245	400	246	446	 0.4%  11.5%	Rritje e efijencës në hetim
Dërguar në gjykatë	21	134	18	183	 14.3%  36.6%	Fokus tek përfundimi i çështjeve komplekse
Kërkesë për pushim	8	8	4	3	 50%  62.5%	Rritje e përzgjedhjes strategjike në hetim
Transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	13	–	7	2	 46.2%	Rritje në konsolidimin e juridiksionit
Pezulluar	16	–	31	–	 93.7%	Rritje e kompleksitetit të gjetjes së provave
Mbartur për hetim për vitin pasardhës	187	258	186	258	 0.5%	Stok i qëndrueshëm

Vlerësimi i riskut për veprat penale të terrorizmit

Të dhënat krahasuese për periudhën 2024 dhe 2025 për terrorizmin paraqesin stabilitet në volumin hetimor, me numër të pandryshuar çështjesh të reja dhe total hetimesh, çka tregon se, veprat penale të kësaj kategorie nuk paraqitën një rrezikshmëri të lartë për vitin raportues. Rritja e lehtë e pezullimeve me rreth 16.7% dhe ruajtja konstante e stokut të mbartur tregojnë qasje të stabilizuar procedurale dhe verifikim të thelluar të informacionit operativ.

Treguesit	2024	2025	Ndryshimi
Çështje të regjistruara	9	9	-
Totali çështjeve në hetim (të transferuara nga viti paraardhës+ të regjistruara në vitin raportues)	29	29	-
Çështje të hetuara	29	29	-
Dërguar në gjykatë	1	0	-
Transferuar në juridiksion të përgjithshëm	1	1	-
Pezulluar	6	7	▲ 16.7%
Mbartur / transferuar në vitin pasardhës	21	21	-

Profili i riskut sipas veprave penale kryesore të krimit të organizuar

Ndër veprat penale kryesore, nga hetimi i vitit 2025 vihet re se, shumica e tyre kanë tendencë të kryhen në kuadër të grupit të strukturuar kriminal (54%) dhe kjo formë e kryerjes së këtyre veprave penale vijon të mbetet shqetësuese dhe me risk të lartë. Riskun më të madh ndër veprat penale e paraqet trafikimi i narkotikëve (28.4%), pasuar nga pastrimi i produkteve të veprës penale (24.3%). Veprat penale të lidhura me terrorizmin (12%), paçka nivelit të rënies së tyre, konsiderohen me risk mesatar për shkak të ndikimit të tyre në sigurinë kombëtare dhe publike, ndërsa mashtrimi kompjuterik (4.5%) dhe trafiku i qenieve njerëzore (1.4%) kanë risk më të ulët, por kërkojnë monitorim për pasojat sociale dhe karakterin ndërkufitar të tyre. Në tërësi, trafiku i narkotikëve dhe pastrimi i parave në kuadër të krimit të organizuar mbeten vepra penale më me prioritet për SPAK.

Krimi i organizuar dhe Terrorizmi

Vepra Penale	Niveli i Rrezikut	Çështjet	Përqindja e secilës vepër penale në totalin e këtyre grup veprash penale
Neni 333/a – Grup i strukturuar kriminal	● I lartë	74 raste	54%
Neni 283/a – Trafikimi i Narkotikëve	● I lartë	21 raste	28.4%
Neni 287 – Pastrimi i produkteve të veprës penale	● I lartë	18 raste	24.3%
Neni 230 – Terrorizmi	● Mesatar	9 raste	12%
Neni 143/b – Mashtrimi Kompjuterik	● Mesatar	4 raste	4.5%
Nenet 110/a & 128/b – Trafiku i qenieve njerëzore	● I ulët	1 rast	1.4%

KORRUPSIONI

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se, korrupsioni në institucionet publike dhe në sistemin e drejtësisë mbetet një fenomen shqetësues, i cili përfshin, funksionarë vendorë dhe administrativë, si edhe prokurorë, gjyqtarë, punonjës policie. Ky fenomen përdoret për përfitime personale, manipulim të procedurave ligjore dhe keqpërdorim të fondeve publike, si dhe për pastrim të të ardhurave të paligjshme, duke minuar integritetin e institucioneve dhe besimin e publikut. Disa nga format kryesore të korrupsionit të evidentuara gjatë vitit 2025, janë përshkruar, si më poshtë.

Korrupsioni i funksionarëve të drejtësisë

Treguesit e vitit 2025 tregojnë se, korrupsioni në sistemin e drejtësisë përfshin individë me funksione publike, përfshirë prokurorë, gjyqtarë, oficerë të policisë gjyqësore dhe avokatë. Në disa raste, këta individë kishin kërkuar ose pranuar përfitime të paligjshme për të favorizuar pozita procedurale ose për të lehtësuar masa sigurie ndaj personave të akuzuar. Përfitimet nuk lidheshin me shërbime profesionale, por përdorshin si instrument ndikimi ndaj vendimeve të drejtësisë. Përveç përfitimeve materiale, keqpërdorimi i funksioneve zyrtare, si mosreferimi i veprimeve korruptive ose devijimi nga procedurat ligjore, lehtësonte shmangien nga përgjegjësia penale, duke minuar integritetin e institucioneve dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Manipulimi në procedurat e prokurimit publik

Hetimet kanë evidentuar se, procesi i prokurimit publik manipulohet në çdo fazë, nga përgatitja e dokumentacionit deri tek ekzekutimi i kontratave. Titullarët e autoriteteve kontraktuese dhe zyrtarët përgjegjës hartonin specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondeve në favor të operatorëve të caktuar, ndërsa ofertat e konkurrentëve keq vlerësoheshin ose eliminoheshin/skualifikoheshin qëllimisht. Kontrolli formal shpesh nuk ishte kryer nga personat kompetentë, duke lejuar një përputhje të planifikuar mes operatorit të preferuar dhe procedurës, ndërsa shpërndarja e fondeve është bërë për shërbime të sajura ose të zmadhuara artificialisht, duke përfshirë edhe projekte me donatorë ndërkombëtarë. Si rezultat, procesi i prokurimit ka funksionuar jo si një instrument i ligjshëm për investime publike, por si mekanizëm për shpërdorim fondesh dhe përfitime të paligjshme, duke cenuar barazinë dhe transparencën.

Korrupsioni i funksionarëve publikë

Hetimet kanë treguar se, korrupsioni në institucionet publike është i strukturuar dhe i planifikuar, duke përfshirë funksione të ndryshme administrative dhe publike. Në rastet e prokurimeve dhe legalizimeve të pronave, zyrtarët përfitonin nga ana monetare për të favorizuar procedurat, duke bashkëpunuar me operatorë ekonomikë dhe duke manipuluar dokumentacionin dhe fondet limit të tenderave. Në sektorin e policisë dhe kontrollit doganor, skemat përfshinin korrupsion aktiv dhe pasiv, ku shpërblimet jepeshin për të shmangur kontrollet dhe për të lehtësuar aktivitetet e paligjshme. Këto veprime siguronin rezultate të parapërcaktuara dhe kanë cenuar konkurrencën dhe transparencën në shërbim të interesave të individëve të përfshirë.

Përdorimi i shoqërive tregtare

Përdorimi i shoqërive tregtare si mbulesë për korrupsion dhe pastrimin e produkteve të veprave penale përbën një nga format më të sofistikuar të devijimit të fondeve publike në prokurimet

publike. Skema funksiononte përmes krijimit ose përdorimit të kompanive me pronësi nominale, ku ortakët në dokumente nuk ishin përfituesit realë dhe nuk ushtrojnë kontroll efektiv, ndërsa vendimmarrja mbi tenderat dhe kontratat publike mbetej nën ndikimin e personave të fshehur. Pronësia e kompanive ndryshonte formalisht përmes shitjeve simbolike të kuotave dhe ristrukturimeve të shpeshta, ndërkohë që administratori real mbetej i njëjtë, duke maskuar lidhjet me përfituesit e vërtetë dhe duke shmangur konfliktin e interesit. Fonde të fituara nga kontratat publike shpërndaheshin më pas tek ortakët nominalë përmes dividendëve, ndërmjetësve financiarë dhe investimeve të strukturuara, duke krijuar një rrjet të ndërlikuar për riciklimin e parave dhe duke e kthyer shoqërinë tregtare nga një operator ekonomik në një instrument mbulues për përfitime të paligjshme.

Skemat e Keqpërdorimit të Shoqërive Tregtare

Fazat	Veprimi kryesor	Indikatorët	Qëllimi
1. Krijimi i kompanisë	Themelohet shoqëri me objekt të përgjithshëm/të papërcaktuar qartë	Kapital minimal, koha e themelimit që përkon me marrjen e postit publik	Krijimi i personit juridik për prokurimet publike
2. Maskimi i pronësisë reale	Vendosen ortakë nominalë	Ortakë jo aktivë me mungesë komunikimi, vendime jashtë regjistrat, administrator konstant	Fshehja e përfituesit real
3. Qarkullimi fiktiv i kuotave	Shiten kuota me çmime simbolike	Mospërputhje me asetet/fitimet, ndryshon pronësia. por jo administratori	Fragmentim i gjurmës së pronësisë
4. Fitimi i tenderave publikë	Kompania fiton kontrata publike	Fitime të shumta tenderash publikë, lidhje kohore me poste zyrtarësh	Përthithja e fondeve publike
5. Grumbullimi i fitimit	Fitimi mbahet në kompani	Rritje e shpejtë të ardhurash, pa dividend për vite, rezerva, rritje kapitali	Shmangie e ekspozimit të menjëhershëm
6. Nxjerrja “ligjore” e fondeve	Shpërndahet dividend pas ndryshimit të kuotave	Dividend i menjëhershëm, përfitues formal nga shoqëria tregtare “mbulesë”	Tërheqje fondesh me mbulesë formale
7. Konvertimi në <i>cash</i>	Paratë tërhiqen dhe dorëzohen	Tërheqje të fragmentuara, koordinim, takime fizike, kalimi i fondeve nga shoqëria tregtare “mbulesë” tek individët përfitues	Dalje nga sistemi bankar
8. Kontabilitet paralel	Regjistrohet ndarja reale	Blloqe shënimesh, initiale, përqindje, llogari projektsh	Evidentim i ndarjes reale të përfitimit

Fazat	Veprimi kryesor	Indikatorët	Qëllimi
9. Instrumentet e pastrimit të parave	Maskohet origjina e fondeve	Ndarja e fitimeve të larta të dividendëve, qarkullimi i sasive të mëdha në cash, ndërmjetës, investime, rritje kapitali, rrimërim kompanish	Vështirësimi i gjurmimit dhe hetimit financiar

KORRUPSIONI I TË ZGJEDHURVE VENDORË

Gjatë hetimeve të vitit 2025, korrupsioni i funksionarëve vendorë u evidentua kryesisht përmes shkëlqes së procedurave ligjore, mosrespektimit të vendimeve administrative dhe miratimit të projekteve infrastrukturore pa verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm, duke shkaktuar dëme për qytetarët dhe institucionet publike. Një dimension tjetër i rëndësishëm ishte shfrytëzimi i fondeve publike për përfitime personale ose të lidhura me të afërmit e tyre, përmes shpërndarjes së parave tek subjekte tregtare të kontrolluara prej tyre, si dhe maskimit të origjinës së tyre përmes transaksioneve të sajura, sponsorizimeve ose blerjeve fiktive. Korrupsioni i të zgjedhurve vendorë u shfaq edhe në konflikte interesi, ku miratoheshin projekte për subjekte ku ata vetë ose të afërmit e tyre kishin interesa materiale, shpesh të fshehura për të shmangur transparencën dhe kontrollin ligjor. Fondet dhe pasuritë e përfituara në mënyrë të paligjshme kalonin përmes OJF-ve, shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, blerjeve online dhe investimeve të strukturuar, duke krijuar një rrjet të ndërlikuar për pastrimin e parave dhe konvertimin e përfitimeve në pasuri të paluajtshme.

Krimi zgjedhor

Hetimet e SPAK-ut për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 zbuluan se, individë të ndryshëm, përfshirë zyrtarë publikë, kryetarët e fshatrave dhe kandidatë politikë, kërkonin ose ofronin përfitime në këmbim të mbështetjes elektorale. Këto përfitime përfshinin shpërblime monetare për votuesit, leje legalizimi të ndërtimeve informale, favore në vendin e punës dhe përfitime të tjera administrative. Në disa zona, zyrtarë të pushtetit vendor përdorën listat e zgjedhësve për të orientuar votuesit dhe për të ofruar përfitime direkte, duke evidentuar modele të koordinuara të ndikimit të paligjshëm në procesin zgjedhor. Hetimet treguan gjithashtu, bashkëpunim mes individëve të përfshirë për të shmangur kontrollin e organeve ligjzbatuese dhe për të mbrojtur strukturën korruptive nga ekspozimi.

Korrupsioni në institucione akademike

Në sektorin akademik janë evidentuar skema korrupsioni të lidhura me sigurimin e fondeve kërkimore dhe prokurimet e projekteve të tyre. Modus operandi përfshinte hartimin e projekteve me përmbajtje fiktive, për të siguruar financim dhe përgatitjen e specifikimeve teknike në bashkëpunim me operatorët ekonomikë që shpallen fitues. Procedurat e prokurimit rezultuan të orientuara që në fazën e ideimit të projektit, ndërsa koordinimi mes drejtuesve akademik, administratorëve dhe strukturave të prokurimit shërbente për të justifikuar fondin limit dhe për të

përdorur oferta të falsifikuara. Në disa raste, procedurat zhvilloheshin pasi pajisjet ishin vendosur paraprakisht, duke kthyer procesin në një formalitet mbulues.

MATJA E RISKUT

Analiza krahasimore e treguesve

Të dhënat për luftën kundër korrupsionit në vitin 2025, krahasuar me vitin e mëparshëm, tregojnë një fokus më të madh dhe qasje strategjike të SPAK, me fluks të qëndrueshëm të çështjeve të reja dhe rritje të numrit të personave në hetim dhe atyre të dërguar në gjykatë. Rritja e kërkesave për pushim dhe ulja e çështjeve të bashkuara reflekton rishikim të kujdesshëm dhe qasje të fokusuar për hetime të thelluara.

Treguesit Kryesorë të Hetimit të Korrupsionit 2024–2025

Të dhënat	2024 Çështje	2024 Persona	2025 Çështje	2025 Persona	Ndryshimi (%) Çështje/Persona	Treguesit kryesorë
Çështje të regjistruara	186	193	183	175	 1.6%  9.3%	Fluks i qëndrueshëm hetimor
Totali çështjeve në hetim (të transferuara nga viti paraardhës + të regjistruara në vitin raportues)	510	257	530	276	 3.9%  7.4%	Rritje e ngarkesës së punës
Të bashkuara	27	—	14	—	 48.1%	Rritje e thellimit të hetimeve
Të hetuara gjithsej	483	257	516	276	 6.8%  7.4%	Rritje e efijencës në hetim
Dërguar në gjykatë	41	141	33	160	 19.5%  13.5%	Fokus tek përfundimi i çështjeve komplekse
Kërkesë për pushim	30	3	49	12	 63.3%  300%	Rritje e vlerësimit të kujdesshëm të cilësisë së kallëzimeve dhe referimeve, me orientim drejt çështjeve me nivel të mundshëm provueshmërie

Të dhënat	2024 Çështje	2024 Persona	2025 Çështje	2025 Persona	Ndryshimi (%) Çështje/Persona	Treguesit kryesorë
Transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm	63	13	44	13	▼ 31.7%	Rritje në konsolidimin e juridiksionit
Pezulluar	5	—	2	—	▼ 60%	Përmirësim i kapaciteteve procedurale
Mbartur për hetim për vitin pasardhës	344	100	389	91	▲ 13.1% ▼ 9%	Rritje e lehte e stokut të çështjeve

Profili i riskut sipas veprave penale kryesore që lidhen me korrupsionin

Disa vepra penale kryesore që lidhen me korrupsionin në vitin 2025, janë kryer në disa raste, në kuadër të krimit të organizuar. Veprat me risk më të lartë të evidentuara nga hetimet e SPAK janë; korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (29.4%), shkelja e barazisë në tendera/ankande publike (23.8%) dhe pastrimi i produkteve të veprës penale (8.7%), ndërsa korrupsioni nga funksionarët e drejtësisë dhe ushtrimi i ndikimit të paligjshëm konsiderohen gjithashtu, veprime me risk të konsiderueshëm për shkak të përfshirjes në disa raste të krimit të organizuar. Vërehet një rënie e lehtë në hetimin e korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë/të zgjedhurve vendorë, por sidoqoftë në një rast është evidentuar lidhja me krimin e organizuar. Në tërësi, korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike dhe shkelje të barazisë në tendera/ankande publike mbeten veprat penale më me risk dhe prioritet për monitorim dhe vlerësim, duke pasur parasysh ndikimin e tyre në administratën publike dhe tendencat e përfshirjes në to edhe të krimit të organizuar.

Korrupsioni

Vepra Penale dhe Përshkrimi	Niveli i Rrezikut	Çështjet për Korrupsion	Çështjet e lidhura me Krimin e Organizuar	Përqindja në totalin e korrupsionit
Neni 287-Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale	🔴 I lartë	11	2	8.7%
Neni 258-Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera/ankande publike	🔴 I lartë	30	2	23.8%
Neni 259-Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	🔴 I lartë	37	0	29.4%

Vepra Penale dhe Përshkrimi	Niveli i Rrezikut	Çështjet për Korrupsion	Çështjet e lidhura me Krimin e Organizuar	Përqindja në totalin e korrupsionit
Neni 245/1-Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	 I lartë	18	1	14.3%
Neni 319-Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë	 I lartë	7	2	5.6%
Neni 319/ç-Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	 I lartë	6	1	4.8%
Neni 260-Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor	 Mesatar – I lartë	4	1	3.2%

ANALIZA KRAHASIMORE E EFEKTIVITETIT 2025

Në këtë pjesë të raportit do të zhvillohet një analizë krahasimore e veprimtarisë së SPAK, duke u fokusuar në efektivitetin në hetim dhe gjykim të çështjeve, si dhe në volumin e punës në hetimin e pastrimit të produkteve të veprave penale.

PROCEDIME ME KALLËZIME DHE REFERIME NGA INDIVIDË DHE INSTITUCIONE

Gjatë vitit 2025, konstatohen në total 131 hetime të filluara me kallëzime dhe referime nga individë dhe institucione, duke ruajtur një trend të ngjashëm me vitin paraardhës (132 hetime). Në ndryshim nga viti 2024, të dhënat statistikore tregojnë se hetimet e filluara me *referime nga Policia e Shtetit*, për vitin 2025 kanë shënuar një rritje me rreth 70%.

Hetimet e filluara me kallëzime nga shtetas, vijnë të mbeten të larta për të tretin vit radhazi.

Për vitin 2025, ato zënë rreth 33.5% të totalit, duke konfirmuar sërish besimin e lartë të publikut tek Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Gjatë vitit 2025, hetimet e filluara me kallëzime nga institucionet publike kanë shënuar një rritje të lehtë, krahasimisht me të njëjtin tregues të vitit 2024.

Ndërkohë, vihet re një rënie e ndjeshme, si për hetimet e filluara me referime nga persona juridikë (me rreth 75%) ashtu edhe për ato të referuara nga subjekte politike (pothuajse e përgjysmuar).

Procedimet sipas burimit të kallëzimit 2021-2025

Hetime	2021	2022	2023	2024	2025	Total
Hetime të filluara me referime nga Policia e Shtetit	68	44	65	30	51	258
Hetime të filluara me referime nga institucionet publike	19	20	12	20	23	94
Hetime të filluara me referime nga subjekte politike	57	10	23	21	10	121
Hetime të filluara me kallëzime nga shtetas	42	28	36	49	44	199
Hetime të filluara me referime nga persona juridik	23	15	9	12	3	62
Total	209	117	145	132	131	734


EFEKTIVITETIT NË HETIM

Të dhënat statistikore për vitin 2025 tregojnë se, edhe gjatë këtij viti efektiviteti në hetim është karakterizuar nga një veprimtari e qëndrueshme dhe e kënaqshme e SPAK, sa i takon *procedimeve penale të reja të regjistruara dhe çështjeve/hetimeve të përfunduara*, paraqitur në mënyrë të përmblendhur për periudhën 2021-2025, në tabelën në vijim:

Çështje të reja	2021	2022	2023	2024	2025
	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje	Çështje
Procedime penale të reja të regjistruara	363	257	299	328	294
Çështjet/hetime të përfunduara	226	196	193	218	216

Nga sa më sipër, konstatohet se, gjatë vitit 2025, janë regjistruar 294 *procedime penale të reja*, duke shënuar një rënie të lehtë krahasimisht me ato të regjistruara gjatë vitit paraardhës, 328 procedime të reja gjatë 2024. Po kështu, raporti mes procedimeve penale të reja të regjistruara dhe çështjeve/hetimeve të përfunduara ka pësuar rritje, nga rreth 66.46% në vitin 2024, në rreth 73.13% në vitin 2025.

Më poshtë, paraqitet analiza krahasimore në formë grafike, e trendit të procedimeve të regjistruara përkundrejt procedimeve të përfunduara, për periudhën 2021-2025.



Volumi i hetimeve penale vijon gjithashtu të shënojë rritje në masën 4.9 % (nga 793 në vitin 2024 në 832 në vitin 2025). Kështu gjatë këtij viti raportues, janë regjistruar nën hetim gjithsej 871 procedime penale, nga të cilat 577 procedime penale janë mbartur nga viti 2024, ndërsa 294 procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2025, si procedime penale të reja. Nga totali prej 871 procedimesh penale, 39 prej tyre janë bashkuar.

MASAT E SIGURIMIT PËR PERSONAT E REGJISTRUAR

Gjatë vitit 2025, në kuadër të politikës penale të ndjekur nga SPAK në lidhje me kërkesat për masa sigurimi, rezulton se janë regjistruar 294 procedime penale, me gjithsej 434 persona të përfshirë.

Shpërndarja e masave të sigurimit sipas veprave penale gjatë vitit 2025, paraqitet si më poshtë:

Masat e sigurimit për personat e regjistruar në vitin 2025

Llojet e masave gjatë vitit 2025	Numri i personave për veprat penale të Krimit të Organizuar	Numri i personave për veprat penale të Korrupsionit	Numri i personave për veprat penale të tjera	Numri i personave të regjistruar për vitin 2025
Masë Sigurimi “Arrest me Burg”	93	15	2	110
Masë Sigurimi “në Mungesë”	58	5	2	65
Masë Sigurimi “Arrest Shtëpie”	18	9	2	29
Masë Sigurimi “Detyrim paraqitje”	6	36	21	63

Masë Sigurimi “Ndalim dalje jashtë vendit”	3	1	8	12
Masë Sigurimi “Pezullim ushtrim detyre”	1	1		2
Masë Sigurimi “Ndalim i Përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”		1		1
Pa masë sigurimi	6	107	39	152
Total	185	175	74	434

Për vitin 2025 vihet re, një rënie e ndjeshme e përdorimit të masës “arrest me burg” dhe zhvendosje drejt masave alternative. Konkretisht, krahasuar me vitin 2024, masa “arrest me burg”, ka pësuar rënie si në vlerë absolute me rreth 53,4 %, (nga 236 raste në vitin 2024, në 110 raste në vitin 2025), ashtu edhe në raport me numrin total të masave të aplikuara (nga rreth 61% në vitin 2024, në rreth 39% në vitin 2025). Prej totalit të rasteve për vitin 2025, rreth 3.45% e tyre lidhen me veprat penale të korrupsionit, ndërsa 21.14% të totalit lidhen me veprat penale të krimit të organizuar.

Rastet “pa masë sigurimi” kanë qenë inekzistente në vitin 2021, duke shënuar rritje të progresive çdo vit. Për vitin 2025 evidentohen 65 raste, të cilat zënë rreth 35% të totalit. Vihet re gjithashtu, rritja e masës “në mungesë” dhe asaj “ndalim dalje jashtë vendit”.

Nga ana tjetër, masa “arrest shtëpie” ka shënuar një rritje graduale deri në vitin 2023 (duke arritur në 51 raste), ndërsa vërehet një rënie në vitet 2024 dhe 2025. Kjo masë duket se, po zëvendësohet nga masa më fleksibël, si “detyrim paraqitje”. Kjo e fundit rezulton me një rritje të ndjeshme ndër vite, nga 8 raste në 2021, në 63 në 2025 (duke u katërfishuar për këtë vit raportues).

Masa “ndalim dalje jashtë vendit”, e cila ka qenë në vlera të ulta deri në vitin 2023, është dyfishuar në krahasim me vitin 2024 (nga 6 në vitin 2024 në 12 në vitin 2025). Kjo masë lidhet shpesh me korrupsionin, ku rreziku kryesor është largimi nga vendi. Masat që lidhen me pezullim ushtrim detyre dhe ndalim veprimtarie, rezultojnë në nivele më të ulëta, ndërkohë që masa e ndalimit të veprimtarive profesionale ka filluar të aplikohet në vitin 2025.

Shpërndarja e masave të sigurimit për personat e regjistruar gjatë vitit 2025, sipas llojit të veprave penale, të pasqyruara në mënyrë grafike, si më poshtë:



Trendi i masave të sigurimit të aplikuara nga SPAK gjatë viteve paraqitet në mënyrë të përmblodhur në tabelën e mëposhtme:

Analiza krahasimore e masave të sigurimit ndër vite

Veprat penale të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit					
Llojet e masave/Viti	2021	2022	2023	2024	2025
Masë Sigurimi Arrest me Burg	127	189	184	236	110 ▼ 53.2%
Masë Sigurimi në Mungesë	0	22	28	38	65 ▲ 71.1%
Masë Sigurimi Arrest Shtëpie	31	37	51	46	29 ▼ 37%
Masë Sigurimi Detyrim paraqitje	8	15	41	53	63 ▲ 18.9%
Masë Sigurimi Ndalim dalje jashtë vendit	1	1	1	6	12 ▲ 100%
Masë Sigurimi Pezullim ushtrim detyre	3	4	1	4	2 ▼ 50%
Masë Sigurimi Ndalim i Përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste					1
Pa masë sigurimi	134	159	73	246	152 ▼ 38.2%
Totali	304	427	379	629	434

VOLUMI I PUNËS NË MBYLLJEN E HETIMEVE

Gjatë vitit 2025, numri total i *çështjeve/hetimeve të përfunduara*, ka vazhduar të jetë i lartë duke ndjekur të njëjtën tendencë me atë të vitit 2024. Vihet re, një rritje e ndjeshme për “*kërkesat për pushim*” dhe “*vendimet e pezullimit*”, ndërkohë që vërehet, një rënie nga i njëjti tregues i vitit 2024 i kërkesave për transferim, 62 kërkesa, gjatë vitit 2025, nga 87 kërkesa për transferim gjatë vitit 2024.

Çështje/ hetime të përfunduara 2021-2025


Çështje/hetime të përfunduara	2021	2022	2023	2024	2025
Kërkesa për pushim	37	38	29	41	58
Vendim pezullimi	34	19	24	27	41
Transferim	107	82	87	87	63
Kërkesa për gjykim	48	57	53	63	54
Totali	226	196	193	218	216

Sa i takon volumit të punës në mbylljen e hetimeve, të dhënat statistikore konfirmojnë edhe për këtë vit, impenjimin e SPAK, për përfundimin e çështjeve/hetimeve. Të dhënat tregojnë një trend në rritje, sa i takon çështjeve/hetimeve të përfunduara edhe gjatë vitit 2025, ku numri total i *çështjeve/hetimeve të përfunduara* është 216, po thuaj i njëjtë me të njëjtin tregues të vitit 2024 (218).

Të dhënat statistikore tregojnë se, edhe gjatë vitit 2025, peshën kryesore në numrin e *çështjeve/hetimeve të përfunduara* e zënë çështjet të cilat janë çuar për “*transferim*” në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, me një tendencë pozitive të uljes së numrit të tyre, nga ku përqindja e çështjeve të transferuara bie nga mesatarja 41–47% në vitet 2021–2024, në 29.2% në 2025.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjeve të trajtuara nga SPAK, vlerësohet se ky tregues, i cili mbetet relativisht i lartë dhe për vitin 2025, tregon jo vetëm qëndrueshmëri në përmirësimin e efektivitetit operacional të SPAK, por dhe qasjen institucionale për përfundimin e çështjeve hetimore, duke ruajtur menaxhimin e qëndrueshëm të volumit të punës.

Shpërndarja e çështjeve/hetime të përfunduara gjatë vitit 2025, pasqyrohet në mënyrë grafike, si më poshtë:




Volumi i hetimit të korrupsionit

Gjatë këtij viti rezultojnë në total 220 *çështje/hetime të regjistruara* kundrejt 156 *çështje/hetime të përfunduara* për vepra penale, që lidhen me korrupsionin. Krahasuar me të njëjtën tregues të vitit 2024, rezulton se, *çështje/hetime të regjistruara* gjatë vitit 2025, kanë shënuar një rritje prej 17.7% krahasimisht me *çështje/hetime të regjistruara* gjatë vitit 2024. Trend rritës kanë shënuar dhe çështjet/hetimet e përfunduara gjatë vitit 2025, duke evidentuar një rritje prej 12.2%, krahasimisht me të njëjtin tregues në vitin 2024. Gjatë vitit 2025, referuar të dhënave statistikore, treguesit e hetimeve të regjistruara kundrejt atyre të përfunduar në kuadër të luftës kundër të *korupsionit*, kanë vijuar të jenë të rritje.

Volumi i hetimit të korrupsionit 2022-2025

Vepra penale	2022		2023		2024		2025	
	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Korrupsion i / Veprat e tjera penale (të reja të regjistruar)								
Numri	178	160	214	150	186	139	220	156

Nga sa më sipër, konstatohet se, numri i çështjeve të përfunduara vazhdon të jetë relativisht i lartë edhe gjatë vitit 2025, duke dëshmuar menaxhim efikas të volumin të punës dhe ruajtjen e balancës mes hetimeve të reja dhe atyre të përfunduara nga SPAK.



Zyrtarët dhe ish-zyrtarët e lartë

Për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2025, janë regjistruar gjithsej **81 persona zyrtarë dhe ish zyrtarë** të lartë. Brenda këtij numri, 11 persona janë regjistruar secili në dy procedime penale të ndryshme, ndërsa 2 persona janë regjistruar secili në tre procedime të ndryshme, çka nënkupton se, numri i regjistrimeve sipas procedimeve është më i lartë se, numri i individëve realë për shkak të përsëritjes së disa personave në më shumë se një procedim.

Vetëm për vitin 2025, janë regjistruar 19 zyrtarë të lartë, nga të cilët 2 persona janë regjistruar secili në dy procedime të ndryshme, duke reflektuar të njëjtin dallim ndërmjet individëve dhe regjistrimeve statistikore.

Gjatë periudhës 1.1.2025 – 31.12.2025, duke përfshirë procedimet e mbartura dhe ato të reja, janë hetuar 27 procedime penale, në të cilat janë përfshirë 30 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë. Këtu përfshihet:

- 1 zëvendëskryeministër
- 1 ish-kryetar Kuvendi
- 1 ish-ministër
- 6 ish-deputetë
- 6 kryetarë bashkie
- 5 ish-kryetarë bashkie
- 2 ish-gjyqtarë *(njëri i regjistruar në dy procedime të ndryshme)*
- 1 ish-prokuror
- 1 kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik
- 1 kryetar i komanduar bashkie
- 1 drejtor
- 4 ish-drejtorë *(tre prej tyre të regjistruar secili në dy procedime të ndryshme)*

Si pasojë e këtyre përsëritjeve, numri statistikor i personave në hetim rezulton 34, ndërsa numri real i personave fizikë nën hetim mbetet 30.⁶

Nga 30 zyrtarë dhe ish zyrtarë ta lartë nën hetim gjatë vitit 2025, mbi 50% e tyre (18) janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim, përkatësisht: 1 ish-kryetar Kuvendi, 5 ish-deputetë, 4 kryetarë bashkie, 2 ish-kryetarë bashkie, 1 ish-gjyqtar, 1 kryetar të komanduar bashkie dhe 4 ish-drejtorë.

Volumi i hetimit të krimit të organizuar

Sa i përket hetimeve mbi veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, gjatë vitit 2025 edhe pse numri i çështjeve/hetimeve të regjistruara është më i ulët krahasuar me vitin 2024, çështjet/hetimet e përfunduara kanë shënuar një rritje me rreth 3.4% (nga 58 në vitin 2024 në 60 në vitin 2025). Ky numër ka vazhduar të rritet (pothuajse duke u dyfishuar krahasuar me të dhënat statistikore të viteve 2022 dhe 2023, siç detajohet në tabelën më poshtë:

Volumi i hetimit të krimit të organizuar 2022-2025

Vepra penale	2022		2023		2024		2025	
Krimi i Organizuar	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara	Çështje/hetime të regjistruara	Çështje/hetime të përfunduara
Numri	79	36	85	43	101	58	74	60

Kjo rritje e numrit të çështjeve/hetimeve të përfunduara, tregon përveçse një përpjekje të shtuar në luftën kundër krimit të organizuar, edhe një përmirësim të vazhdueshëm në menaxhimin dhe përfundimin e hetimeve nga SPAK.

Të dhënat statistikore tregojnë rritjen e angazhimit të SPAK gjatë vitit 2025, për përfundimin e hetimeve në çështjet e lidhura me krimin e organizuar, në kuadër të qasjes së ashpër të institucionit ndaj veprave penale, që lidhen me grupet kriminale të strukturuar, si dhe luftën ndaj krimit të organizuar.

Volumi i hetimit të pastrimit të parave

Gjatë vitit 2025, SPAK ka regjistruar gjithsej 32 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, siç pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Procedime të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal

Neni 287, Kodi Penal	Viti				
	2021	2022	2023	2024	2025
Procedime të regjistruara në kuadër të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”	15	20	35	47	32


⁶ Diferenca prej katër njësis lidhet drejtpërdrejt me regjistrimin e disa individëve në më shumë se një procedim penal. Numri i regjistrimeve statistikore mund të tejkalojë numrin e personave fizikë për shkak të përfshirjes së të njëjtit individ në më shumë se një procedim penal.

Konstatohet se, numri i procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2025, paraqet një ulje krahasuar me vitin 2024, gjatë të cilit u regjistruan 47 procedime penale. Megjithatë, pavarësisht kësaj rënieje, niveli i procedimeve për vitin 2025, mbetet ndjeshëm më i lartë krahasuar me vitet 2021 dhe 2022, duke reflektuar një konsolidim të aktivitetit hetimor të SPAK në këtë fushë.

Analiza e të dhënave për periudhën 2021–2025 tregon se, procedimet e regjistruara për veprën penale “*pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” kanë njohur një rritje progresive dhe të qëndrueshme deri në vitin 2024, duke u trefishuar krahasuar me vitin 2021. Ndërkohë, viti 2025 shënon një qëndrueshmëri dhe stabilizim i këtij treguesi, në krahasim me periudhat fillestare të ciklit pesëvjeçar.

Duhet të theksohet se, procedimet për këtë veprë penale lidhen kryesisht me çështje komplekse, të karakterizuara nga vlera të mëdha financiare, përdorimi i skemave të sofistikuara të pastrimit të parave dhe lidhjet e drejtpërdrejta me veprimtari kriminale të organizuara. Në këtë kontekst, pavarësisht luhatjeve vjetore në numër, fokusi i hetimeve ka qenë i orientuar drejt rasteve me kompleksitet dhe ndikim të lartë financiar.

Të dhënat e analizuara për periudhën 2021–2025 dëshmojnë se, lufta kundër pastrimit të produkteve të veprës penale mbetet një prioritet i qëndrueshëm i SPAK, duke konfirmuar rolin qendror të institucionit në parandalimin dhe ndëshkimin e kriminalitetit të organizuar dhe veprimtarive të lidhura me të.




SEKUESTRIMI DHE KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË VEPRAVE PENALE

Për sa i përket vendimeve për sekuestrim dhe konfiskim të produkteve të veprave penale të hetuara nga SPAK gjatë vitit 2025, të dhënat statistikore tregojnë gjithsej 16 vendime sekuestrimi dhe 8 vendime konfiskimi. Pra vërehet një rënie krahasuar me vitet paraardhëse sikurse paraqitet dhe në tabelën në vijim.

Sekuestrimet dhe Konfiskimet për vitet 2021–2025

Akte Ligjore	2021		2022		2023		2024		2025	
	Sekuestime	Konfiskime	Sekuestime	Konfiskime	Sekuestime	Konfiskime	Sekuestime	Konfiskime	Sekuestime	Konfiskime
Ligji-Anti Mafia	14	4	5	10	8	5	8	3	4	3
Kodi Penal	5	4	7	20	8	20	17	11	12	5
Akt Normativ (OFL)	28	54	0	32	0	14	0	6	0	0
Total	47	62	12	62	16	39	25	20	16	8



Sekuestrimet për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, vërehet një ulje e vendimeve për sekuestrim në kuadër të akteve ligjore “Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009” (Anti-Mafia), “Kodi Penal” dhe “Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 (OFL)”, krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, ky nivel është i ngjashëm, ose më i lartë, ose i krahasueshëm me vitet 2022 dhe 2023.

Sekuestrime për vitet 2021-2025

Akte Ligjore	2021	2022	2023	2024	2025
	Sekuestrime	Sekuestrime	Sekuestrime	Sekuestrime	Sekuestrime
Ligji Anti Mafia	14	5	8	8	4
Kodi Penal	5	7	8	17	12
Akt Normativ (OFL)	28	0	0	0	0
Total	47	12	16	25	16

Në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2025 janë marrë 4 vendime për sekuestrim, duke shënuar një rënie në krahasim me 8 vendime në vitin 2024. Lidhur me sekuestrimin sipas Kodit Penal, gjatë vitit 2025 konstatohet një ulje relative nga 17 vendime në vitin 2024, në 12 vendime në vitin 2025.

Ndërsa sa i takon Aktit Normativ (OFL), gjatë vitit 2025 nuk është regjistruar asnjë vendim për sekuestrim.

Në përfundim, gjatë vitit 2025 konstatohet një stabilizim i aktivitetit për vendimet e sekuestrimeve në nivele më të moderuara, me fokus kryesisht tek Kodi Penal dhe një përdorim më të kufizuar të ligjit Anti-Mafia.

Konfiskimet për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, vërehet një ulje e vendimeve për konfiskim në kuadër të akteve ligjore “ligji nr. 10192, datë 3.12.2009” (Anti-Mafia), “Kodi Penal” dhe “Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 (OFL)”, krahasuar me vitet paraardhëse, siç pasqyrohet në tabelën në vijim:

Konfiskime për vitet 2021–2025

Akte Ligjore	2021	2022	2023	2024	2025
	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime	Konfiskime
Ligji Anti Mafia	4	10	5	3	3
Kodi Penal	4	20	20	11	5
Akt Normativ (OFL)	54	32	14	6	0
Total	62	62	39	20	8

Në kuadër të ligjit Anti-Mafia, gjatë vitit 2025 janë regjistruar 3 vendime për konfiskim, një nivel i qëndrueshëm ky krahasuar me vitin 2024. Sa i përket Kodit Penal, vendimet për konfiskim u reduktuan nga 11 në vitin 2024, në 5 në vitin 2025, duke reflektuar një ulje të moderuar të aktivitetit.

Ndërkaq, lidhur me Aktin Normativ (OFL), gjatë vitit 2025 nuk është regjistruar asnjë vendim për konfiskim.

Në përfundim, gjatë vitit 2025 sa i përket vendimeve për konfiskim, ato duket se, janë përqendruar tek Kodi Penal dhe ligji Anti-Mafia.

Analiza e periudhës 2021–2025 tregon se, kulmi i aktivitetit në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive u shënua në vitet 2021-2022, kjo edhe për shkak të zbatimit në këto vite të Aktit Normativ (OFL).

Vlera e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara

Për vitin 2025, vlera totale e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara arrin afërsisht rreth 45.4 milionë euro. Kjo shifër përfshin asetet e sekuestruara dhe konfiskuara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 (Anti-Mafia), si dhe sipas Kodit të Procedurës Penale. Ndërkohë, nuk rezulton të ketë pasur sekuestrime apo konfiskime në kuadër të Aktit Normativ (OFL).

Nga totali i sipërpërmendur, rreth 1.91 milionë euro përfaqësojnë vlerën e aseteve të konfiskuara, ndërsa pjesa tjetër, prej rreth 43.49 milionë euro, është vlera e aseteve të sekuestruara. Në vlerën e aseteve të sekuestruara përfshihet dhe sekuestrimi i kriptovalutave të llojit TETHER, USDT, me vlerë ekuivalente prej 14.5 milionë dollarë ose rreth 12.4 milionë euro (Vendimi nr.583, datë 04.09.2025).


Vlera e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara për Vitin 2025

Akte Ligjore	Viti 2025			
	Sekuestime		Konfiskime	
	Në monedhën Euro	Në monedhën USD	Në monedhën Euro	Në monedhën USD
Ligji nr.10192, datë 3.12.2009 (Anti Mafia)	14,691,875.00		811,289.00	
Kodi i Procedurës Penal	16,420,425.00	14,500,000.00	1,099,806.00	
Akt Normativ (OFL)	-		-	
Totali	31,112,300.00	14,500,000.00	1,911,095.00	-


Sikurse evidentohet nga tabela, vlera e pasurive të sekuestruara është dukshëm më e lartë krahasuar me atë të pasurive të konfiskuara, duke përbërë rreth 96% të totalit për vitin 2025, ndërkohë që konfiskimet zënë rreth 4% të totalit.

Në vijim të kësaj analize dhe bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, rezulton se nga vlera totale e asetëve të sekuestruara prej rreth 43.5 milion euro, pjesa më e madhe, rreth 66%, ose rreth 28.8 milion euro, përfaqësojnë pasuri të sekuestruara në kuadër të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 34%, ose rreth 14.7 milion euro, i përket pasurive të sekuestruara në kuadër të Ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 (Anti-Mafia). Sa i përket konfiskimeve, vlera e tyre është dukshëm më e ulët krahasuar me sekuestrimet dhe shpërndahet ndërmjet të njëjtave akte ligjore.

Raporti i vlerave të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë vitit 2025 sipas bazës ligjore



Raporti midis masës së konfiskimeve dhe sekuestrimeve



Gjatë vitit 2025, vlera totale e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara është më e ulët krahasuar me vitin paraardhës, duke zbritur nga rreth 65 milionë euro, në rreth 45.4 milionë euro.

Nga totali i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara për vitin 2025, vlera e pasurive të sekuestruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar është rreth 42.4 milionë euro, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara për këtë kategori veprash penale është rreth 1.8 milionë euro.

Përgjatë vitit 2025, nuk janë dhënë vendime për sekuestrimin e pasurive në lidhje me vepra penale të korrupsionit të thjeshtë, ndërsa vlera e pasurive të sekuestruara të zyrtarëve të lartë është rreth 1.1 milion euro, ndërkohë që vlera e pasurive të konfiskuara të tyre është rreth 100,000 euro.

EFEKTIVITETI NË GJYKIM

Gjatë vitit 2025, SPAK ka vijuar të paraqesë një nivel të qëndrueshëm efektiviteti në fazën e gjyqimit, sikurse rezulton nga të dhënat statistikore mbi vendimet e dhëna nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO) për periudhën 2021–2025.

Vendimet e GJKKO-së në vitet 2021–2025

Vendimet e dënimit	2021	2022	2023	2024	2025
	çështje	çështje	çështje	çështje	çështje
Vendim fajësie në GJKKO	75	47	72	65	66
Vendime pafajësie dhënë nga GJKKO	2	3	8	7	10
Totali	74	50	80	72	76

Në total, gjatë vitit 2025 janë dhënë 76 vendime gjyqësore nga GJKKO-ja, nga të cilat 66 vendime fajësie dhe 10 vendime pafajësie. Krahasuar me vitin 2024, konstatohet një rritje e lehtë e numrit total të vendimeve, nga 72 në 76 çështje, çka tregon një stabilizim të volumit të çështjeve të përfunduara në gjykim.


Vendimet e fajësisë përbëjnë rreth 87% të totalit, ndërsa vendimet e pafajësisë përbëjnë rreth 13%, duke ilustruar nivelin e lartë të efektivitetit të SPAK në fazën e gjyqimit. Gjatë vitit 2025, janë dhënë 66 vendime fajësie, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2024, ku ishin dhënë 65 vendime. Ky tregues dëshmon se, pavarësisht rritjes së kompleksitetit të çështjeve të trajtuara, SPAK ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të çështjeve të paraqitura në gjykim.

Gjatë vitit 2025 evidentohet gjithashtu një rritje e numrit të vendimeve të pafajësisë, nga 7 në vitin 2024, në 10 në vitin 2025.

Analiza e të dhënave për periudhën pesëvjeçare tregon nivele të larta të efektivitetit në gjykim dhe përfundimit të çështjeve me vendim gjyqësor, duke reflektuar qëndrueshmëri të këtij treguesi ndër vite. Këto të dhëna dëshmojnë se, SPAK ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm efektiviteti në gjykim.

Në vijim, paraqitet grafiku që ilustron vendimet e dënimit të dhëna gjatë vitit 2025 dhe peshën e tyre në raport me totalin, duke theksuar përqindjen e vendimeve fajësie dhe pafajësie.

Vendimet e dënimit dhënë nga GJKKO gjatë vitit 2025



ANALIZA E VOLUMIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË POSAÇME PËR VITIN 2025

VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë, volumni i punës në hetim

Në Prokurorinë e Posaçme për periudhën e vitit **2025** janë hetuar gjithsej **871** procedime penale, nga të cilat, **577** procedime penale janë mbartur nga viti **2024**, ndërsa **294** procedime penale janë regjistruar gjatë vitit 2025, si procedime penale të reja.

Nga numri total i procedimeve penale të hetuara, për **39** procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes, duke pasur në hetim për këtë periudhë kohore gjithsej **832** procedime penale me **838** persona nën hetim.

Nga **294** procedime penale të regjistruara për vitin 2025, **46** procedime penale janë regjistruar mbi bazën e kallëzimeve dhe procedimeve të ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve gjyqësore, **109** procedime janë të regjistruara kryesisht. Ndërkohë, janë filluar mbi bazën e referimeve penale të shërbimeve të policisë gjyqësore, të kallëzimeve penale të institucioneve të ndryshme vendase dhe autoriteteve të huaja, enteve private të shtetasve etj., 139 procedime penale.

Nga 109 procedime penale të regjistruara kryesisht me 102 persona në hetim, 10 procedime janë bashkuar me procedimet e tjera.

Për vitin 2025, janë dërguar për kompetencë lëndore pranë Prokurorisë së Posaçme 56 procedime penale nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Për 15 procedime është vendosur ridërgimi i tyre pranë prokurorisë përkatëse me vendimin e prokurorëve të posaçëm për mospranimin e akteve. Për 41 procedime penale është vendosur pranimi dhe regjistrimi i tyre në Prokurorinë e Posaçme.

Janë regjistruar gjithsej, 325 kallëzime nga të cilat, për 178 kallëzime është vendosur mosfillim procedimi penal, për 2 kallëzime penale, nuk është marrë vendimmarrje gjatë vitit 2025 dhe janë mbartur në vitin 2026 (për dy kallëzime penale të vitit 2024 është vendosur mosfillim procedimi penal në vitin 2025), për 130 kallëzime penale është vendosur regjistrimi i procedimit penal, për 10 kallëzim penale është vendosur bashkimi i tyre me procedime penale, për 2 kallëzim penale është vendosur shfuqizim vendimi mosfillimi dhe për 3 kallëzime penale është vendosur moskompetencë.

Në lidhje me vendimet e mosfillimit të procedimit penal, është paraqitur ankim në gjykatë në 66 raste, nga të cilat për 14 vendime është vendosur lënia në fuqi, për 19 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe për 33 vendime mosfillimi vazhdon gjykimi në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga **832** procedime penale në hetim me **838** persona nën hetim, rezulton se gjatë vitit **2025** kanë përfunduar hetimet për **216** procedime penale me **440** persona nën hetim/të pandehur, ku për **54** procedime me **401** të pandehur është paraqitur kërkesë për gjykim, për **58** procedime penale me **16** persona në hetim është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes, **63** procedime penale me **23** persona në hetim janë transferuar për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe për **41** procedime penale është vendosur pezullimi i hetimeve. Ndërsa **616** procedime penale me **398** persona në hetim janë mbartur për vitin 2026.

Në lidhje me **kërkesat për gjykim**, rezulton të jenë dërguar në gjykatë **54** kërkesa për gjykim me **401** të pandehur nga të cilat **18** kërkesa për gjykim me **183** të pandehur për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, **33** kërkesa për gjykim me **160** të pandehur për vepra penale të lidhen me korrupsionin, dhe për **3** kërkesë për gjykim me **58** të pandehur për vepra penale të tjera.

Në **58** procedimet penale për të cilët është paraqitur **kërkesë për pushimin** e çështjes kanë qenë nën hetim **16** persona, nga të cilët **4** kërkesa për pushim me **3** persona nën hetim për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar, **49** kërkesa për pushim me **12** persona nën hetim për vepra penale të lidhen me korrupsionin, dhe për **5** kërkesa për pushim me **1** persona nën hetim për vepra për vepra penale të tjera.

Në **63** procedimet penale që janë transferuar në prokuroritë e rretheve gjyqësore kanë qenë **23** persona nën hetim, **7** procedime penale me **2** persona nën hetim për vepra në fushën e krimit të organizuar, për **44** procedime penale me **13** persona nën hetim për vepra në fushën e korrupsionit, për **12** procedime penale me **8** persona nën hetim për vepra penale të tjera.

Në lidhje me **pezullimin e hetimeve** rezulton se për **41** procedimet penale është vendosur pezullimi i hetimeve, nga të cilat rezulton se kemi **31** procedime të pezulluara për veprat penale

në kuadrin e krimit të organizuar, **2** procedime të pezulluara për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe kemi **8** procedime të pezulluara për vepra penale të tjera.

Nga numri prej **838** persona nën hetim, **604** prej tyre janë hetuar me **masë sigurimi**, ndërsa **234** persona nën hetim janë hetuar në **gjendje të lirë**.

416 personat nën hetim janë hetuar me **masë sigurimi**, “arrest me burg”, nga të cilët **263** masa janë ekzekutuar, ndërsa për **153** persona është vendosur masa e sigurimit “arrest në burg” në mungesë.

Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vendosur për **66** persona nën hetim, **104** persona nën hetim janë hetuar me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, **15** persona për masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, **2** persona me masën e sigurimit “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”, **1** person me masën e sigurimit “ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”

Për vitin 2026 **janë mbartur** në hetim **616** procedime penale me **398** persona në hetim.

Nga 616 procedime penale të mbartura, 186 procedime penale janë të regjistruara për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar me 258 persona nën hetim, nga të cilët **215** prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe 388 procedime penale me 91 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të korrupsionit, nga të cilët 8 prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest me burg”. Ndërsa, 42 procedime penale me 49 persona nën hetim janë të regjistruar për vepra penale të tjera, nga të cilët **2** prej tyre hetohen me masën e sigurimit “arrest në burg”.

Nga 398 persona nën hetim në procedimet penale të mbartura, 225 persona janë duke u hetuar me masën e sigurimit “arrest në burg”, 24 persona me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, 39 persona me masën e sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, 9 persona me masën e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit”, 2 persona me masën “pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik” dhe 99 persona në gjendje të lirë pa ndonjë masë sigurimi.

Afati mesatar i hetimit të kryer nga prokurorët e posaçëm rezulton të jete rreth 540 ditë.

Procedimet e hetuara dhe të regjistruara për veprat penale që lidhen me zgjedhjet, për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025

Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, janë hetuar (mbartur dhe regjistruar) gjithsej 70 procedime penale, për 27 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me krimet zgjedhore, nga të cilat rezulton se:

- Për veprat penale që lidhen me zgjedhjet e vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 46 procedime me 9 persona nën hetim,
- Për veprat penale që lidhen me zgjedhjet e viteve të kaluara janë hetuar gjithsej 24 procedime me 18 persona nën hetim.

Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, janë përfunduar gjithsej 21 procedime me 22 persona nën hetim, nga të cilat :

- 8 procedime, me 19 të pandehur është dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim;

- 10 procedime penale, me 3 persona nën hetim janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim;
- 2 procedime janë transferuar për kompetencë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm;
- 1 procedim është pezulluar.
- 5 procedime janë bashkuar më procedimet e tjera

Aktualisht në hetim janë 44 procedime penale, me 5 persona.

Procedimet e regjistruara për veprat penale që lidhen me zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025

Për veprat penale që lidhen me zgjedhjet 2025 janë regjistruar gjithsej 46 procedime me 9 persona nën hetim, nga të cilat:

- 4 procedime, me 8 të pandehur është dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim;
- 7 procedime penale, janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim;
- 2 procedime janë transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- 1 procedim është pezulluar.
- 4 procedime janë bashkuar më procedimet e tjera

Aktualisht në hetim për në lidhje me procedimet e regjistruara për veprat penale që lidhen me zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, janë 28 procedime penale, me 1 person.

Procedimet që lidhen me veprat penale me qëllime terroriste për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025

Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, janë hetuar (mbartur + regjistruar) gjithsej 29 procedime penale me 1 person nën hetim, për veprat penale me qëllime terroriste, nga të cilat rezulton se:

- 1 procedim është transferuar për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore
- 7 procedim janë pezulluar

Aktualisht në hetim janë 21 procedime penale me 1 person.

Të dhënat për hetimet pasurore për vitin 2025

- Përgjatë vitit 2025, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë regjistruar 13 procedime pasurore dhe 18 referime pasurore ndaj personave, të cilët kanë kryer vepra penale dhe bëjnë pjesë në fushën e zbatimit sipas nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.
- Prokuroria e Posaçme, në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet ndjekjes penale, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale, gjatë vitit 2025 ka arritur të sekuestrojë dhe konfiskojë një portofol të diversifikuar asetesh, si pasuri të paluajtshme, vlera monetare, si dhe kuota tregtare. Më konkretisht:
- Në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, janë paraqitur në gjykatë 4 kërkesa për sekuestrimin e pasurive dhe janë dhënë nga gjykata 4 vendime për pranimin e kërkesës për

sequestrimin e pasurisë dhe 1 vendim për mospranimin e kërkesës për sequestrimin e pasurisë, i cili pas ankimimit nga ana e prokurorit të çështjes është ndryshuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke vendosur përfundimisht për pranimin e kërkesës. Pasuritë e sequestruara janë: 11 pasuri të luajtshme, 66 pasuri të paluajtshme, 4 subjekte tregtare dhe 3 llogari bankare.

Pasuritë e sequestruara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 14.691.875 Euro.

Po kështu, janë paraqitur në gjykatë 9 kërkesa për konfiskimin e pasurive, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 3 vendime për konfiskim të pasurive duke konfiskuar përkatësisht: 3 pasuri të luajtshme, 8 pasuri të paluajtshme, 2 subjekte tregtare dhe 4 llogari bankare.

Pasuritë e konfiskuara sipas ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*” vlerësohen rreth 811.289 Euro.

- **Në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, gjatë procesit penal**, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, janë marrë 12 vendime për sequestrim pasurie. Në total janë sequestruar rreth 113 pasuri të paluajtshme, 35 pasuri të luajtshme, 13 subjekte tregtare, 92 llogari bankare dhe rreth 1.500.000 milionë Euro në shumë monetare.
Pasuritë e sequestruara sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë vlerësohen rreth 16.420.425 Euro.
- **Në zbatim të Kodit Penal, gjatë procesit penal**, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, njëkohësisht me vendimet e dënimit, janë marrë 5 vendime për konfiskim pasurie. Në total janë sequestruar rreth 15 pasuri të paluajtshme dhe 2 pasuri të luajtshme.
Pasuritë e konfiskuara sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë vlerësohen rreth 1.099.806 Euro.
- **Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020**, nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë 3 vendime të formës së prerë. Për 2 nga këto vendime është vendosur të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe për 1 vendim, është vendosur shfuqizimi i konfiskimit dhe sequestrimit për 1 pasuri të paluajtshme.
Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndaj rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është shprehur me 2 vendimmarrje.
Në zbatim të parimit së gjësë së gjykuar, Kolegji Penal ka vendosur mospranim të rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

VOLUMI I PUNËS NË GJYKIM

Gjatë vitit 2025 janë dërguar në gjykatë 53 kërkesa për gjykim dhe 3 kërkesa për miratimin e marrëveshjes së fajësisë. Për 30 çështje është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë së

Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar për dërgimin në gjyq të çështjes penale. Për 2 çështje është vendosur refuzimi i marrëveshjes së fajësisë dhe kthimin e akteve. Për 1 çështje është vendosur plotësimi i hetimeve, për 1 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe plotësimi i hetimeve, ndërsa 22 çështje janë në proces.

Për vitin 2025, në GJKKO, janë gjykuar 147 çështje me 850 persona të pandehur, nga të cilat rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit për 62 çështje me 228 persona. Për 85 çështje penale themeli me 622 persona të pandehur vazhdon gjykimi, duke u mbartur për t'u gjykuar në vitin 2026.

Për vitin 2025, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 81 vendime me 247 persona. Për 1 vendim me 1 persona të pandehur është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe është dërguar për kompetencë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore. Për 1 vendim me 1 të pandehur është vendosur miratimi i marrëveshjes së fajësisë dhe për 2 vendime me 5 të pandehur është refuzimi i miratimit të marrëveshjes së fajësisë. Për vitin 2025, nga GJKKO janë dhënë 66 vendime dënimi me 197 persona të dënuar.

Për vitin 2025, nga GJKKO, janë dhënë gjithsej 66 vendime dënimi me 197 persona të dënuar. Nga këto, 25 vendime me 89 persona të dënuar për vepra penale në fushën e krimit të organizuar, ndërsa 41 vendime me 108 persona të dënuar për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

Pafajësitë. Gjatë vitit 2025, nga GJKKO janë deklaruar të pafajshëm 21 të pandehur.

Duhet cilësuar se, nga pafajësitë e dhëna nga GJKKO për 10 çështje me 68 persona të gjykuar është vendosur pafajësi e plotë për vetëm 2 çështje me 6 persona të pandehur, ndërsa për 8 çështje të tjera ka vendime fajësie për 47 persona dhe vendim pafajësie për 15 të tjerë.

Pushimet në gjykim – Për 1 çështje me 2 persona është vendosur pushimi i gjykimit në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Përveç çështjeve penale të mësipërme, prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë edhe në gjykimin e 8 çështjeve penale me të dëmtuar akuzues, që kanë paraqitur kërkesë drejtpërsëdrejti në gjykatë, me 20 persona të akuzuar.

Pafajësitë me të dëmtuar akuzues- Për 5 çështje me 5 persona të akuzuar është vendosur pafajësi në GJKKO.

Pushimet në gjykim me të dëmtuar akuzues- Për 2 çështje me 14 persona të akuzuar është vendosur pushimi i çështjes në GJKKO.

Moskompetenca lëndore në gjykim me të dëmtuar akuzues - Për 1 çështje me 1 person të akuzuar është moskompetenca lëndore në GJKKO.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE 2025

Gjatë vitit 2025 janë ekzekutuar 70 vendime penale të formës së prerë me 251 të pandehur dhe 226 të dënuar.

Nga **251** të pandehur janë dhënë vendime penale të formës së prerë si më poshtë:

- Për **36** të pandehur janë dhënë vendime të formës së prerë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsioni dhe Krimit të Organizuar. (GJKKO)
- Për **190** të pandehur janë dhënë vendime të formës së prerë në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJAKKO), nga këto për **14** të pandehur Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në (GJAKKO).
- Për **25** të pandehur janë dhënë vendime të formës së prerë nga Gjykatat (GJAKKO dhe GJKKO) për pushim dhe pafajësi, nga këto (për **8** të pandehur Gjykatat kanë vendosur deklarin e pafajshëm, për **13** të pandehur Gjykatat kanë vendosur “pushimin e çështjes në ngarkim të tyre”, ku 1 i pandehur ka ndërruar jete dhe për **4** të pandehur Gjykatat kanë vendosur përjashtim nga vuajtja e dënimit të dhënë).

Për **226** të dënuar kemi këto masa dënimi:

- 161 janë të dënuar me burg.
- 58 janë të dënuar me kusht/ kohë prove.
- 7 janë të dënuar me orë pune.

Për vitin 2025, janë dhënë **70** vendime penale të formës prerë, ku **10** prej tyre janë vendime penale për ish-zyrtarë të lartë, si më poshtë:

- 6 të pandehur ish-kryetarë bashkie ,
- 2 të pandehur ish-gjyqtarë ,
- 1 i pandehur ish-Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
- 1 i pandehur ish-Deputet

Për vitin 2025 janë ushtruar gjithsej **79** ankime nga palët dhe Prokurorët, ndaj vendimeve penale të GJKKO, nga të cilat **65** prej tyre janë shqyrtuar, gjykuar në GJAKKO, ndërsa për **14** prej tyre vazhdon gjykimi.

Gjithashtu janë ushtruar gjithsej **32** rekurse nga palët dhe Prokurorët ndaj vendimeve të (GJAKKO), ku vijon gjykimi në Gjykatë të Lartë.

Për **59** vendime penale të Gjykatës së Lartë dhe 1 vendim të Gjykatës Kushtetuese, vendimmarrja si më poshtë:

- Në **42** vendime është vendosur mospranim rekursi
- Në **5** vendime është vendosur lënie në fuqi e vendimit të GJAKKO;
- Në **4** vendime është vendosur prishja e vendimit të GJAKKO dhe lënia në fuqi e Vendimit të GJKKO.
- Në 2 vendime është vendosur lënia në fuqi e GJAKKO, duke i ndryshuar masën të dënuarit.
- Në 3 vendime është vendosur prishja e vendit të GJAKKO dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në GJAKKO me tjetër trupë gjykues
- Në 3 vendime është vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe dërgimin e çështjes në të njëjtën Gjykatë me tjetër trupë gjykuese

- Në 1 vendim të Gjykatës Kushtetuese është vendosur shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i saj në të njëjtën gjykatë me tjetër trupë gjykuese

Gjatë vitit 2025, nga Gjykatat është dhënë dënimi plotësues “ndalimi për të ushtruar funksion publik”, në bazë të nenit 35 të Kodit Penal për **30** persona,

Gjatë vitit 2025 Gjykatat kanë dhënë 15 vendime për konfiskimin e pasurive në proces penal.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme janë paraqitur **11** kërkesa për vendosje në regjim të posaçëm për 11 të dënuar, për të cilët Ministri i Drejtësisë ka vendosur miratimin e tyre.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është kërkuar vendosja në regjim të posaçëm për 9 të dënuar, ku për 4 prej tyre Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedurës për vendosjen në regjim të posaçëm, ndërsa 5 të dënuar jemi në proces verifikimi.

Nga sektori i ekzekutimeve janë përgatitur **343** vendime për miratimin e takimeve të të paraburgosurve me familjarët e tyre, sipas kërkesave të ardhura nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, nga avokatët apo familjarëve të tyre.

Për të dënuarit, të cilët kanë përfunduar dënimet alternative (me kusht/me kohe prove/ore pune), pas raportit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, janë nxjerrë nga prokurorët 34 vendime për përfundim dënimi.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE HETIMET E PËRBASHKËTA

Spektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Ndërlidhës në Hetimet e Përbashkëta bazuar në nenin 22, të ligjit nr. 95/2016, është përgjegjës për koordinimin e punës me autoritetet e shteteve të huaja. Ky sektor drejtohet nga një Prokuror i Posaçëm dhe në strukturën e tij ka 3 Ndërlidhës. Spektori shërben si ndërlidhës me autoritetet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve të përbashkëta, ekstradimeve, marrëdhënieve me Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën Qendrore të Interpol-it, Prokurorin Shqiptar Ndërlidhës në Eurojust, Prokurorët dhe Oficerët Ndërlidhës atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë, apo dhe drejtpërsëdrejti me autoritetet e huaja.

Kërkesat për ndihmë juridike nga jashtë vendit

Gjatë vitit 2025, nga ana e Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, janë trajtuar **95** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike transmetuar nga autoritetet gjyqësore të huaja, në bazë të konventave të Këshillit të Europës dhe Konventave të Kombeve të Bashkuara, si dhe marrëveshjeve dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Nga totali i kërkesave të transmetuara nga autoritetet e huaja janë ekzekutuar **68** dhe **27** kërkesa për ndihmë juridike të dërguara në fund të vitit 2025, janë në fazë ekzekutimi.

Objekti i kërkesave për ndihmë juridike është kryerja e veprimeve të ndryshme hetimore në territorin e Republikës së Shqipërisë për llogari të autoriteteve të huaja, kontrolli i ambienteve apo sekuestrimi i pasurive të luajtshme, të paluajtshme apo vlerave monetare në “cash”.

- Ndarja sipas objektit të këtyre kërkesave do të ishte si më poshtë:


- **87** kërkesa me objekt kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore, si dhe sekuestrimin e pasurive;
- **8** kërkesa me objekt kontroll ambient;

Kohëzgjatja e ekzekutimit të këtyre kërkesave luhet nga 2 javë deri në 6 muaj, kjo në varësi të objektit të kërkesës apo numrit të madh të personave për të cilët kërkohet kryerja e veprimeve.

Këto kërkesa janë transmetuar nga ana e autoriteteve gjyqësore të huaja të vendeve evropiane, rajoni, si dhe vendeve të Amerikës Latine me objekt kryerjen e veprimeve hetimore në Republikën e Shqipërisë lidhur me hetime të regjistruara nga këto autoritete.

- Ndarja sipas shteteve, do të ishte: **Belgjika** me numrin më të madh të kërkesave **24**, **Gjermania 16** kërkesa, **Italia 15** kërkesa, **Franca 10** kërkesa, **Anglia dhe Holanda** me nga **5** kërkesa, **Spanja 4** kërkesa, **Kosova 3** kërkesa, **Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rumania, Greqia** me nga **2** kërkesa, **Norvegjia, Suedia, Maqedonia e Veriut, Luksemburgu, Bullgaria dhe Çekia** me nga **1** kërkesë.
- Ndarja sipas veprave penale, do të ishte:
 - **Trafikimi i lëndëve narkotike**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **46** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Trafikimi i lëndëve narkotike**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe **pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale**, janë transmetuar **12** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal janë transmetuar **13** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Vrasja dhe heqja e paligjshme e lirisë**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **6** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Mashtrimi**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **15** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Falsifikimit të dokumenteve dhe kontrabandës**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **2** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Trafikimit i qenieve njerëzore**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, është transmetuar **1** kërkesë për ndihmë juridike.

Letërporosi nga jashtë vendit




Kërkesat për ndihmë juridike për jashtë vendit

Për nevoja të hetimeve nga Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme në vitin 2025, janë përpiluar **156** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja, të vendeve Evropiane, Rajonit, si dhe vendeve të Amerikës Latine, në kuadër të hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. Nga totali i kërkesave të transmetuara autoritetet e huaja kanë ekzekutuar **55** kërkesa për ndihmë juridike, **3** kërkesa janë ekzekutuar pjesërisht, dhe **97** kërkesa për ndihmë juridike janë në fazë ekzekutimi.

- Ndarja sipas shteteve është: **Franca 55** kërkesa, **Holanda 12** kërkesa, **Italia 8** kërkesa, **Kosova 7** kërkesa, **Belgjika, Greqia** dhe **Zvicra** me nga **6** kërkesa, **Gjermania, Mali i Zi, Ekuadori**, dhe **Spanja** me nga **5** kërkesa, **SHBA, Anglia** dhe **Brazili** me nga **4** kërkesa, **Austria** dhe **Kolumbia**, me nga **3** kërkesa, **Sllovakia, Maqedonia e Veriut** dhe **Turqia** me nga **2** kërkesa, **Danimarka, Bullgaria, Portugalia, Serbia, Çekia, Luksemburgu, Polonia, Qipro, Republika Domenikane, Kanadaja, Peruja, dhe Paraguai** me nga **1** kërkesë.
- Ndarja sipas veprave penale, do të ishte:
 - **Trafikimi i lëndëve narkotike**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **45** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Trafikimi i lëndëve narkotike**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe **pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale**, janë transmetuar **28** kërkesa për ndihmë juridike;
 - **Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe janë transmetuar **7** kërkesa për ndihmë juridike;

- **Vrasja dhe heqja e paligjshme e lirisë, mbajtje pa leje e dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **39** kërkesa për ndihmë juridike;
- **Mashtrimi**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, është transmetuar **1** kërkesë për ndihmë juridike;
- **Vepra penale në kuadër të terrorizmit**, janë transmetuar **5** kërkesa për ndihmë juridike;
- **Falsifikimit të dokumenteve dhe kontrabandës**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **5** kërkesa për ndihmë juridike;
- **Trafikimit i qenieve njerëzore**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, është transmetuar **1** kërkesë për ndihmë juridike.
- **Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik**, janë transmetuar **14** kërkesa për ndihmë juridike.
- **Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë**, në kuadër të grupit strukturuar kriminal, janë transmetuar **2** kërkesa për ndihmë juridike;
- **Trafikimi i armëve dhe i municionit, dhe shkatërrimi pronës me eksploziv**, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, janë transmetuar **4** kërkesa për ndihmë juridike;



Referime penale

Gjatë vitit 2025 janë transmetuar 3 referime penale nga autoritetet e huaja, konkretisht 2 nga Belgjika dhe 1 nga Franca.

Hetimet pasurore

Prokuroria e Posaçme, në vitit 2025, në vijim të kërkesave për ndihmë juridike, të transmetuara nga autoritetet e huaja, bazuar në Ligjin Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen

*e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014), ka regjistruar **2 kërkesa për hetim pasuror**, të transmetuara nga Belgjika, për të cilat po vijohet me hetimet.*

Sekuestrimet

Në vitin 2025, në zbatim të kërkesave për ndihmë juridike të autoriteteve të huaja me objekt sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe në vijim të vendimeve gjyqësore të cilat kanë lejuar ekzekutimin e tyre, është vijuar me sekuestrimet për llogari të këtyre autoriteteve, në total të **8 ambiente banimi, 2 garazhe, 1 shoqëri tregtare, 3 llogari bankare, 3 automjete dhe vlera monetare cash prej 211.635,00 Euro**, të detajuara si më poshtë:

1. Për llogari të autoriteteve **belge** – vlera monetare prej **201.635,00 Euro**;
2. Për llogari të autoriteteve **italiane** – vlera monetare prej **10.000,00 Euro**;
3. Për llogari të autoriteteve **angleze** – **6 ambiente banimi, 2 garazhe, 1 shoqëri tregtare, 3 llogari bankare dhe 3 automjete**;
4. Për llogari të autoriteteve **gjermane** – **2 ambiente banimi dhe 1 automjet**;

Këto pasuri të sekuestruara, po administrohen dhe menaxhohen nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në zbatim të Ligjit në Nr. 34/2019 “*Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara*”.

Kontrollet e ambienteve

Nga autoritetet gjyqësore të huaja për vitin 2025, janë paraqitur **8 kërkesa për ndihmë juridike me objekt jo vetëm kryerjen e veprimeve hetimore, por dhe për kontrollin e ambienteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të cilat gjykata ka lejuar kryerjen e këtyre veprimeve si dhe ushtrimin e kontrolleve sipas subjekteve të kërkuara. Shtetet të cilat kanë kërkuar kontrollin e ambienteve janë:**

- Belgjika - 4 kërkesa;
- Bullgaria - 1 kërkesë;
- Gjermania - 2 kërkesa;
- Italia - 1 kërkesë.

Skuadrat e përbashkëta hetimore

Një tjetër fushë shumë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkombëtar, është dhe krijimi i Skuadrave të Përbashkëta Hetimore. Në vitin 2025 janë krijuar **6 Skuadra të Përbashkëta Hetimore**, gjithashtu është dakordësuar me autoritetet e huaja për krijimin edhe të 6 Skuadrave të tjera Hetimore. Gjatë vitit 2025, kanë vijuar gjithashtu hetimet për **26 Skuadra të Përbashkëta Hetimore**, aktive të krijuara gjatë viteve 2020-2025 në funksion të hetimeve për veprat penale të trafikimit të narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale, ose të veprimtarisë kriminale, mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit, trafikimit të personave të rritur, mashtrimit kompjuterik vepra të kryera në formën e bashkëpunimit të veçantë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga Kodi Penal në nenet, 110/a 283/a, 28, 287, 278, 143/b, 333/a dhe 334.

Ndarja sipas shteteve për skuadrat e krijuara në vitin 2025 do të ishte, **Italia** me 2 Skuadra të Përbashkëta, dhe **Gjermani-Greqi-Bullgari, Francë, Ukrainë dhe Finlandë** me nga 1 Skuadër të Përbashkët Hetimore.

Në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2025, janë mbajtur 16 takime koordinuese me autoritetet e huaja palë në këto skuadra, përveç mbledhjeve të përbashkëta të realizuara nëpërmjet video-konferencës.

OPERACIONET E PËRBASHKËTA ME AUTORITETET E HUAJA GJATË VITIT 2025:

1. Operacioni i SPAK me autoritetet finlandeze.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me autoritetet finlandeze, në kuadër të Skuadrës së Përbashkët Hetimore, të krijuar gjatë vitit 2023, ka vijuar hetimet në kuadër të procedimit penal nr.147, datë 29.06.2023, për veprat penale të “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283 dhe 28/4 të Kodit Penal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal; si dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga pika 1 e nenit 334 të Kodit Penal.

Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin nr.52, datë 02.06.2025, ka vendosur masën e sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj 11 shtetasve shqiptarë.

Më 03.06.2025 nga Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është bërë e mundur ekzekutimi i masës së sigurisë për 9 persona nën hetim.

Gjatë ekzekutimit të masave të sigurimit janë ushtruar kontrole të shumta në banesa dhe ambiente biznesi si dhe janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 8 automjete; 13 telefona celularë dhe prova shkresore të ndryshme.

Në zbatimin e masave të sigurisë dhe ushtrimin e kontroleve kanë marrë pjesë edhe oficerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit në Finlandë, të policisë së Helsinkit dhe Turkut, Finlandë. Ndihmë të veçantë në hetimin e këtij procedimi penal ka dhënë Zyra e Oficerit Ndërlidhës të Vendeve nordike për Shqipërinë dhe Kosovën, duke ngritur urat lidhëse mes SPAK dhe autoriteteve hetimore dhe policore të Finlandës.

2. Operacioni SPAK me autoritetet italiane

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar procedimin penal nr. 36 i vitit 2019, për veprat penale “*Trafikimi i narkotikëve*”, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal*” dhe “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*”, vepra të parashikuara nga nenet 283/a, 28/4, 333/a, 334 dhe 287 të Kodit Penal.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në kuadër të hetimeve për procedimin penal nr.36 të vitit 2019, ka krijuar edhe 4 Skuadra të Përbashkëta Hetimore me autoritetet italiane të drejtësisë. Ku në kuadër të tre Skuadrave të Përbashkëta Hetimore janë proceduar dhe gjykuar më parë 118 persona në Shqipëri dhe Itali.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të Skuadrës së katërt të Përbashkët Hetimore, është zhvilluar një Operacion i përbashkët me Prokurorinë e Barit, Drejtorinë Antimafia, me mbështetjen e Eurojust, në kuadër të së cilës janë vënë nën hetim 52 persona në Shqipëri dhe Itali.

Gjatë operacionit në Shqipëri në zbatim të vendimit Nr. 34, datë 30.04.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë caktuar 30 masa sigurimi “arrest në burg” dhe 1 urdhër ndalimi.

Më datë 20.06.2025, në kuadër të procedimin pasuror nr.10/2025, të Prokurorisë së Posaçme dhe në ekzekutim të Vendimit Nr. 39, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë sekuestruar nga aktiviteti kriminal, edhe 21 pasuri të paluajtshme, në vlerën rreth 12 milion Euro.

3. Operacioni SPAK me autoritetet zvicerane

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar procedimin penal nr. 49/3 viti 2023, për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e *narkotikëve*”, “*Trafikimi i narkotikëve*”, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal*”, të parashikuara nga nenet 28/4, 283/1, 283/a, 287, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Nga veprimet hetimore të kryera në bashkëpunim me autoritetet e drejtësisë zvicerane, janë mbledhur provat e nevojshme, të cilat kanë provuar faktin se disa shtetas shqiptarë në bashkëpunim me njëri-tjetrin, si dhe në bashkëpunim me disa persona të tjerë që janë me banim në Luzern, Zvicër, në formën e grupit të strukturuar kriminal, kanë organizuar dhe kanë bërë të mundur funksionimin e një sistemi informal të transferimit të parave i njohur me emërtimin “Haëala”, i cili iu ka mundësuar personave nën hetim dhe personave të tjerë të përfshirë në aktivitete kriminale, të transferonin në mënyrë të shpejtë, shuma monetare nga Zvicra në Shqipëri, për një periudhë disa vjeçare, të paktën prej vitit 2020 dhe në vazhdim.

Në kuadër të këtij procedimi penal me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.68 datë 14.07.2025, ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg” ndaj tre personave nën hetim, ku nga ana e shërbimeve policisë në datën 19.07.2025, është ekzekutuar masa e sigurimit “arrest në burg” për 2 persona. Ndërsa personi i tretë nën hetim ndodhet aktualisht i arrestuar në Zvicër.

Gjithashtu në kuadër të këtij procedimi penal me Vendimin Nr. 442, datë 14.07.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur caktuar masën e sigurimit pasuror mbi 2 pasuri të paluajtshme, 2 subjekte tregtare dhe në vlerën monetare prej 77.160 Franga.

4. Operacioni (Pandora) SPAK me autoritetet gjermane.

Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 42, të vitit 2024, për veprat penale “*Mashtrimi kompjuterik*”, kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi i strukturuar kriminal*” të parashikuara nga nenet, 143/b, 28/4, 333/a, dhe 334 të Kodit Penal.

Në kuadër të këtij procedimi penal, pas një hetimi më shumë se një vjeçar, në mars 2025 në bashkëpunim me autoritetet gjermane dhe me mbështetjen e EUROPOL, u zhvillua një Operacion i Përbashkët “Pandora”, në lidhje me veprimtari të paligjshme të call-centerave në Shqipëri.

Gjatë operacionit janë ekzekutuar masat e sigurisë “arrest në burg”, për 3 persona, masat e sigurisë “arrest në shtëpi”, për 3 persona të caktuara nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe u krye shpallja në kërkim ndërkombëtar për 2 persona ndaj të cilëve është caktuar gjithashtu masa e sigurisë “arrest në burg”.

Në ekzekutim të masave të sigurisë janë kryer 8 kontrolle të ambienteve në Tiranë, në të cilat u sekuestruan aparate celulare, pajisje kompjuterike dhe vlera monetare prej rreth 10.000 EURO.

Urdhërat për shpalljen në kërkim ndërkombëtar:

Në vitin 2025, prokurorët e Prokurorisë së Posaçme kanë bërë shpalljen në kërkim ndërkombëtar për **89** persona, me qëllim ekzekutimin e masave të sigurimit apo vendimeve të formës së prerë të dënimeve, kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet, 78, 79/dh, 80, 143/b, 189, 190, 245, 259, 278, 284, 287, 283/a, 298/2, 319/ç, 28/4, 333/a, 334 të Kodit Penal.

Ekstradimet

Prokuroria e Posaçme, gjatë vitit 2025, ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë **48** kërkesa për ekstradim nga jashtë vendit në Shqipëri, kryesisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet, 78, 79/a-22, 79/dh, 80, 109, 134, 189, 243, 258-25, 278, 283/a, 284, 287, 298, 319, 28/4, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.

TABELA KRAHASUESE PËR VITET 2020-2025

Lloji i Kërkesës	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Kërkesa për Ndihmë Juridike nga jashtë vendit	49	77	54	48	70	95
Kërkesa për Ndihmë Juridike për jashtë vendit	41	51	62	121	163	156
Skuadrat e Përbashkëta Hetimore	5	5	10	10	10	6
Shpalljet në kërkim ndërkombëtar	6	15	42	72	117	89
Kërkesat për ekstradim	23	17	10	39	40	48

Duke iu referuar tabelës së lartpërmendur vërehet një rritje e volumit të punës të Sektorit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Ndërlidhës në Hetimet e Përbashkëta, si dhe Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme edhe gjatë vitit 2025, e pasqyruar kjo në kërkesat për ndihmë juridike transmetuar nga autoritetet e huaja, në kërkesat për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të huaja në kuadër të procedimeve penale, në operacionet e përbashkëta me autoritetet e huaja në kuadër të Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, në shpalljet e personave në kërkim ndërkombëtar, si rrjedhojë edhe rritjen e kërkesave për ekstradim.

Gjithashtu, është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe evropiane, të rajonit, amerikane, gjithashtu edhe me autoritetet homologe të vendeve të Amerikës Jugut. Është rritur ndjeshëm shkëmbimi informacionit edhe nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit si Eurojust, Interpol, Europol etj. Vazhdon gjithashtu intensiv dhe në rritje komunikimi me oficerët ndërlidhës atashuar pranë ambasadave të huaja në Tiranë, i cili ndikon në forcimin e bashkëpunimit dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Projektet ndërkombëtare

Edhe gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është asistuar në punën e saj nga programe të SH.B.A.-së, të cilat synojnë përmirësimin e drejtësisë kriminale të Shqipërisë dhe sektorin e zbatimit të ligjit — Programi Tejoqeanik i Ndihmës dhe i Trajnimit të Zhvillimit të Prokurorisë (OPDAT) dhe Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal (ICITAP), përfaqësues të së cilave janë të vendosur dhe fizikisht në ambientet e kësaj prokurorie.

Misioni OPDAT është përfshirë në rishikimin e legjislacionit të drejtësisë kriminale, trajnimin e prokurorëve, gjyqtarëve, oficerëve të policisë, në dhënien e pajisjeve për zbatuesit e ligjit dhe dhënia e ndihmës teknike që synon vendosjen e strukturave më efektive të zbatimit të ligjit. Ky mision me anë të Këshilltarëve Ligjorë të Përherëshëm, gjatë periudhës që nga krijimi e në vazhdim, ka ofruar ekspertizë dhe asistencë të bazuar në çështje konkrete për prokurorët në veçanti, por edhe më gjerë në sistemin e drejtësisë dhe në ndihmën për marrëdhëniet e kësaj prokurorie ndërkombëtarisht, me synimin për ta ndihmuar në luftën e saj kundër krimit ndërkombëtar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimet për Hetimet Kriminale ICITAP, është një program i cila ka si synim zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zbatimit të ligjit, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. ICITAP edhe gjatë vitit 2025, ka mbështetur Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe Sektorin e Hetimit Financiar duke organizuar një sërë trajnimesh të specializuara për përmirësimin e kapaciteteve hetimore, si dhe ka mbështetur të gjithë strukturën e Prokurorisë së Posaçme, me mjete logjistike, pajisje elektronike Softëare, sisteme informatike etj.

Projekti EU4LEA (faza e dytë) është një projekt asistence teknike i financuar nga BE me një mundësi për të ofruar pajisje, i projektuar për të mbështetur dhe ndihmuar agjencitë kryesore të zbatimit të ligjit shqiptar në veçanti Policinë e Shtetit Shqiptar, Ministrinë e Brendshme, SPAK (Prokurorinë e Posaçme, Sektorin e Hetimit Financiar dhe BKH), Prokurorinë e Përgjithshme, përfshirë ato të Juridiksionit të Përgjithshëm, në arritjen e objektivave të tyre dhe përafrimin e

performancës së tyre me standardet më të mira të BE-së. Objektivi i përgjithshëm i projektit EU4LEA është të kontribuojë në fuqizimin e zbatimit të ligjit në Shqipëri. Objektivat specifike të projektit EU4LEA janë: 1. Përmirësimi i performancës të Policisë së Shtetit Shqiptar (PSHSH), SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme, Sektori i Hetimit Financiar dhe BKH), Prokurorisë të Përgjithshme dhe agjencive përkatëse në luftën kundër krimit të organizuar/krimit të rëndë, korrupsionit në nivele të larta dhe krimit mjedisor. 2 Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Kufirit Kombëtar.

Për të përmbushur objektivat e përcaktuara, fokusi i projektit është si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Projekti do të hartojë dhe zbatojë trajnime të përshtatura, duke përfshirë trajnimin në punë dhe asistencën për zhvillimin e kapaciteteve, të cilat do të bashkojnë policinë, prokurorët, qeverinë vendore dhe palë të tjera të interesuara.

Gjithashtu, parashikohen lloje të ndryshme aktiviteteve, mbështetje këshillimore si teknike dhe strategjike, vlerësime/analiza ligjore, përmbledhje e *acquis*-it përkatëse të BE-së, gamë e gjerë trajnimesh/seminaresh, ushtrime praktike simuluese në nivel qendror dhe vendor, vizita studimore në agjencitë e BE-së /vendeve anëtare të BE-së, rishikim/monitorim i rasteve penale, vizita në terren, etj.

Konkretisht për vitin 2025, ky projekt ka kontribuar në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Reduktimit të Çështjeve të Mbartura (*Backlog*) 2025–2027 të SPAK-ut. Monitorimi i progresit dhe zbatimit të kësaj strategjie realizohet nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar mujore dhe tremujore, që përfshijnë mbledhjet e Grupit të Punës, tabelat e standardizuara të raportimit dhe verifikimin e kryqëzuar të të dhënave midis Sektorit të Regjistrimit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve. Bazuar në të dhënat paraprake të tetorit 2025, numri i çështjeve të mbartura është reduktuar nga 83 në 71 për vitin 2020 ose më herët dhe nga 62 në 50 për vitin 2021, ndërsa norma paraprake e likuidimit ka arritur 78%, duke reflektuar një përparim të dukshëm dhe efektivitet në trajtimin e çështjeve të prapambetura. Po kështu, në bashkëpunim me projektin ka filluar puna për hartimin e një udhëzimi mbi masat për financimin e terrorizmit, sipas rekomandimeve të MONEYVAL.

Projekti EU4FAST (Mbështetje për Parandalimin dhe Luftimin e Kontrabandës së Emigrantëve dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ballkanin Perëndimor).

Qëllim i këtij projekti është përmirësimi i kushteve për parandalimin dhe luftimin e kontrabandës së emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor.

Ky projekt synon të forcojë aftësinë e autoriteteve ligjzbatuese dhe gjyqësore të Ballkanit Perëndimor për të luftuar kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, aftësinë e aktorëve të zbatimit të ligjit të Ballkanit Perëndimor për të bashkëpunuar me Shtetet Anëtare, dhe aktorët e zbatimit të ligjit jo anëtarë në BE në aktivitetet që lidhen me kontrabandën e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore, të forcojë kapacitetin e autoriteteve kufitare të Ballkanit Perëndimor për të parandaluar dhe luftuar kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore në përputhje me standardet e BE-së dhe të drejtat e njeriut.

Projekti WBCJ Western Balkan Criminal Justice (Drejtësia Penale e Ballkanit Perëndimor)

Eurojust për dy dekadat e fundit ka ofruar mbështetje dhe ndihmë operationale për shtetet anëtare të BE-së, me fokus të veçantë në lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor. Projekti i Drejtësisë Penale

të Ballkanit Perëndimor (WBCJ) u zhvillua për të shtrirë këtë mbështetje operacionale për partnerët e Ballkanit Perëndimor, edhe në rastet kur asnjë vend i BE-së nuk është i përfshirë drejtpërdrejt.

Qëllimi i Projektit WBCJ është të forcojë bashkëpunimin brenda Ballkanit Perëndimor dhe midis rajonit dhe Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke përdorur mjete dhe instrumente moderne. Pajisja e partnerëve të Ballkanit Perëndimor me mjetet dhe metodat e punës të bashkëpunimit gjyqësor të BE-së - si takimet e koordinimit, qendrat koordinuese dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore (SPH) - është thelbësore për rezultatin e suksesshëm të hetimeve ndërkufitare.

Projekti jep mbështetje dhe asistencën lidhur me ekspertizat dhe praktikën më të mira nga Eurojust dhe vendet anëtare të BE-së për mënyrën e përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve për bashkëpunim gjyqësor, financim direkt për takimet operative (takime koordinuese, qendra koordinuese) dhe aktivitete hetimore ndërmjet partnerëve të Ballkanit Perëndimor, si brenda ashtu edhe jashtë SPH, siguron pajisje moderne, si telefona celulare dhe laptopë të sigurtë si dhe shërbime përkthimi.

Projekti Holandez MATRA “Strengthening the SPO” (forcimi i Prokurorisë së Posaçme), Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC).

Projekti Pilot 1: kishte si synim kryesor dhënien e rekomandimeve për forcimin e Prokurorisë së Posaçme në aspekte të ndryshme të organizimit të saj dhe funksioneve mbështetëse më të mira, rritjen e uniformitetit të proceseve të punës duke u fokusuar kryesisht në lehtësimin e punës së prokurorëve, nëpërmjet stafit administrativ, hetuesve dhe ndihmësve ligjorë. Në kuadër të së cilit është zhvilluar edhe një vizitë studimore me qëllim shkëmbimin e eksperiencave lidhur me funksionimin e prokurorive homologe dhe agjencive ligjzbatuese në Holandë, duke sugjeruar gjithashtu edhe për ndryshime apo nisma të reja ligjore për këtë qëllim.

Projekti Pilot 2

Ky projekt gjithashtu gjatë vitit 2025, ka marrë nismën për rritjen e kapaciteteve të SPAK duke kryer një sërë trajnimesh edhe për hetimet financiare në aspektin praktik dhe operacional, pasi gjatë viteve të fundit SPAK-u është përballur me një rritje të krimeve financiare të lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Vëmendje e veçantë iu kushtua aspekteve specifike të hetimit financiar, si kontrolli në banesa, vëzhgimit sekret dhe strategjia e marrjes në pyetje gjatë hetimeve financiare. Trajnimi përfshiu gjithashtu bashkëpunimin e Hetuesve Financiarë me ekspertë të fushës nga Agjencitë e Zbatimit të Ligjit të Holandës. Gjithashtu ky projekt bëri të mundur pajisjen e hetuesve financiarë me instrumente (programe kompjuterike) për analizë financiare dhe trajnimin përkatës së tyre të cilët do të rrisin cilësinë dhe efikasitetin në hetimet financiare.

Agjencia kundër Krimit (NCA), nëpërmjet Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, ka mbështetur Prokurorinë e Posaçme, Hetuesit Financiarë, si dhe Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, me trajnime në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe Hetuesit Financiarë me një sërë trajnime në fushën e hetimit financiar, instrumente (programe kompjuterike) për leximin dhe

analizimin e detajuar të të dhënave bankare të nevojshme për kryerjen e hetimeve financiare, si dhe ka dhuruar një sërë pajisje kompjuterike, laptopë, printera portabël dhe statikë.

Vizita Studimore/Trajnime/Konferenca Jashtë Shtetit

Për vitin 2025, përveç takimeve koordinuese në kuadër të skuadrave të përbashkëta nga prokurorët janë kryer **49** Trajnime /Takime / Konferenca / Forume jashtë vendit, kryesisht në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja

Një tjetër aspekt i punës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ka qenë dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit me prokuroritë e shteteve të Amerikës Latine ku gjatë vitit 2025 janë nënshkruar edhe 6 Marrëveshje të reja bashkëpunimi konkretisht:

- Më datën 27.03.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Ekuadorit;
- Më datën 03.12.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Kolumbisë;
- Më datën 03.12.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Kilit;
- Më datën 03.12.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës Federale të Brazilit;
- Më datën 03.12.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Paraguait;
- Më datën 03.12.2025, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit midis Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës Domenikane;

Problematika

1. Vijnë të mbetet problematike statusi i 3 (tre) Ndërlidhësve në Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta, i cili i trajton si nëpunës civilë bazuar në Ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, (i ndryshuar) edhe pse kjo situatë është në kundërshtim me funksionet që duhet të kryejë Ndërlidhësi sipas Ligjit 95/2016, pasi kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale dërguar nga/për autoritetet e huaja, si dhe hetimet e përbashkëta, bazohen në Konventa shumëpalëshe, dypalëshe, Kodin e Procedurës Penale, si dhe Ligjin 10.193 datë 03.12.2009 “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”, (i ndryshuar), të cilat kanë si objekt kryerjen e **veprimeve procedurale**,

ku në Drejtorinë homologe të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, këto veprime kryhen nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Në situatën aktuale ku Ndërlidhësit kanë statusin e “nëpunësit civil”, ata nuk mund të kryejnë veprimet procedurale por vetëm veprime administrative dhe ndihmëse. Këto veprime procedurale deri më tani janë të detyruar t'i kryejnë kryesisht nga Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, Hetuesit Financiarë të Prokurorisë së Posaçme, si dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të cilët është një volum i shtuar në detyrat funksionale të përditshme të tyre, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën e shtuar vit pas viti e reflektuar kjo edhe nga raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme.

Duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, dhe skuadrat përbashkëta hetimore, janë në rritje, referuar statistikave vjetore, është e domosdoshme që këto veprime të kryhen nga Ndërlidhësit e këtij sektori duke iu dhënë atyre atributet e Oficerit të Policisë Gjyqësore, si për statusin ashtu dhe ndryshimet e pagës e cila duhet të jetë e njëjtë me pagën e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Për këtë arsye, nëpërmjet shkresës **Nr. 10 452 Prot., datë 30.11.2022**, i jemi drejtuar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, duke i propozuar disa ndryshime dhe shtesa mbi domosdoshmërinë për disa përmirësime ligjore të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, konkretisht ndryshimin e pikës 3, 4 dhe shtimin e pikës 5 të nenit 22, ndryshimin e paragrafit të gërmës “b”, në pikën 1 të nenit 23, por deri më tani nuk kemi ende një përgjigje konkrete lidhur me këtë propozim.

2. Vijon të mbetet problematike gjatë punës së hasur nga Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe hetimeve të përbashkëta mungesa e kompetencës për shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve të huaja lidhur me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja në Shqipëri në ngarkim të shtetasve shqiptarë për veprat penale për të cilat Prokuroria e Posaçme ka në kompetencë, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, gjithashtu edhe paraqitja e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimet e vendimeve penale të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj me arsyetimin si më poshtë:

- Prokuroria e Posaçme nuk mund të shqyrtojë kërkesat e autoriteteve të huaja për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, për veprat penale që ka në kompetencë, pasi Ligji për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë Nr. 10 193, datë 3.12.2009 (i ndryshuar), në nenin 53, pika “4”, këtë kompetencë ia jep Prokurorit të Rrethit Gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm;
- Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme nuk mund të paraqesë një kërkesë për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj, në rastet kur ky vendim nuk mund të ekzekutohet brenda territorit shqiptar, ose në rastet kur një shtet i huaj refuzon ekstradimin e një shtetasi të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Prokuroria e Posaçme, për shkak të shtetësisë së tij sipas nenin 6/2 të Konventës Evropiane për Ekstradimin e vitit 1959, pasi këtë kompetencë ligji i lartpërmendur sipas nenit 62, pika “2” ia atribuon Prokurorisë së Përgjithshme.

- E njëjta situatë është edhe në rastet e ekzekutimit të vendimeve të huaja për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit shqiptarë që janë duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj për kryerjen e veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale;

- Apo për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit e huaj që janë duke vuajtur dënimin me burgim në Shqipëri për kryerjen e veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, pasi këtë kompetencë ia jep Prokurorisë së Përgjithshme.

Për këtë arsye, sa më lart, propozojmë ndryshimet e Ligjit për Marrëdhëniet Juridiksionale me Jashtë Nr. 10 193, datë 3.12.2009 (i ndryshuar), konkretisht në **nenin 53** e në vijim, **nenin 60** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”, Seksioni I “Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja”,** si dhe **nenit 62** e në vijim të **Kreut IV “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale”, Seksioni II “Ekzekutimi i Vendimeve Penale Shqiptare Jashtë Shtetit”,** duke i dhënë Gjykatës Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kompetencën për shqyrtimin e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale të huaja, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit shqiptar që janë duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj për kryerjen e veprave penale të parashikuara sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe paraqitjen e kërkesave për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nga një shtet i huaj gjithashtu dhe kërkesat për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme për transferimin me qëllim vazhdimin e vuajtjes së dënimit për shtetasit e huaj, që janë duke vuajtur dënimin me burgim në Shqipëri për kryerjen e veprave penale të parashikuara sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

3. Gjatë vitit 2025, është evidentuar se ka një përmirësim të dukshëm përsa i përket ekstradimit/deportimit të shtetasve shqiptarë të cilët kërkojnë për qëllim ekstradimi nga Emiratet e Bashkuara Arabe drejt Shqipërisë, megjithatë sërisht mbetet problematike çështja e ekstradimit të tyre, për këtë arsye, rezulton e nevojshme nënshkrimi i një marrëveshje dypalëshe ekstradimi mes Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Shqipërisë.

BËRTHAMA KOMANDUESE

Gjatë vitit 2025, aktiviteti i Zyrës së Përgjimeve është zhvilluar në kushte të një ngarkese të konsiderueshme pune, e përballuar me angazhim maksimal, siç evidentohet nga të dhënat statistikore në vijim.

Prioritet ka qenë zbatimi i dispozitave ligjore që normojnë veprimtarinë e kësaj Zyre.

Përgjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përdorur metodën e përgjimit për 186 procedime penale.

Për vitin 2025, Bërthama Komanduese Elektronike, ka ekzekutuar në interes të çështjeve penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

- **252 Autorizime të Prokurorit** për lejim përgjimi;
- **1738 Vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, nga të cilat:
 - **373 Vendime Lejim Përgjimi**
 - **235 Vendime Vleftësimi**
 - **1130 Vendime Zgjatjeje**

Gjatë vitit 2025, për veprat penale nën hetim nga Prokuroria e Posaçme, **janë interceptuar 3004 pajisje fundore** (pajisja/numri telefonik i subjektit në përgjim).

Nga këto, disa procedime janë finalizuar me masa të ndryshme sigurimi nga Gjykata.

Mbi të dhënat e interceptimit jashtë objektit të hetimit, është mundësuar regjistrimi i procedimeve penale kryesisht.

Më poshtë gjendet pasqyra përmbledhëse e procedimeve penale për vitin 2025 e krahasuar me vitet e mëparshme për të cilat është kërkuar përgjimi telefonik.

PASQYRËPËRMBLEDHËSE PËR PERIUDHËN 2020-2025							
	2020	2021	2022	2023	2024	2025	Krahasuar me vitin 2024 në %
Procedime penale	91	129	122	186	163	186	↑ 14.1%
Pajisje fundore	1373	1957	2177	3335	3096	3004	↓ 3%
Vendime gjykate	943	1204	1000	1669	2046	1738	↓ 15%
Autorizime të prokurorit	391	411	328	358	323	252	↓ 22%

Paraqitja grafike sipas disa zërave krahasuar me vitet e mëparshme



SEKTORI I EKSPERTIZËS

Vendimet e ardhura për ekspertim:

Gjatë vitit 2025 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 372 vendime ekspertimi për 615 prova digjitale dhe konkretisht për 503 telefona celularë dhe tabletë, 98 kompjutera, 14 DVR dhe 153 prova të tjera digjitale (hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.)

Për vitin 2024 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 400 vendime ekspertimi për 841 prova digjitale dhe konkretisht për 553 telefona celularë dhe tabletë, 110 kompjutera, 16 DVR dhe 162 prova të tjera digjitale (hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.)

Për vitin 2023 në Sektorin e Ekspertizës kanë ardhur për ekspertim 345 vendime ekspertimi për 623 prova në total dhe konkretisht 407 telefona celularë, 76 kompjutera, 19 DVR dhe 121 prova të tjera digjitale (USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Për vitin 2022 kanë ardhur për ekspertim 240 vendime ekspertimi për 500 prova digjitale dhe konkretisht 328 telefona celularë, 59 kompjutera, 11 DVR dhe 102 prova të tjera digjitale (USB, karta memorie, CD/DVD, etj.)

Akte ekspertimi të realizuara:

Gjatë vitit 2025 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 336 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 516 prova digjitale në total dhe konkretisht 375 telefona celularë dhe tabletë, 65 kompjutera, 13 DVR dhe 63 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Gjatë vitit 2024 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 293 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 520 prova digjitale në total dhe konkretisht 344 telefona celularë, 58 kompjutera, 2 DVR dhe 116 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Gjatë vitit 2023 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 261 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar 453 prova digjitale në total dhe konkretisht 321 telefona celularë, 37 kompjutera, 20 DVR dhe 75 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

Për vitin 2022 nga ekspertët e këtij sektori janë realizuar 256 akte ekspertimi, ku janë ekzaminuar gjithsej 423 prova digjitale dhe konkretisht 313 telefona celularë, 40 kompjutera, 7 DVR dhe 63 prova të tjera digjitale (si hard disqe, USB, regjistruar, tableta, karta memorie, CD/DVD, etj.).

-Sa i përket vitit 2021, në këtë vit Sektori i Ekspertizës ka filluar aktivitetin e tij, ku vendimet e para të ekspertimit kanë filluar të pranohen në muajin Shtator.

Për periudhën shtator-dhjetor 2021 kanë ardhur për ekspertim pranë këtij sektori 118 vendime ekspertimi për 174 telefona celularë, 50 kompjutera dhe 49 prova të tjera elektronike (DVR, USB, CD/DVD, kamera/aparate fotografike dixitale, etj.).

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2021 janë realizuar 35 akte ekspertimi.

-Për vitin 2025 janë realizuar 43 akte ekspertimi më shumë se viti 2024, si dhe janë ekzaminuar 4 prova digjitale më pak.

Po kështu gjatë këtij viti ekspertët e këtij sektori janë angazhuar edhe në 5 veprime të ndryshme procedurale si këqyrje apo kontrolle për sekuestrim provash digjitale dhe të dhënash kompjuterike në ambiente të ndryshme.

Prova materiale të ekzaminuara						
Viti	Akte Ekspertimi të realizuara	Telefona	Kompjuterat	DVR	Të tjera (HDD, USB, CD/DVD, etj.)	Prova në total
2025	336	375	65	13	63	516
2024	293	344	58	2	116	520
2023	261	321	37	20	75	453
2022	256	313	40	7	63	423

DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të sistemeve informatike dhe infrastrukturës IT, duke dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në mbarrëvajtjen e veprimtarisë institucionale. Veprimtaria e DTI-së është fokusuar në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës teknologjike, forcimin e sigurisë së informacionit, zhvillimin dhe administrimin e sistemeve informatike, si dhe ofrimin e mbështetjes teknike për stafin e institucionit.

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës IT

Gjatë vitit 2025 është realizuar mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve informatike, si dhe rikonfigurimi i infrastrukturës qendrore IT, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë, garantimin e përpunimit të të dhënave në kohë reale dhe mbrojtjen e informacionit nga rreziqet teknike dhe kibernetike.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka administruar dhe mirëmbajtur një gamë të gjerë sistemesh kritike të institucionit, përfshirë:

- sistemet e sigurisë kibernetike;
- sistemet e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave;
- sistemet e sigurisë fizike dhe perimetrale;
- zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Rrjetit të Klasifikuar;
- mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit telefonik institucional.

Menaxhimi i faqes zyrtare dhe mbështetja e procesit zgjedhor

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka luajtur një rol kyç në krijimin, administrimin dhe funksionimin e infrastrukturës teknologjike në mbështetje të procesit zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Kontributi i DTI-së ka përfshirë funksionimin e rubrikës “Denonco për Zgjedhjet”, konfigurimin dhe administrimin e numrit të gjelbër për denoncime, ofrimin e mbështetjes teknike për prokurorët dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH)

në terren, si dhe pjesëmarrjen aktive në procesin e monitorimit të medias gjatë periudhës zgjedhore.

Gjatë vitit 2025 janë publikuar gjithsej 222 njoftime, konkretisht 114 njoftime për shtyp dhe 108 njoftime për punësim, duke kontribuar në forcimin e komunikimit institucional dhe rritjen e nivelit të transparencës ndaj publikut.

Akresi në bazat shtetërore të të dhënave

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, SPAK ka akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit të institucioneve shtetërore. Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka mirëmbajtur dhe administruar këto lidhje, duke garantuar akses të sigurt dhe funksional në 22 sisteme dhe baza të dhënash shtetërore, nga të cilat 3 sisteme janë integruar gjatë vitit 2025 në listën ekzistuese. Kjo ka kontribuar në përmirësimin e ndjeshëm të shpejtësisë, sigurisë dhe eficiencës së proceseve hetimore.

Suporti për përdoruesit dhe dokumentacioni

DTI ka ofruar suport të vazhdueshëm teknik për stafin e institucionit dhe ka hartuar dokumentacion teknik dhe udhëzues të nevojshëm, përfshirë manuale përdorimi dhe dokumente të sigurisë. Gjithashtu, drejtoria ka marrë pjesë aktive në komisione prokurimi për pajisje dhe sisteme IT, si dhe është angazhuar në grupe të ndryshme pune që i shërbejnë mbarëvajtjes së veprimtarisë institucionale.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pajisjet

Gjatë vitit 2025, SPAK ka përfitur pajisje dhe licenca softëare për sisteme informatike nga partnerë ndërkombëtarë si **OSCE, NCA dhe CILC**, duke forcuar kapacitetet teknologjike dhe analitike të institucionit.

Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve

Nga 1 janari 2025 ka vijuar implementimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve të SPAK ku në 6-mujorin e parë janë zhvilluar dhe konsoliduar modulet: Moduli i Protokollit, Moduli i Drejtuesit të SPAK, Moduli i Regjistrimit të Kallëzimeve dhe Moduli i Hetimit të Çështjes.

Gjatë gjysmës të dytë të vitit 2025 u përfunduan dhe u implementuan me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara për këtë fazë të projektit, duke u mbështetur në sistemin bazë tashmë operacional që prej janarit 2025. Kjo fazë u fokusua në finalizimin e moduleve kritike që lidhen me raportimin, statistikën, hetimin e procedimeve dhe referimin e pasurive.

Në mënyrë të veçantë, u realizua:

- implementimi i plotë i Modulit të Raportimit dhe Statistikave, përfshirë modelet zyrtare të raportimit;
- përfundimi i Modulit të Hetimit të Procedimeve dhe Referimit të Pasurive.

Projekti është iniciuar nga misioni ICITAP dhe gjatë vitit 2025 është mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, për të garantuar funksionalitetin e plotë të sistemit.

Sistemi ka kontribuar në rritjen e eficiencës së proceseve administrative dhe hetimore, si dhe në përmirësimin e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave statistikore.

KOMISIONI I POSAÇËM I VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE PASTËRTISË SË FIGURËS GJATË VITIT 2025

Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, i cili krijohet sipas pikës 12 të nenit 57, dhe e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të pikës 6, të nenit 6, dhe nenit 7 të ligjit. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ka në përbërje të tij një gjyqtar nga Gjykata e Apelit e Posaçme i zgjedhur me short, dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme të zgjedhur me short, ku procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit, një hetues I BKH-së, një Hetues Financiar nga Seksioni i Hetimit Financiar në Spak.

Gjatë vitit 2025 Komisioni ka përfunduar verifikimet e plota të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për 42 (dyzet e dy) kandidatë për personel administrativ ne Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Po gjatë këtij viti Komisioni ka mbaruar procesin e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës edhe për 7 (shtatë) kandidatët për Drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Gjatë këtij viti janë paraqitur 38(tridhjetë e tetë) kërkesa të reja për personel administrativ ne Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në këto kërkesa tre prej tyre janë për Gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë proces kanë përfunduar verifikimet për Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Ky Komision kryen një punë shumë voluminoze, pasi përveç vendimmarrjes për kryerjen e verifikimeve nga ILDKPI dhe DSIK, vazhdon me analizën e thelluar të raporteve të përcjella nga këto dy institucione, për çdo subjekt verifikimi. Kryen verifikime të drejtpërdrejta në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme, Prokurorinë e Përgjithshme, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Agjencinë e Inteligjencës Financiare, SHISH, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Departamentin e Administratës Publike.

Pas administrimit dhe analizimit të të gjitha të dhënave të grumbulluara Komisioni përpilon dhe i përcjell institucionit të emërtesës raportin e hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës.

E rëndësishme për tu theksuar në vonesën e punës së Komisionit janë vonesat në kthimin e përgjigjeve nga institucionet verifikuese, gjë që pasjellë vonesën në përpilimin e raporteve.

Gjithashtu një ndihmë në mbarëvajtjen e punës do të përbënte prania e një sekretari full time në ndihmë të punës së Komisionit.

Në përmbledhje gjatë vitit 2025, Komisioni ka përfunduar raportet e verifikimit të Pasurisë dhe Pastërtisë së Figurës për **49 (dyzet e nëntë)** subjekte dhe kryen dhe vazhdon verifikimet edhe për **46 (dyzetë e gjashtë)** subjekte.

KOMPETENCA E INSTITUCIONIT TË ISH - KOMISIONERËVE PUBLIKË

Duke filluar nga data 1 janar 2025, në zbatim të nenit 179/b, pika 8, të Kushtetutës, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë pas shpërbërjes së tyre, mbarimi i mandatit të të cilëve ka ndodhur më datë 31.12.2024, referuar parashikimit kushtetues në ligjin nr. 16/2022, ‘Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”’, të ndryshuar.

Ky parashikim kushtetues ka siguruar vazhdimësinë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për ankimet e ushtruara nga Komisionerët Publikë dhe të pashqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, deri në datën 31.12.2024.

Në këtë kuadër, duke u bazuar edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Ministrisë së Drejtësisë, të datës 26.12.2024, pas përfundimit të procesit të marrjes në dorëzim të dosjeve që u përkasin ankimeve të Komisionerëve Publikë dhe aseteve të Institucionit të Komisionerëve Publikë nga ana e Prokurorisë së Posaçme, u krijuan të gjitha kushtet e nevojshme për vazhdimin normal të punës në fillim të vitit 2025 e në vijim.

Ankimet e Komisionerëve Publikë, të pashqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit deri në datën 31.12.2024, janë ndjekur gjatë vitit 2025 nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, së bashku me dy prokurorë të autorizuar prej tij, përkatësisht Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit dhe Drejtuesi i Seksionit Kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit.

Të dhënat statistikore mbi shqyrtimin e çështjeve gjatë vitit 2025

Gjatë periudhës 01.01.2025 – 31.12.2025, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit janë shqyrtuar gjithsej 32 ankime, të ushtruara nga Komisionerët Publikë, nga një total prej 41 ankimesh të kaluara tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme pas përfundimit të mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë.

Numri i lartë i ankimeve të shqyrtuara pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit gjatë vitit 2025 reflekton nivelin e lartë të angazhimit të Prokurorisë së Posaçme për përfundimin e çështjeve të kaluara nga Komisionerët Publikë, duke treguar prioritetin e dhënë për mbylljen e procesit të rivlerësimit kalimtar brenda afatit të parashikuar nga dispozitat kushtetuese.

Të dhëna mbi ecurinë e çështjeve të ndjekura gjatë vitit 2025

Lidhur me seancat gjyqësore publike të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me objekt ankimet e Komisionerëve Publikë, të ndjekura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorët e

autorizuar prej tij gjatë vitit 2025, ecuria e çështjeve në Kolegj dhe statusi i tyre deri më datë 31.12.2025 paraqiten si më poshtë:

Nga 32 çështjet gjyqësore të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me objekt shqyrtimin e ankimeve të Komisionerëve Publikë gjatë vitit 2025, për 28 çështje është përfunduar shqyrtimi gjyqësor me vendim të formës së prerë, ndërsa 4 çështje të tjera janë ende në proces shqyrtimi. Lidhur me këto 4 çështje, që janë ende në proces shqyrtimi, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar disa seanca gjyqësore, por shqyrtimi gjyqësor i tyre nuk ka përfunduar dhe çështjet vijojnë të jenë në proces në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, proces i cili pritet të përfundojë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026.

Këto të dhëna tregojnë se, gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme ka arritur të përfundojë trajtimin/përfaqësimin e një numri të konsiderueshëm çështjesh të kaluara nga përfundimi i mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, rreth 68% të totalit të tyre, çka pasqyron angazhimin e lartë dhe prioritetin e dhënë për përmbylljen e procesit të rivlerësimit kalimtar brenda afatit kushtetues.

Përfundimi i një numri të konsiderueshëm çështjesh brenda vitit 2025, duke pasur parasysh volumin dhe kompleksitetin e tyre, dëshmon për efikasitetin dhe angazhimin profesional të përfaqësuesve të Prokurorisë së Posaçme në ushtrimin e kompetencave të ish-Komisionerëve Publikë, duke ruajtur njëkohësisht standardet e vendosura gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Të dhëna mbi angazhimin në seancat gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Gjatë vitit 2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorët e autorizuar prej tij, kanë marrë pjesë aktivisht në seancat gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke trajtuar dhe përfaqësuar çdo çështje të kaluar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë.

Konkretisht, gjatë vitit 2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorët e autorizuar prej tij, kanë ndjekur në total 107 seanca gjyqësore publike të zhvilluara pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (përfshirë këtu edhe seancat e shpalljes së vendimeve), në funksion të shqyrtimit gjyqësor të çështjeve me objekt ankimet e Komisionerëve Publikë.

Ky numër i lartë i seancave gjyqësore të zhvilluara, reflekton një volum të konsiderueshëm të punës përgatitore në një proces të specializuar, si ai i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u realizuar paralelisht me angazhimet e përditshme të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Përmes angazhimit të lartë të burimeve njerëzore në këtë proces, gjatë vitit 2025 është bërë e mundur të sigurohet një përfaqësim efektiv dhe profesional, si dhe të ruhet integriteti i standardeve të vendosura, në funksion të mbrojtjes së interesit publik.

Të dhëna lidhur me vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në raport me kërkimin përfundimtar të ankimeve

Sa u takon rezultateve të shqyrtimit të çështjeve dhe vendimmarrjes nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga 28 çështjet për të cilat shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar gjatë vitit 2025, për 24 prej tyre, ose rreth 86% të çështjeve, vendimi i Kolegjit ka qenë në përputhje me kërkimin përfundimtar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ose është vendosur pushimi i shqyrtimit të

çështjes. Në këtë kategori përfshihet edhe një çështje, për të cilën Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka vendosur heqjen dorë nga ankimi.

Ndërsa për 4 nga 28 çështjet e përfunduara gjatë vitit 2025, vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit ka qenë e ndryshme nga kërkimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorëve të autorizuar prej tij në përfaqësimin e çështjeve pranë Kolegjit.

Gjatë vitit 2025, ushtrimi i kompetencave të ish-Komisionerëve Publikë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, megjithëse ka përfaqësuar një ngarkesë të konsiderueshme, që ka kërkuar angazhimin maksimal të Drejtuesit dhe prokurorëve të autorizuar prej tij, ka rezultuar efikas, duke u zhvilluar në përputhje me kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi.

Përparimi i arritur në përfundimin e çështjeve të kaluara nga Komisionerë Publikë, ka kontribuar në konsolidimin e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe ka ndihmuar në forcimin e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë.

Për vitin 2026, parashikohet shqyrtimi i 13 çështjeve/ankimeve të kaluara nga Komisionerët Publikë. Trajtimi i këtyre çështjeve do të vijojë nën drejtimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorëve të autorizuar prej tij, dhe parashikohet të përfundojë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, në përputhje me afatin kushtetues.

Procesi do të garantojë jo vetëm respektimin e standardeve të larta profesionale, por edhe një trajtim të drejtë, të paanshëm dhe transparent të çdo çështjeje, duke ruajtur integritetin dhe kredibilitetin e institucioneve të drejtësisë.

KOORDINATORI PËR MARRËDHËNIEN ME MEDIAN DHE E DREJTA E INFORMIMIT

Përgjatë vitit 2025, Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat ka luajtur një rol aktiv në forcimin e komunikimit mes Prokurorisë së Posaçme, qytetarëve, gazetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Në zbatim të ligjit nr. 95/2016 dhe udhëzimeve të Drejtuesit të institucionit, janë trajtuar me korrektësi kërkesat për informacion, si dhe është punuar për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit 2025–2028. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar publikime të rregullta të njoftimeve për shtyp dhe postime në rrjetet sociale të SPAK, Facebook dhe X.

Koordinatori ka qenë i angazhuar në organizimin e seancave informuese me gazetarët, konferencave për shtyp dhe intervistave, si dhe në adresimin e kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve drejtuar institucionit. Përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me gazetarët e mediave kombëtare, ndërkombëtare dhe reporterët e pavarur (freelance), është siguruar përcjellja e informacionit për çështje të ndryshme me interes publik.

Përmirësimi i komunikimit institucional dhe transparenca

Për të arritur disa nga objektivat e Strategjisë së Komunikimit është punuar për përmirësimin e komunikimit të brendshëm institucional dhe përgatitjen paraprake të njoftimeve apo deklaratave për shtyp. Koordinatori ka mundur gjithashtu përditësimin e “Regjistrisë së kërkesave dhe përgjigjeve”, i cili sipas ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” (i ndryshuar) duhet të

publikohet dhe përditësohet çdo muaj në faqen zyrtare të institucionit, më konkretisht në kategorinë **“Programi i Transparencës / Programi i Transparencës SPAK”**.

Koordinatori për Marrëdhënien me Median ka qenë në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit në përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin dhe publikimin sa më korrekt të kërkesave për informim, siç është vepruar gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025.

Përgjigjet ndaj kërkesave dhe pyetjeve të qytetarëve dhe gazetarëve

Në këtë raport nuk janë përfshirë pyetjet për çështje që kërkojnë përgjigje të shpejta për shkak të ndikimit të tyre në publik. Në këto raste, Koordinatori, në bashkëpunim me Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, u ka dhënë përgjigje kryesisht pyetjeve nga gazetarët. Këto kërkesa zënë një numër të vogël krahasuar me ato që protokollohen dhe adresohen nga institucioni.

Në të gjitha rastet e përgjigjeve individuale apo në grupin e ËhatsApp-it të gazetarëve që ndjekin zhvillimet që lidhen me Strukturën e Posaçme, përgjigjet kanë qenë shteruese dhe të mbështetura në referenca të qarta ligjore për çështjet që janë në hetim paraprak apo në gjykim.

Gjatë kësaj periudhe është vënë re një rritje e numrit të kërkesave për informacion, në brendësinë e të cilave janë përfshirë disa pyetje që prekin tematika të ndryshme. Kjo situatë kërkon angazhim të dedikuar të burimeve njerëzore, veçanërisht të Zyrës së Regjistrimit, nga e cila sigurohen të dhënat e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për të adresuar këto kërkesa, rekomandohet që aktorët e jashtëm të shfrytëzojnë më gjerësisht burimet publike të informacionit, (raportet vjetore, njoftimet për shtyp, etj.), si dhe të paraqesin kërkesa më të strukturuar dhe të fokusuar. Kjo qasje do të kontribuonte në përpunim më efikas të kërkesave, në reduktimin e ngarkesës administrative dhe në optimizimin e përdorimit të burimeve njerëzore.

Gjithashtu, publikimi i Regjistrimit të Transparencës mbetet burim i hapur, i cili mund të konsultohet nga qytetarët, gazetarët/media, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, të cilët mund të gjejnë informacionin dhe përgjigjet në faqen e internetit të SPAK.

Intervistat e zhvilluara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar rreth 8 intervista nga Prokurorët e Posaçëm, të transmetuara apo publikuara sipas temave:

1. **14 shkurt**⁷ - Intervistë e prokuroren, Dolorosa Musabelliu mbi pasuritë e krimit të organizuar e dhënë për Birn Albania dhe është publikuar në formën e një dokumentari të shkurtër në faqen ëëë.reporter.al si edhe në youtube, ku ka marrë 594 shikime.
2. **21 maj**⁸ - Intervistë me prokurorin e posaçëm, Vladimir Mara i cili flet për personat e penduar dhe bashkëpunimin e tyre me drejtësinë. Ky dokumentar i transmetuar në Top Channel ka marrë 176,988 shikime në Youtube.

⁷ Lufta kundër pasurive të krimit të organizuar përballet me pengesa – Reporter.al

⁸ ‘PENTITO’ - "Materiale ekskluzive, vrasësit që tronditën organizatat kriminale"-Inside Story.

3. **23 maj**⁹ - Intervistë e prokurores Dolorosa Musabelliu, e cila flet për investimin e parave të krimit të organizuar shqiptar dhe lidhjet e tij në Ballkan, e dhënë për Birn Kosovën, si pjesë integrale e një dokumentari që trajtonte temën e pastrimit të parave. Ky dokumentar është publikuar në faqen Kallxo.com dhe është lexuar nga 20 mijë lexues, është shfaqur në Dukagjini TV si edhe në formatin e kinemasë në Reporting House (Muzeu i Krimeve të Luftës në Prishtinë). Në rrjetet sociale numëron mbi 45 mijë shikime ndërsa në youtube 4036 shikime. Ky artikull është publikuar edhe gjuhën angleze¹⁰ në Prishtina Insight.
4. **29 maj**¹¹ - Intervistë e me prokurorin, Alfred Shehu mbi trafikun e kokainës nga Amerika Latine në Shqipëri dhënë medias vendore Citizen Channel. Dokumentari dhe materialet e tjera (klipet e shkurtuara) kanë marrë 250.000 shikime në Youtube dhe Median Sociale. Dokumentari është transmetuar gjithashtu tek “Ora Neës”, në emisionin “Ora e Betit”.
5. **5 nëntor 2025**¹² - Intervistë mbi mandatin 3-vjeçar në krye të SPAK të z. Altin Dumani. Intervista e transmetuar në RTSH ka marrë 58.241 shikime dhe pjesë të saj janë ndarë edhe në mediat online.
6. **24 tetor 2025**¹³ - Rrjetet e fshehta financiare pas grupeve të narkotrafikut shqiptar. Shkrimi i referohet transferimit të parave përmes sistemit Haëala dhe kriptovalutave në shërbim të grupeve të narkotrafikut. Ky shkrim numëron 6602 lexime në shqip dhe 3767 në versionin anglisht të publikuar në BalkanInsight¹⁴.
7. **20 dhjetor 2025** - “Altin Dumani, prokurori që guxoi dhe nuk tërhiqet! Intervista e fundit para dorëzimit të detyrës, kreu i SPAK i thotë të gjitha për Revistën Neësbomb.al.”¹⁵
8. **24 dhjetor 2025**¹⁶ - “Askush nuk është mbi ligjin”, reagimi i parë publik i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme z. Klodjan Braho.

Konferencat për shtyp:

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 4 konferenca për shtyp:

- **21 maj** – Konferencë e përbashkët me autoritetet italiane për operacionin antidrogë me 52 urdhër-arreste me një mbulim të gjerë në median vendase.
- **3 qershor** – Konferencë e përbashkët me autoritetet finlandeze për operacionin mbi trafikun e drogave sintetike

⁹ Dokumentar - Varfëria nga shpëlarja e parave;

¹⁰ Albanian Prosecutor Reveals Money Laundering Networks and Criminal Methods - Prishtina Insight Prishtina Insight

¹¹ Rrugë e kokainës: Nga Kolumbia në Shqipëri | Cocaine Route: Colombia to Albania | Dokumentar - YouTube

¹² Drejtësia e Altin Dumanit, kreu i SPAK rrëfëhet në 'Dialog' - RTSH

¹³ Exchange: Rrjetet e fshehta financiare pas grupeve të narkotrafikut shqiptar – Reporter.al

¹⁴ Moving Albanian Drug Money, on Trust or in Crypto | Balkan Insight

¹⁵ <https://newsbomb.al/aktualitet/altin-dumani-prokurori-qe-guxoi-dhe-nuk-terhiqet-intervista-e-fundit--i380455>

¹⁶ New Chief of Albania's Anti-Graft Prosecution Vows 'Tough Approach' | Balkan Insight

- **31 korrik** – Konferencë me autoritetet gjermane për hetimet paralele mbi krimin kompjuterik
- **22 dhjetor** – Ceremonia e emërimit të Drejtuesit të SPAK, z. Klodjan Braho

Takime informuese me gazetarët

- Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 3 takime informuese më 20 janar, 31 korrik dhe 15 dhjetor 2025, të fokusuar tek vijimi i çështjeve me interes të lartë publik dhe sqarime teknike e ligjore rreth tyre.

Kërkesat për informacion

Gjatë vitit 2025 kanë mbërritur dhe protokolluar 238 kërkesa dhe janë trajtuar 170 kërkesa për informacion, të mbërritura kryesisht nga gazetarët vendas dhe të huaj, të shpërndara sipas muajve:

- 19 kërkesa për informacion gjatë muajit janar;
- 5 kërkesa për informacion gjatë muajit shkurt;
- 21 kërkesa për informacion gjatë muajit mars;
- 27 kërkesa për informacion gjatë muajit prill;
- 20 kërkesa për informacion gjatë muajit maj;
- 19 kërkesa për informacion gjatë muajit qershor;
- 18 kërkesa për informacion gjatë muajit korrik;
- 10 kërkesa për informacion gjatë muajit gusht;
- 10 kërkesa për informacion gjatë muajit shtator.
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit tetor.
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit nëntor.
- 7 kërkesa për informacion gjatë muajit dhjetor.

Gjithashtu, Koordinator i u ka dhënë përgjigje verbalisht gazetarëve, qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat janë dokumentuar në dokumentet e brendshëm zyrtarë. **Në total numri i tyre është 43; 19 përgjigje për gazetarët, 21 qytetarët dhe 3 për organizatat e shoqërisë civile.**

Publikimet dhe vizitorët në faqen zyrtare

Gjatë periudhës raportuese janë publikuar **114 njoftime për shtyp** në faqen zyrtare të SPAK, e cila ndiqet nga 109,496 vizitorë, krahasuar me 82,766 vizitorë në vitin 2024. Numri i shikimeve të faqes ka arritur 563,453, krahasuar me 437,882 në vitin 2024.

Gjatë vitit 2025, Koordinator i ka realizuar 8 intervista dhe 4 konferenca për shtyp, ka zhvilluar 3 takime informuese me gazetarët, ka trajtuar 165 kërkesa për informacion dhe ka dhënë përgjigje përmes 42 memove të dokumentuara për qytetarë dhe media. Publikimet në faqen zyrtare të SPAK kanë arritur 114 njoftime. Kjo faqe ndiqet nga 109,496 vizitorë, duke shënuar një rritje të dukshme krahasuar me vitin 2024. Shifrat e mësipërme pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të SPAK për transparencë, qasjen për një informim efikas në përpjekje për të forcuar besimin e qytetarët tek SPAK.

DOKUMENTACIONI I KLASIFIKUAR DHE I PAKLASIFIKUAR

Janë regjistruar në Regjistrin elektronik të korrespondencës 44392 shkresa të ndryshme (praktika hyrëse dhe dalëse).

Janë regjistruar 2433 materiale kallëzuese, nga të cilat 610 materiale kallëzuese janë dërguar për kompetencë, 263 materiale kallëzuese janë dërguar për verifikim, 372 materiale kallëzuese janë dërguar për vlerësim, për 282 materiale kallëzuese është kthyer përgjigje, si dhe 738 materiale kallëzuese janë arkivuar ose janë shtuar në dosjet ekzistuese.

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në përmbushje të kompetencave të tij ligjore të parashikuara në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ka nxjerrë 526 urdhra ndër të cilët:

- 7 Urdhra të Përbashkët me Drejtorin e BKH-së;
- 3 Strategji;
- 2 Udhëzime të Përgjithshme;
- 2 Rregullore të miratuara;
- 5 Marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara me institucionet publike;
- 4 Marrëveshje dhurimi;
- 6 Memorandume dhe 1 Deklaratë e përbashkët me autoritetet e huaja.

Kancelari në funksion të ushtrimit të kompetencave, në bazë të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në funksion gjithashtu edhe të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të deleguar, ka nxjerrë 1089 urdhëra administrativë, financiarë dhe si Autoritet Kontraktor i deleguar,

Janë regjistruar në regjistrin elektronik të protokollit 914 kërkesa nga institucionet shtetërore, për të cilat janë kthyer 888 përgjigje, 7 shkresa janë arkivuar;

Janë regjistruar 1119 kërkesa/memo dhe informacione nga avokatët, nga të cilat janë kthyer 385 përgjigje, pjesa tjetër trajtohet nga prokurorët e çështjes;

Janë regjistruar 24 kërkesa nga Shoqëria Civile, nga të cilat 15 ju është kthyer përgjigje, 5 janë arkivuar dhe 4 trajtohen nga prokurorët sipas çështjeve;

Janë regjistruar 688 kërkesa/ informacione/ etj., nga të cilat iu është kthyer përgjigje 374 prej tyre, ndërsa 61 janë arkivuar, ku pjesa tjetër po trajtohet nga prokurorët sipas çështjeve;

Janë regjistruar 2449 kërkesa, vërtetime të shtetasve ose subjekteve, (kërkesa për punësim për efekt verifikimi nga regjistri) dhe iu është kthyer përgjigje 2430;

Gjithashtu në regjistrin elektronik janë evidentuar 358 në shërbim të kompetencave që Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, trajtoi si Komisioner Publik.

Janë regjistruar 1022 materiale në Regjistrin Sekret për vitin 2025.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, DOKUMENTACIONIT DHE SHËRBIMEVE

Zhvillimi i burimeve njerëzore, në përputhje me objektivat dhe zbatimin e politikave përkatëse të Prokurorisë së Posaçme, synon të krijojë një mjedis pune të përshtatshëm dhe motivues, që i shërben jo vetëm rritjes profesionale të punonjësve, por dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

Plani i punësimeve, sipas organigramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme

Me ligjin nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Prokurorisë së Posaçme i është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, fondi i pagave, i cili do të mundësonte plotësimin e nevojave të organigramës, strukturës së Prokurorisë së Posaçme, me 144 punonjës në përputhje me Urdhërin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 70, datë 06.01.2025 “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.

Procesi i punësimeve, për pozicionet e parashikuara në organigramën, strukturën e Prokurorisë së Posaçme

Në mbështetje të ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të ndryshuar, të ligjit nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të ndryshuar, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të ndryshuar, të udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike, si dhe të Urdhërit nr. 70, datë 06.01.2025 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, bazuar në planin e mësipërm të punësimit, vakancave shtesë të krijuara gjatë vitit 2025, është vijuar me shpalljen e procedurave për plotësimin e vendeve vakante, në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme, si dhe në Shërbimin Kombëtar të Punësimit për të cilat janë zhvilluar procedurat përkatëse, të punësimit, për plotësimin me personel administrativ.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2025 kanë ushtruar detyrën gjithsej 124 punonjës, nga të cilët 20 (njëzet) Prokuror të emëruar, 12 (dymbëdhjetë) Hetues Financiarë, 92 (nëntëdhjetë e dy) punonjës administrativë dhe 4 (katër) punonjës me kontratë të përkohshme.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2025, janë shpallur dhe zhvilluar procedura të punësimit për 11 pozicione të ndryshme, ku janë punësuar 12 (dymbëdhjetë) punonjës (1 (një) nga procedura e shpallur gjatë vitit 2024), nga të cilët:

- ✓ të emëruar me kontratë pune janë 9 (nëntë) punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor Kabineti dhe 7 (shtatë) Këshilltarë ligjor/ekonomik, në Kabinetin e Drejtuesit, 1 (një) Përgjegjës

Spektori të Hetuesve Financiar, 1 (një) Punonjës Pastrimi, 1 (një) Shofer Prokurori dhe 1 (një) Oficer Informacioni, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse;

- ✓ të emëruar me procedura sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, janë 12 (dhjetë) punonjës, nga të cilët 7 (shtatë) punonjës të emëruar me procedurën “Pranim në shërbimin civil”, 4 (katër) punonjës të emëruar me procedurën “Lëvizje paralele” dhe 1 (një) punonjës të emëruar me procedurën “Ngritje në detyrë”;
- ✓ në mbështetje të Vendimit nr. 19, datë 09.01.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, pranë Prokurorisë së Posaçme për vitin 2025 kanë ushtruar funksionin 2 (dy) punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 6 orë në ditë, me afat 1-vjeçar dhe 2 (dy) punonjës me kontratë pune, me kohëzgjatje 8 orë në ditë, me afat 6-mujor.

Gjatë vitit 2025, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kanë dhënë dorëheqjen, janë ngritur në detyrë ose janë larguar nga shërbimi civil 7 (shtatë) punonjës, si më poshtë vijon:

- ✓ 2 punonjës të kategorisë ekzekutive për arsye të dorëheqjes;
- ✓ 2 punonjës të kategorisë ekzekutive për arsye të lëvizjes paralele;
- ✓ 2 punonjës me kontratë për arsye të ngritjes në detyrë;
- ✓ 1 punonjës me kontratë, ka përfunduar marrëdhënien e punës, për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie.

Në mënyrë të përmbledhur numri i pozicioneve të punësuar në Prokurorinë e Posaçme për vitin 2025, paraqitet si më poshtë:

Statusi	Kategoria	Numri i të emëruarve për vitin 2025
Nëpunës civil	E ulët drejtuese	2
Nëpunës civil	Ekzekutive	8
Me Kod Pune	Kabineti i Drejtuesit	8
OPGJ	Spektori i Hetimit Financiar	1
Me Kod Pune	Punonjës Administrate	3
Total		22

Në përfundim të vitit 2025, për arsye të shtimit të strukturës së Prokurorisë së Posaçme me 17 punonjës, të lëvizjes së punonjësve ekzistues, si dhe për arsye objektive si rezultat i mungesës së zyrave janë zhvilluar procedura që kanë qenë të domosdoshme, procedurat e mbetura të rekrutimit, për pozicione pjesë e planeve të rekrutimit të vitit 2025, që duhet të zhvillohen gjatë vitit 2026.

Shkalla reale e plotësimit të Drejtorive/Sektorëve të Prokurorisë së Posaçme, në fund të vitit 2025, krahasuar me numrin e punonjësve sipas strukturës dhe organikës, të aprovuar me Urdhërin nr. 70, datë 06.01.2025 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme “Për miratimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, të ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

Drejtoria/Sektori	Organika/ Struktura	Aktualisht	Vakancë
Drejtuesi i Prokurorisë/prokuror	1	1	0
Kabineti i drejtuesit	15	10	5
Prokuror	19	19	0
Sektori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Hetime të Përbashkëta	3	3	0
Bërthama Komanduese Elektronike	2	2	0
Sektori i Hetimit Financiar	16	12	4 (në proces)
Sektori i Ekspertizës	8	4	4
Sektori i Asistencës për Individët me Status të Posaçëm	2	1	1
Sekretaria Administrative	14	13	1
Sektori i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale	3	3	0
Sektori i Raportimeve pranë Bashkimit Europian	3	3	0
Kancelari	1	1	0
Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	9	8	1
Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit	7	5	2
Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve	41	39	2
Total	144	124	20

Struktura e miratuar e Prokurorisë së Posaçme që nga krijimi i saj në vitin 2019 deri në vitin 2025, se bashku me plotësimin e emërimeve të Drejtorive/Sektorëve të Prokurorisë së Posaçme, në mënyrë krahasimore paraqitet, si më poshtë:

Prokuroria e Posaçme	Prokuror		Hetues Financiar		Ekspert		Status nëpunësi civil		Me Kod Pune	
	Sipas strukt urës	Emë ruar	Sipas strukt urës	Emë ruar	Sipas strukt urës	Emë ruar	Sipas strukt urës	Emë ruar	Sipas strukt urës	Emë ruar
Viti										
2019		6	0	0	0	0		12		10
2020	14	13	8	0	22	16	33	20	22	12
2021	20	17	4	0	8	8	32	26	20	19
2022	20	17	8	0	7	5	52	38	25	25
2023	20	18	16	12	10	5	59	44	28	27
2024	20	20	16	12	10	6	59	45	28	27
2025	20	20	16	12	10	6	59	52	39	34

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË KANDIDATIT PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT DHE PËR POZICIONIN HETUES FINANCIAR, NË PROKURORINË E POSAÇME.

Procesi i përzgjedhjes së kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit

Prokuroria e Posaçme, më datë 07.04.2025, ka nisur procedurën e përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, duke qenë se, më datë 31.08.2025 përfundonte mandati i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, bazuar dhe në kërkesën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Procesi

i përzgjedhjes së kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ka qenë një proces i rëndësishëm me qëllim vijimin e veprimtarisë së kësaj strukture të specializuar. I gjithë procesi është zhvilluar duke respektuar detyrimet e parashikuara nga ligji nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, të ndryshuar, i mbështetur plotësisht në parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe objektivitetit, duke garantuar një proces të qëndrueshëm, profesional dhe të dokumentuar me korrektësi. Në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë qenë të pranishëm në rolin e vëzhguesit përfaqësues të ICITAP, OPDAT dhe të BE në Shqipëri.

Komisioni i Përzgjedhjes, ka miratuar me vendimin nr. 1, rregulloren “*Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit*”, në të cilën është përcaktuar se procesi i përzgjedhjes dhe propozimit për emërim/riemërim të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit do të realizohet në 6 (gjashtë) faza, si më poshtë:

1. Ekzaminimi paraprak i aplikimit;
2. Vizitë mjekësore dhe test për aftësitë fizike;
3. Provim i zgjeruar me shkrim (Ese) dhe test për arsyetimin logjik;
4. Testi i poligrafit dhe intervistës në panel;
5. Verifikim figure, deklaram i pasurisë;
6. Identifikimi i kandidatit fitues, trajnimi dhe propozimi për emërim/riemërim.

Komisioni i Përzgjedhjes më datë 26.11.2025, pas shqyrtimit në tërësi të të gjithë procesit, marrë në konsideratë edhe raportet e verifikimit të pasurisë dhe figurës për të 7 (shtatë) kandidatët, me shumicë votash vendosi përzgjedhjen e kandidatit z. Joni Keta dhe rekomandimin Këshillit të Lartë të Prokurorisë për emërimin në pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një mandat 5-vjeçar.

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin Hetues Financiar, pranë Prokurorisë së Posaçme

Prokuroria e Posaçme, më datë 27.05.2025, ka nisur procedurën për punësimin e 4 (katër) Hetues Financiar, në Sektorin e Hetimit Financiar, pranë Prokurorisë së Posaçme. I gjithë procesi është zhvilluar duke respektuar detyrimet e parashikuara nga neni 21, të ligjit nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, të ndryshuar, si dhe në Rregulloren nr. 248, datë 27.04.2022, “*Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurrimit dhe emërimit të hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar, në Prokurorinë e Posaçme*”, i mbështetur plotësisht në parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe objektivitetit, duke garantuar një proces të qëndrueshëm, profesional dhe të dokumentuar me korrektësi.

Në Rregulloren nr. 248, datë 27.04.2022, “*Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurrimit dhe emërimit të hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar, në Prokurorinë e Posaçme*”, është përcaktuar se, procesi i përzgjedhjes për hetues financiar do të realizohet nëpërmjet 3 (tre) faza nëpërmjet një procesi pikëzimi, si më poshtë:

1. Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve;

2. Faza e dytë, vlerësimi me shkrim;
3. Faza e tretë, intervista e strukturuar me gojë;

Kandidatët që kanë kaluar fazën e konkurrimit dhe janë përzgjedhur në listën fituese, do t'i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës.

Komisioni i Përzgjedhjes ka zhvilluar dhe ka përfunduar më datë 24.11.2025 të tre fazat e konkurrimit për kandidatët që kanë aplikuar për t'u emëruar hetues financiar, në Sektorin e Hetimit Financiar.

Aktualisht kjo procedurë është në fazën e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës.

Trajnimet e punonjësve

Që një institucion të realizojë qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në ligj, duhet jo vetëm të disponoj burimet e nevojshme, por edhe t'i përdorë ato me efektivitet. Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve të Prokurorisë së Posaçme, e cila vjen gjithmonë e në rritje, roli i një personeli administrativ të trajnuar në funksionet mbështetëse është shumë i rëndësishëm për performancën dhe efikasitetin e Prokurorisë së Posaçme. Për këtë arsye, Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2024 me Urdhërin nr. 679, datë 09.10.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, miratoi *“Planin e trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023-2026”*.

Prokurorët dhe Hetuesit Financiar zhvillojnë trajnime, të cilat kryesisht kanë pasur në vëmendje ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe profesionale në aspektin e hetimit dhe ndjekjes penale, të cilat zhvillohen nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe Projektet e ndryshme ndërkombëtare.

Për ngritjen e kapaciteteve profesionale të burimeve njerëzore, lidhur me trajnimet, gjatë vitit 2025, nga Prokuroria e Posaçme kanë ndjekur trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP) gjithsej rreth 74 punonjës, nga Komisioni Europian dhe Organizata të tjera Ndërkombëtare rreth 106 punonjës, nga institucione trajnuese të tjera rreth 17 punonjës. Në total punonjësit e Prokurorisë së Posaçme kanë ndjekur rreth 58 tema të ndryshme trajnimi, nga një numër i përgjithshëm me rreth 197 punonjës.

Gjithsesi gjatë vitit 2025 në bashkëpunim me ASPA, Shkolla e Magjistraturës, CILC, EU4LEA, FBI dhe institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, janë kryer “on-line” dhe fizikisht trajnimet e planifikuara.

Në mënyrë të përmbledhur gjatë vitit 2025 temat e trajnimeve të kryera, institucionet trajnuese dhe numrin e punonjësve pjesëmarrës për çdo temë trajnimi të kryer, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Institucioni i organizimit të trajnimit	Nr. Trajnimeve	Nr. Punonjësve
1	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	23	74
2	Komisioni Europian, Organizata të tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare	30	106
3	Trajnime nga institucione të tjera	5	17

Gjithashtu, gjatë vitit 2025, kryen dhe përfunduan trajnimin e detyrueshëm 2 (dy) javor, pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, *"Prezantimi me Administratën Publike"*, duke kaluar me sukses edhe testin përkatës, 3 (tre) punonjës, të emëruar nëpunës civil në periudhë prove.

Të gjithë këta punonjës kanë kryer testin përkatës pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike në përfundim të periudhës së provës.

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2025 ka konfirmuar në detyrë 3 (tre) nëpunës civil, për të cilët kanë ardhur rezultatet e testit të kryer dhe janë realizuar të gjithë procedurat përkatëse, bazuar në vlerësimin në punë për periudhën 1 (një) vjeçare të provës.

Pajisja me Certifikatën e Sigurisë së Personelit, për punonjësit e Prokurorisë së Posaçme

Në mbështetje të ligjit nr. 10/2023 *"Për informacionin e klasifikuar"*; Vendimit nr. 731, datë 27.11.2024, të Këshillit të Ministrave, *"Për miratimin e rregullores "Për sigurinë e personelit"* si dhe të Urdhërit nr. 256, datë 25.04.2023 të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme *"Për funksionet që duhet të pajisen me "Certifikatën e Sigurimit të Personelit" për njohje me informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", të Shteteve dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar"*, janë përcaktuar të gjitha funksionet që duhet të pajisen me Certifikatën e Sigurimit të Personelit, si dhe nivelin përkatës. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, referuar akteve ligjore në fuqi, si dhe kërkesave të drejtuara nga Prokuroria e Posaçme, ka proceduar duke pajisur me Certifikatë Sigurie stafin e Prokurorisë së Posaçme.

Gjatë vitit 2025, nga Prokuroria e Posaçme janë kërkuar pajisja me Certifikata të Sigurisë së Personelit (CSP), të tipologjive të ndryshme, që paraqitet si më poshtë:

Certifikatë (CSP)	Niveli i Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP)		
	Tepër sekret	Sekret	Konfidencial
Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të rinovuara	8	4	0
Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) për konfirmim vlefshmërie dhe modelim	4	5	0
Certifikate Sigurie personeli (CSP) pajisur për herë të parë	0	1	0
Certifikate Sigurie personeli (CSP) në proces rinovimi	1	2	0
Certifikate Sigurie personeli (CSP) aplikuar për herë të parë në proces	1	3	1

Të gjithë punonjësit, të cilët kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, në Prokurorinë e Posaçme për arsye të ndryshme, kanë dorëzuar Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP) tek Struktura përgjegjëse e institucionit (Specialisti i Burimeve Njerëzore) dhe u nënshtrohen procedurave të debriefimit, duke nënshkruar në dokumentin përkatës. Ata janë përgjegjës për ruajtjen e informacionit të klasifikuar edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për një periudhë 2-vjeçare.

Gjatë vitit 2025, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nuk është vendosur për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të Certifikatës së Sigurisë së

Personelit (CSP), për asnjë punonjës të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në Prokurorinë e Posaçme

Janë kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësitë në pozicionin e anëtarit të Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin, Kontrollin dhe Zgjidhjen e Gjendjeve të Konfliktit të Interesit në Prokurorinë e Posaçme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 95/2016 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, të ndryshuar; ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”; ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, të ndryshuar si dhe udhëzimeve përkatëse të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Gjatë vitit 2025, për Prokurorinë e Posaçme numri i subjekteve sipas funksioneve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private dhe kanë plotësuar llojin e deklaratës, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i deklarimit	Numëri i zyrtarëve aktual që mbartin detyrim për deklarim
1	Subjekt Deklarues për deklaratën si kandidatë	33
2	Subjekt Deklarues për deklaratën para fillimit të detyrës	22
3	Subjekt Deklarues për deklaratën periodike vjetore	93
4	Subjekt Deklarues për deklaratën pas largimit nga funksioni	3

Gjithashtu, Autoriteti Përgjegjës, gjatë vitit 2025 ka realizuar dhe detyra të përcaktuara nga legjisllacioni i sipërcituar, si më poshtë:

- ✓ Hartimi i raportit Vjetor të vitit 2024 të Autoritetit Përgjegjës dhe dërgimi brenda afateve ligjore në ILDKPKI.
- ✓ Njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, për deklaratën si “*Kandidatë*”, “*Para fillimit në detyrë*” dhe “*Pas largimit nga funksioni*” të subjekteve deklaruese të Institucionit.
- ✓ Rakordimi i listës së subjekteve midis Institucionit të Prokurorisë së Posaçme dhe ILDKPKI-së.
- ✓ Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të Udhëzimit për Autoritetin Përgjegjës, me qëllim vënien në dispozicion të Institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI.
- ✓ Ndjekja e dorëzimit brenda afateve ligjore të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të të gjithë subjekteve deklaruese të Prokurorisë së Posaçme.
- ✓ Trajnimi i bërë nga ILDKPKI, përsa i përket deklarimit online të interesave private nga ana e subjekteve deklaruese të Autoritetit. Hapja e llogarive të gjithsecilit nga subjektet deklaruese dhe lajmërimi i tyre me anë të e-mail dhe të shkresave të protokolluara.
- ✓ Asistencë për subjektet deklaruese të Prokurorisë së Posaçme, të cilët kanë ndjerë nevojën për ndihmë. Komunikim i vazhdueshëm me nëpunëset e ILDKPKI.

Në vitin 2025 për të gjitha lëvizjet e personelit subjekt deklarimi, janë njoftuar për deklaratat e tyre “*Para fillimit të detyrës*” dhe “*Pas largimit nga funksioni*”, etj., për të cilët është bërë dhe njoftimi i institucionit të ILDKPKI-së për ndryshimet në regjistër, si dhe është njoftuar edhe Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, për të gjithë punonjësit e larguar nga detyra.

Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme ka krijuar llogaritë për plotësimin e deklaratave për kandidatë për të gjithë kandidatët e kualifikuar për pozicionin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (7 kandidatë) dhe për pozicionin për Hetues Financiar (10 kandidatë).

Bashkëpunimi me Drejtoritë/Sektorët e tjerë

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Dokumentacionit dhe Shërbimeve gjatë vitit 2025, ka bashkëpunuar me Drejtoritë/Sektorët e tjerë për problematika të ndryshme, ku mund të përmenden, bashkëpunimi me Sektorin e Buxhetit dhe Prokurimeve në planifikimin e nevojave, si dhe pjesëmarrjen në procese të veçanta të prokurimit të mallrave, punëve apo shërbimeve. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në hartimin e dokumentacionit përkatës në lidhje me përditësimin e strukturës së Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me ligjin nr. 115/2024 “*Për Buxhetin e vitit 2025*” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 09.01.2025 “*Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes së qendrore*”.

Është bashkëpunuar me Drejtoritë/Sektorët në lidhje me përkrahjet e punës për pozicionet specifike të shpallura për rekrutim, si dhe unifikimin e përkrahjeve të punës dhe përcaktimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me shpalljen për konkurrim të hapur për çdo procedurë rekrutimi, sikurse edhe publikimeve në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme, të të gjithë njoftimeve përkatëse.

Gjithashtu, ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Kancelarin dhe Kabinetin e Drejtuesit, lidhur me proceset gjyqësore civile dhe administrative, në të cilët Prokuroria e Posaçme ka qenë palë, statistikave dhe raportimet mbi burimet njerëzore, si dhe kontributin në hartimin dhe draftimin e disa akteve nënligjore.

Në Prokurorinë e Posaçme gjatë vitit 2025, janë hartuar dhe draftuar aktet ligjore si më poshtë:

- ✓ Hartimi i Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”;
- ✓ Hartimi i Strategjisë së Komunikimit 2025 - 2028, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- ✓ Hartimi i Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, 2025-2027 të
- ✓ Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- ✓ Hartimi i draft Udhëzimit të Përgjithshëm për qarkullimin e brendshëm të dosjeve;
- ✓ Përmirësimi i procedurave të rekrutimit, duke zbatuar ligjin nr. 95/2016, ligjin nr. 97/2016 si dhe legjislacionin e nëpunësit civil;
- ✓ Hartimi i draft Protokollit për Komunikimin gjatë Krizave në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Veprimtaria në proceset gjyqësore administrative/civile, ku Prokuroria e Posaçme ka qënë palë në proces

Drejtoria e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2025 ka ndjekur proceset gjyqësore civile dhe administrative, në të cilat Prokuroria e Posaçme ka qënë palë, në këto procese:

Nr.	Shkallët e gjykimit	Numri i çështjeve
1.	Çështje Administrative në Shkallën e parë të Gjykimit	21
2.	Çështje civile në Shkallën e parë të Gjykimit	3
3.	Çështje Administrative në Shkallën e dytë të Gjykimit	11

Prokuroria e Posaçme gjatë këtij viti ka ndjekur 35 çështje gjyqësore, kërkesë padi të reja apo edhe të mbartura në Gjykatën Administrative dhe Civile të Shkallës së Parë, si dhe në Gjykatën Administrative të Apelit. Për vitin 2025 janë 15 çështje të reja në gjykim.

SEKTORIT TË RAPORTIMEVE PRANË BE, GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, Sektori i Raportimeve ka ushtruar një veprimtari intensive dhe komplekse, duke luajtur një rol thelbësor në përmbushjen e detyrimeve institucionale të raportimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Veprimtaria e sektorit është karakterizuar nga një volum i lartë raportimesh, afate të ngushta kohore, koordinim të vazhdueshëm ndërinstitucional dhe përfshirje aktive në procese strategjike me rëndësi të veçantë për procesin e integrimit evropian dhe vlerësimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Raportimet në kuadër të Kapitujve 23 dhe 24 të procesit të integrimit evropian

Një komponent qendror i veprimtarisë së Sektorit të Raportimeve gjatë vitit 2025 ka qënë përgatitja, koordinimi dhe konsolidimi i raportimeve në kuadër të Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore dhe Kapitullit 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria. Në këtë kuadër, sektori ka bashkëpunuar ngushtësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, duke kontribuar në hartimin e materialeve analitike, përditësimin e të dhënave dhe reflektimin e progresit institucional. Raportimet janë realizuar në përputhje me kërkesat dhe metodologjinë e Komisionit Evropian, duke garantuar koherencë ndërmjet informacionit të përcjellë nga institucionet përgjegjëse dhe qëndrimeve zyrtare të shtetit shqiptar. Sektori ka luajtur një rol aktiv në harmonizimin e kontributeve, verifikimin e saktësisë së të dhënave dhe adresimin e komenteve apo kërkesave sqaruese të ardhura nga shërbimet e BE-së.

Raportimet në kuadër të Interim Benchmarks

Gjatë vitit 2025, Sektori i Raportimeve ka qënë i angazhuar në mënyrë intensive në raportimet lidhur me Interim Benchmarks, të cilat përbëjnë elementë kyç të kuadrit negociues për anëtarësim. Në këtë drejtim, sektori ka realizuar raporte të shpeshta, në disa raste deri në dy herë në muaj. Përveç raportimeve të shkruara, përfaqësues të sektorit kanë marrë pjesë edhe në raporte dhe prezantime online përpara shërbimeve të Komisionit Evropian, duke kontribuar në paraqitjen e progresit të arritur, sqarimin e çështjeve të ngritura dhe adresimin e rekomandimeve përkatëse. Ky proces ka kërkuar përgatitje të detajuar, koordinim të brendshëm dhe reagim të shpejtë ndaj kërkesave të Komisionit Evropian. Gjithashtu, sektori ka marrë pjesë rregullisht në takimet

koordinuese të organizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme, lidhur me ecurinë e kapitujve 23 dhe 24.

Raportimet në kuadër të Raportit të Progresit dhe Raportit të Sundimit të Ligjit

Në kuadër të veprimtarisë raportuese për vitin 2025, Sektori i Raportimeve ka qenë i angazhuar në përgatitjen dhe konsolidimin e kontributeve për Raportin e Progresit dhe Raportin e Sundimit të Ligjit, të cilat përbëjnë instrumente kyçe të vlerësimit të ecurisë së reformave dhe të performancës institucionale të Shqipërisë nga ana e Bashkimit Evropian. Këto raporte janë realizuar me prioritet të veçantë, me qëllim garantimin e një pasqyrimi të saktë, të plotë dhe të besueshëm të progresit të arritur, si dhe të nivelit të zbatimit të reformave dhe objektivave të parashikuara.

Raportimet në kuadër të strategjive kombëtare

Gjatë vitit 2025, Sektori i Raportimeve ka realizuar raporte të rregullta, të strukturuar dhe të harmonizuara në kuadër të strategjive kombëtare dhe dokumenteve kryesore planifikuese, konkretisht:

- Plani Semestral i Integritetit Evropian (PSIE);
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (SKPPPFT), e cila ndiqet dhe monitorohet nga AIF;
- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë (SND);
- Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK);
- Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025-2030;
- Strategjia Ndërsektorale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.

Në këtë kuadër, sektori ka përgatitur dhe përcjellë raporte periodike, statistika të detajuara dhe përgjigje zyrtare, në funksion të monitorimit të zbatimit të objektivave, masave dhe indikatorëve të përcaktuar në secilin dokument strategjik. Procesi i raportimit ka kërkuar koordinim të vazhdueshëm ndërinstitucional, mbledhje dhe verifikim të të dhënave, harmonizim të informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe respektim të plotë të formateve dhe afateve të përcaktuara, duke garantuar cilësi, saktësi dhe besueshmëri të informacionit të raportuar.

Raportimet në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe zbatimit të konventave

Sektori i Raportimeve ka kontribuar në përgatitjen e raporteve për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në kuadër të zbatimit të konventave ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, me fokus në evidentimin e masave të ndërmarra, progresit të arritur dhe sfidave të identifikuara në zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare.

Procesi Moneyval – Raundi VI i vlerësimit

Një nga proceset më komplekse dhe më kërkuese gjatë vitit 2025 ka qenë angazhimi në kuadër të Moneyval – Raundi i VI i vlerësimit të Shqipërisë. Sektori ka qenë i përfshirë në mënyrë intensive në plotësimin e pyetësorit teknik dhe pyetësorit të efektivitetit. Në kuadër të këtij procesi, si dhe të zbatimit të SKPPPFT-së, sektori ka marrë pjesë aktive në 10 takime të Grupit Ndërinstitucional të Nivelit Teknik (GNTP), duke kontribuar në diskutimet teknike, koordinimin ndërinstitucional dhe harmonizimin e qëndrimeve lidhur me përmbushjen e standardeve të FATF dhe Moneyval.

Në përfundim, veprimtaria e Sektorit të Raportimeve gjatë vitit 2025 ka qenë intensive, shumëdimensionale dhe me përgjegjësi të lartë institucionale. Përmes një pune të strukturuar, koordinimi të ngushtë ndërinstitucional dhe përkushtimi profesional, sektori ka kontribuar ndjeshëm në përmbushjen e detyrimeve të raportimit, forcimin e besueshmërisë institucionale dhe avancimin e procesit të integritetit evropian dhe vlerësimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.

BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Viti 2025 shënoi një vit zhvillimi thelbësor për Byronë Kombëtare të Hetimit duke mbajtur në konsideratë jo vetëm aktivitetin administrativ të institucionit, i cili mori përmasa të reja, por edhe zgjedhja e Drejtuesit të ri ka çelur një kapitull të ri institucional, në aspektin vizionar të drejtimit dhe atë të bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme.

Miratimi i akteve të përbashkëta nënligjore të Drejtorit të Byrosë dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme janë udhëhequr nga një proces me bazë të gjerë konsultimi dhe analize nevojash institucionale për të kryer hetime komplekse kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe jo nëpërmjet një shkëmbimi formal opinionesh ligjore dhe shkresash zyrtare. Qëllimi parësor në miratimin e strukturës së re duke shpërndarë në sektorët respektiv 40 pozicione të reja hetuesish, në terma afatshkurtër konsiston në rritjen e kapaciteteve aktuale hetimore dhe në terma afatmesëm me perspektivën e ngritjes së njësive të dedikuara të analizës dhe asaj operacionale.

Riorganizimi dhe ridimensionimi i organizimit të brendshëm nëpërmjet një vizioni të përbashkët të lidershit të Byrosë dhe Prokurorisë së Posaçme ka qenë një tjetër tregues dhe element solid, jo vetëm në funksion të ngritjes së një marrëdhënie të re bashkëpunimi midis dy institucioneve por edhe në qasjen bashkëdakordësuese mbi rregullat e organizimit dhe funksionimit të strukturës, me role dhe detyra të qarta sa u përket kompetencave hetimore, prokuroriale dhe administrative në përputhje me hierarkinë institucionale. Duke mbajtur parasysh kapacitetet aktuale hetimore të Byrosë, vlerësohet nevoja për ngritjen dhe zhvillimin e disa funksioneve të brendshme themelore, të tilla si analiza kriminale, forca operacionale dhe përdorimi i metodave speciale të hetimit, me qëllim garantimin e pavarësisë për funksione operative dhe teknike nga institucione si Policia e Shtetit.

Njësia e analizës kriminale do të sigurojë një informacion të bollshëm mbi tendencat e krimit, do të zhvillojë vlerësime të kërcënimeve dhe rrezikut potencial për veprat penale në juridiksion të SPAK si edhe do të ndihmojë në nxitjen e marrëdhënieve më të thelluara dhe ndërveprimin me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Ndërkohë, ngritja e forcës operacionale nëpërmjet kapaciteteve të specializuara si vëzhgimi, depërtimi, fshehja, përgjimi etj., është vendimtare për zhvillimin e hetimeve të SPAK, duke patur parasysh kapacitetet dhe burimet e kufizuara të BKH-së në këtë drejtim. Ngritja e një njësie të tillë brenda strukturës do të kufizojë maksimalisht edhe mundësinë e rrjedhjes së informacioneve në ekzekutimin e kryerjes së veprimeve hetimore si edhe do të zhvillojë në një dimension tjetër zhvillimin e kapaciteteve hetimor, nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit dhe krijimin e njohurive të avancuara teknologjike për përdorimin e pajisjeve të sofistikuara në funksion të kërkimit të provës.

Gjithashtu, miratimi i akteve të përbashkëta për rekrutimin e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe fillimi i procedurave për rekrutimin e tyre shënon përmbushjen e një kërkesë të kahershme

ligjore për SPAK, i evidentuar si detyrim i paplotësuar për disa vite më radhë, nga Progres - Raportet e Komisionit Evropian dhe Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e strukturës. Pas kryerjes së një analize brenda strukturës mbi bazën e lëndës kryesore dhe volumit të hetimeve, e asistuar edhe nga partnerët e huaj, dy drejtuesit përcaktuan institucionet/njësitë hetimore nga të cilat do të rekrutohen 10 oficerët e parë të shërbimeve të Policisë Gjyqësore në BKH. Ky proces aktualisht është në fazën përfundimtare të tij, ku 15 kandidatë nga 67 në total që aplikuan, do të nënshtrohen verifikimit të figurës dhe pasurisë sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016, *i ndryshuar*.

Aktet e përbashkëta nënligjore pas shumë diskutimeve ndër vite, kanë përcaktuar përfundimisht rolin dhe qëllimin e funksionit të oficerit të shërbimeve gjyqësore pranë BKH-së, duke sanksionuar si rol parësor të tyre, atë të ndërlidhjes/koordinimit midis BKH-së dhe institucioneve prej të cilave ata janë rekrutuar me qëllim të zhvillimit të hetimeve nga SPAK. Jo rastësisht, ligji 95/2016 kërkon që shërbimet e policisë gjyqësore që do të bashkohen BKH-së, të gëzojnë aftësi dhe kapacitete të posaçme profesionale në fushat e ekspertizës që mbulojnë institucionet e origjinës.

Rritja dhe konsolidimi i bashkëpunimit midis institucioneve nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe komunikimit me objekt thellimin e hetimeve si edhe kryerja e çdo veprimi procedural, që vlerësohet për nevojat të hetimit me urdhër të prokurorit të çështjes, do të ketë një impakt të ndjeshëm jo vetëm në interesin e përgjithshëm të hetimeve por së bashku edhe me rritjen e numrit të aksesit në databaza (total 22 deri në 2025), do të jenë faktorë shtytës për rritjen e numrit të referimeve nga institucionet e origjinës.

Referime në Prokurorinë e Posaçme, mbi bazën e indicieve, - 6 (gjashtë).

URDHRA TË PËRBASHKËTA

Urdhra të Përbashkët midis Drejtorit të BKH-së dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme – 5 (pesë)

1. Urdhër i Përbashkët "Për miratimin e strukturës së BKH-së";
2. Urdhër i Përbashkët "Për caktimin e procedurave dhe funksionimin e Komisionit të përzgjedhjes së Oficerëve të Policisë Gjyqësore";
3. Urdhër i Përbashkët "Për caktimin e hetuesve në Sektorin Kundër Korrupsionit, Sektorin Kundër Krimit të Organizuar dhe Zyrën e Përgjimeve në Prokurorinë e Posaçme";
4. Urdhër i Përbashkët "Për miratimin përshkrimit të punës së oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore";
5. Urdhër i Përbashkët "Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit, përcaktimin e rregullave dhe procedurave të përzgjedhjes së Oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore".

Marrëveshje të nënshkruara

1. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SH.A. "Për dhënien e të drejtës së aksesit në sistemin Billing/CRM të OSHEE Group".

2. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Ujësjetës Kanalizime SH.A. *“Për dhënien e të drejtës së aksesit në sistemin elektronik AL-Billing”*.

Trajnime, konferenca, Workshop, takime etj.

Të zhvilluara brenda vendit janë 33

Hetuesit – 19

Administrata -14

Të zhvilluara jashtë vendit janë 41:

Hetuesit – 41

Nga të cilat 17 janë trajnime dhe 24 takime

Burimet Njerëzore

Gjatë vitit 2025 BKH në zbatim të nenit 7 të Ligjit Nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, janë shpallur procedurat për 4 (katër) funksione administrative, nga të cilat :

1. Specialist i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse – pozicioni është plotësuar dhe punonjësi është i emëruar përkohësisht pasi është ende në proces verifikimi të kushtit të sigurisë, nga Komisioni i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.
 2. Përgjegjës i Sektorit të Sekretari Protokollit, ngritje në detyrë - pozicioni është plotësuar, punonjësi i ka kaluar kushtet e sigurisë.
 3. Specialist i Armatimit, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse – pozicioni është plotësuar dhe punonjësi është i emëruar përkohësisht pasi është ende në proces verifikimi të kushtit të sigurisë, nga Komisioni i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.
 4. Specialist i Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse- janë kryer procedurat e shërbimit civil, por kandidatët që kanë aplikuar nuk plotësonin kriteret e kërkuara, procedurat janë anuluar.
- ❖ Gjithashtu, specialisti i Sektorit të Sekretari -Protokoll ka kryer procedurat e shërbimit civil, por është ende në proces verifikimi të kushtit të sigurisë, nga Komisioni i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.

Vende vakante: 4

1. Specialist Sekretari -Protokoll;
2. Specialist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
3. Këshilltar i Drejtorit;
4. Asistent i Drejtorit.

Aktiviteti administrativ

Korrespondenca për shkresat hyrëse – dalës, në Byronë Kombëtare të Hetimit,

✚ *Sekretari – Protokoll, gjatë kësaj periudhe janë trajtuar 4.686 shkresa, të ndara si vijon:*

Shkresa hyrëse – 4,092

Shkresa dalëse - 594

✚ *Gjatë kësaj periudhe ka regjistruar/administruar dhe shpërndarë 143 shkresa, të ndara si vijon:*

Agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet shtetërore ;

Shkresa hyrëse – 43

Shkresa dalëse - 37

Partnerët Ndërkombëtar;

Shkresa hyrëse – 43

Shkresa dalëse - 20

Niveli i Zbatimit të Rekomandimeve të Komisionit Evropian për Byronë Kombëtare të Hetimit

Byroja Kombëtare e Hetimit është institucion kontribuues në Kapitullin 23 dhe Kapitullin 24. Në VKM nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës” janë parashikuar masa konkrete për përmbushjen e detyrimeve nga Byroja Kombëtare e Hetimit, në vazhdimësi.

Specifikisht masat për realizim nga Byroja Kombëtare e Hetimit dhe statusi i realizimit respektiv për secilën prej tyre:

- Rritja e numrit të referimeve – Në vazhdimësi
- Finalizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit BKH-Policia e Shtetit sipas nenit 29 të ligjit 95/2016 – Në proces negociimi
- Përfundimi i procesit të rekrutimit të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe zgjedhjes së Zëvendës drejtorit – Në proces
Për 10 pozicione të oficerëve të shërbimeve gjyqësore është hapur gara në tetor të vitit 2025 dhe kanë aplikuar 67 kandidatë, të cilët janë në proces vlerësimi nga Komisioni i Përzgjedhjes. Brenda muajit shkurt 2026 do të përcillen kandidatët e kualifikuar për të vijuar me procesin e veting-ut sipas sanksionimeve të nenit 6 të ligjit SPAK.
Sot është mbyllur afati i aplikimit të kandidateve për pozicionin e Zëvendës drejtorit dhe kanë shprehur interes 11 hetues të BKH-së.
- Ngritja pranë BKH-së, të një njësie të re përgjimi parandalues, të njësisë së vlerësimit të riskut dhe njësisë së bashkëpunimit ndërkombëtar deri në vitin 2025” – (i) Realizuar ngritja e Seksionit të Përgjimit Parandalues; (ii) Në proces vlerësimi me Prokurorinë e Posaçme ngritja e dy njësive të tjera.
- Rritja e numrit të aksesit në databazat e institucioneve shtetërore – Në proces Përgjatë vitit 2025 hetuesit e BKH-së kanë rritur në 22 numrin e aksesit në sisteme (databaza) të agjencive brenda vendit në 3 sisteme të agjencive të huaja (total 25).

Drejtori i BKH-së është në proces negocimi për sigurimin e aksesimit me 14 institucione të tjera të shtetit shqiptar dhe 1 agjenci të huaj (EMPACT).

- Pjesëmarrja e BKH-së në platformën EMPACT – Në proces koordinimi me projektin EU4LEA të Delegacionit Evropian, për vendosjen e kontakteve me zyrën qendrore të EMPACT.
- Trajnimet vazhduese për hetuesit – Në vazhdimësi

Nga ana jonë, për vitin 2025, janë përmbushur detyrimet e përcaktuara për raportimet, pjesëmarrjen në takime, parashikimin e masave konkrete në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të progres raporteve.

Jemi në proces për të përmbushur masat e vendosura nga shteti shqiptar në udhërrëfyes për vitin 2026.

TREGUESIT E BUXHETIT PËR VITIN 2025 DHE PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN E ARDHSHËM DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Buxheti i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), është miratuar me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”. Zbatimi i buxhetit gjatë vitit 2025 për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mbështetet në kuadrin ligjor për buxhetin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin duke patur në fokus, parimet e përdorimit me efikasësi, efektivitet, kursim dhe transparencë.

Me qëllim përmbushjen e objektivave prioritare të institucionit, menaxhimi financiar është fokusuar në financimin e shpenzimeve në përputhje dhe me objektivat strategjik të SPAK dhe kryesisht për:

- ✓ Krijimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme në funksion të arritjes së rezultateve pozitive në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- ✓ Përdorimin e teknologjisë më të avancuar në funksion të ekspertizës dhe hetimeve proaktive sipas kompetencës ligjore të Strukturës së Posaçme.
- ✓ Përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore si dhe të krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.

1.1 Analiza vjetore e treguesve buxhetor viti 2025

Në zbatim të ligjit nr. nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” i ndryshuar, buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 2,370 milion lekë dhe me buxhetin vjetor të rishikuar në vlerën 1,480 milion lekë nga të cilat:

- Buxheti për Prokurorinë e Posaçme në shumën 1,047 milionë lekë
- Buxheti për Byroën Kombëtare të Hetimit në shumën 433 milionë lekë

Tabela nr. 1: Plani buxhetor për vitin 2025

(000/lekë)

Titulli	Emërtimi	Plani Fillestar Vjetor	Plani Vjetor i Rishikuar	Shpenzime Faktike	Diferenca	% e realizimit fakt/plan
1	2	3	4	5	6=(4-5)	7=(5/4)
03390	Veprimtaria e SPAK	2,369,963	1,480,420	1,351,505	128,915	91%
Totali i Shpenzimeve të Institucionit		2,369,963	1,480,420	1,351,505	128,915	91%

Niveli i realizimit të fondeve buxhetore të SPAK-ut në krahasim me planin e miratuar paraqitet në masën 91 %.

Duke u mbështetur në veprimtarinë bazë të institucionit, pjesë përbërës e të cilit janë:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me kod institucioni në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë 1041001,
2. Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) me kod institucioni në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë 1041002,

Në analizën vjetore të vitit 2025, informacioni paraqitet në mënyrë tabelare dhe grafikisht, si mëposhtë:

- a) Sipas planit fillestar të miratuar shuma totale 2,370 milionë lekë përfaqëson 1,670 milionë lekë shpenzimet korrente dhe 700 milion lekë shpenzimet kapitale. Gjatë 12-mujorit të vitit 2025, ky plan ka pësuar ndryshime.
- a) Sipas planit të rishikuar shuma totale 1,480 milionë lekë përfaqëson 1,122 milionë lekë shpenzimet korrente, dhe 358 milion lekë shpenzimet kapitale.
- b) Sipas realizimit faktik, totali i shpenzimeve të realizuara është në shumën 1,352 milion lekë ose 91% e planit të rishikuar, të rakorduara edhe me të dhënat e sistemit SIFQ, të cilat shpenzimet korrente janë realizuar në vlerë 1,059 milionë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale në vlerë 293 milionë lekë.

Tabela nr.2: Raporti i shpenzimeve të programit sipas llogarive ekonomike


(000/lekë)

Art.	Emërtimi	Fakti i vitit paraardhës 2024	1	2	3	4=(2-3)	Përqindja e realizimit Fakt/Plan (%)
			Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca Plan - Fakt	
			Plan Fillestar Viti 2025	Plan i Rishikuar Viti 2025	periudhës 12 - mujore		
600	Paga	749,365	1,285,496	817,896	808,037	9,859	99%
601	Sigurime Shoqërore	63,448	136,000	74,763	68,720	6,043	92%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	160,908	248,117	225,287	178,280	47,007	79%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	1,830	1,830	0	100%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	984	0	2,110	1,919	191	91%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	974,705	1,669,613	1,121,886	1,058,786	63,100	94%
231	Kapitale të Trupëzuara	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815	82%
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale	249,395	700,000	358,534	292,719	65,815	82%
Totali (korrente + kapitale)		1,224,100	2,369,613	1,480,420	1,351,505	128,915	91%

Për sa i përket realizimit faktik krahasuar me buxhetin vjetor përfundimtar rezulton se përqindja e realizimit sipas zërave buxhetorë paraqitet në;

- masën rreth 96%, për shpenzime paga/sigurime,
- shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera rreth 79%,
- transfertat buxhetore rreth 95%
- shpenzimet për investime 82%.

Grafiku nr.1: Struktura e realizimit Fakt - Plan për vitin 2025



Struktura e shpenzimeve 2025

Analiza e strukturës së shpenzimeve sipas peshës specifike ofron një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si janë ndarë dhe menaxhuar fondet në kuadër të buxhetit. Kjo analizë ndihmon në identifikimin e devijimeve midis buxhetit fillestar të parashikuar, buxheti i rishikuar dhe realizimin faktik.

Tabela 3: Raporti struktura e shpenzimeve në përqindje

Në 000/lekë


Art.	Emertimi	Plani Fillestar Vjetor 2025	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar 2025	Struktura e shpenzimeve	Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	1,285,496	54%	817,896	55%	808,037	60%
601	Sigurime Shoqërore	136,000	6%	74,763	5%	68,720	5%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	248,117	10%	225,287	15%	178,280	13%
606	Transferta Korente të Huaja	0	0%	1,830	0%	1,830	0%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0%	2,110	0%	1,919	0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	1,669,613	70%	1,121,886	76%	1,058,786	78%
231	Kapitale të Trupëzuara	700,000	30%	358,534	24%	292,719	22%
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	700,000	30%	358,534	24%	292,719	22%
Totali (korrente + kapitale)		2,369,613	100%	1,480,420	100%	1,351,505	100%

Në buxhetin e planifikuar shpenzimet janë kategorizuar në zërat kryesor dhe secili zë ka një peshë specifike në totalin e buxhetit. Vihet re se pesha specifike sipas llogarive ekonomike për vitin 2025, siç mund të konstatohet në përqindje dhe në grafikun më poshtë, pjesën më të madhe të fondeve të planifikuara mbi totalin e buxhetit të rishikuar e zë, zëri i shpenzimeve për pagat me 60% në krahasim me zërat e tjerë.

Në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare, rezulton se:

- Sipas planit fillestar të miratuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 70% në vlerë rreth 1,670 milionë lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 30% , në vlerë rreth 700 milionë lekë.
- Sipas planit të rishikuar, shpenzimet korrente zënë një peshë specifike 76% në vlerë rreth 1,122 milionë lekë, ndërsa shpenzimet për investime zënë një peshë specifike 24%, në vlerë rreth 358 milionë lekë.
- Sipas realizimit faktik, në totalin e shpenzimeve të realizuara shpenzimet korrente zënë 78% në vlerë 1,059 milionë lekë, ndërsa shpenzimet kapitale 22% në vlerë 293 milionë lekë.

Grafiku nr.2: Struktura e Shpenzimeve sipas peshës specifike të programit viti 2025



1.2 Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, bazuar në orjentimet e Ministrisë së financave, në kuadër të PBA, ka parashikuar tregues performance me bazë gjinore në nivel produkti.

Treguesi i parashikuar është: **% e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese.**

Tabela nr.4: Raporti i posteve gra në nivel drejtuesi

SPAK	Fakt Nr. i Funksioneve në nivel drejtues	Fakt Nr. i Funksioneve në nivel drejtues Gra	% e posteve drejtues Gra/Totalin
Prokuroria e Posaçme	18	8	44%
Byroja Kombëtare e Hetimit	9	5	56%
Totali	27	13	48%

Ky tregues jo vetëm që pasqyron angazhimin e institucionit për rritjen e përfaqësimit të grave në nivelet vendimmarrëse, por gjithashtu ndikon në zhvillimin e efekteve pozitive për të integruar barazinë gjinore në të gjitha aspektet e veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, në kuadër të PBA-së dhe buxhetimit gjinor, treguesi kontribuon në identifikimin dhe monitorimin e rezultateve të politikave dhe ndërhyrjeve buxhetore që synojnë reduktimin e pabarazive gjinore dhe rritjen e aksesit të grave në pozicione vendimmarrëse.

Fakti që **48% e posteve drejtuese (në nivele të larta, mesme dhe të ulëta drejtuese)** mbahen nga gra tregon një nivel domethënës përfaqësimi dhe dëshmon për angazhimin institucional drejt zbatimit të parimit të barazisë gjinore.

Grafiku nr.3: Numri i posteve drejtuese gra ndaj totali të posteve drejtuese



Në këtë kuptim, treguesi gjinor nuk është vetëm një matës statistikor, por një element thelbësor i llogaridhënies institucionale dhe i integritetit të perspektivës gjinore në planifikimin strategjik dhe buxhetor të institucionit.

1.3 Performanca e buxhetit në nivel programi

Në zbatim të ligjit vjetor “*Për zbatimin e buxhetit viti 2025*”, drejtorja e buxhetit ka analizuar dhe detajuar fondet në përputhje me shpërndarjen e fondeve buxhetore të miratuara, përgjatë vitit 2025, ka marrë masat korrigjuese nëpërmjet rialokimeve të fondeve (shtesa /pakësime). Bazuar në Aktet normative për ndryshimin e ligjit buxhetor, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, janë kryer detajimet përkatëse sipas rishikimit të buxhetit.

1.3.1 Shpenzimet e personelit

Plani i fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), nëpërmjet Ligjit vjetor të buxhetit për vitin 2025, për zërin “**Paga dhe sigurime**”, (llogaria ekonomike 600-601) ka qenë fillimisht në shumën 1,421 milion lekë. Pas rishikimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, plani përfundimtar është përcaktuar në vlerën 893 milion lekë:

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: 464 milionë lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH): 429 milionë lekë.

Sipas të dhënave të realizimit, Prokuroria e Posaçme dhe BKH kanë realizuar gjithsej shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore në shumën 877 milionë lekë. Konkretisht:

- Prokuroria e Posaçme ka realizuar shpenzime në shumën 410 milionë lekë për paga dhe 38 milionë lekë për sigurime, ose rreth 97% e fondit të planifikuar për vitin 2025;
- Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar shpenzime në shumën 398 milionë lekë për paga dhe 30 milionë lekë për sigurime shoqërore, ose 99.98% e fondit të planifikuar për vitin 2025.

Niveli i realizimit të shpenzimeve për këtë zë tregon se fondi i pagave është administruar në mënyrë të efektshme, në përputhje me numrin real të punonjësve.

Bazuar në **ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2025**, konkretisht:

- Aktin Normativ nr. 6, datë 11.06.2025,
 - Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025,
 - Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025,
- “Mbi ndryshimin e Ligjit nr. 115/2024 Për buxhetin e vitit 2025”,

dhe në mbështetje të deklarimeve të fondeve buxhetore të papërdorura, është miratuar një pakësim i fondeve në shumën totale prej 529 milionë lekë për zërin “*Paga dhe sigurime shoqërore*” nga të cilat: (Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: 105 milionë lekë/Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) 424 milionë lekë).

Deklarimi i këtyre tepricave buxhetore ka qenë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e ekzistencës së vakancave në strukturën organike, të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të fondit të planifikuar për paga dhe kontribute shoqërore gjatë vitit buxhetor 2025.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, **struktura e miratuar** e punonjësve për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përbëhet nga gjithsej 322 punonjës, konkretisht 144 punonjës në Prokurorinë e Posaçme dhe 178 punonjës në Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Gjatë vitit 2025, **numri efektiv** i punonjësve rezulton të jetë 206 punonjës, nga të cilët 124 punonjës në Prokurorinë e Posaçme dhe 82 punonjës në Byroja Kombëtare e Hetimit. Krahas punonjësve organikë, në strukturë janë angazhuar edhe 4 punonjës me kontratë të përkohshme, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim mbulimin e nevojave të përkohshme dhe specifike të institucionit.

1.3.2 Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera

Aktiviteti operacional dhe hetimor i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) gjatë vitit buxhetor 2025 është mbështetur nga buxheti i shtetit, në kuadër të zërit “**Mallra dhe shërbime**” (llogaria ekonomike 602).

Plani fillestar i miratuar për këtë zë ka qenë në shumën 248 milionë lekë, ndërsa pas rishikimeve buxhetore të kryera gjatë vitit, plani përfundimtar është miratuar në shumën 225 milionë lekë. Ky plan është detajuar si më poshtë:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar: 223 milionë lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH): 2 milionë lekë.

Gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike paraqiten në shumën totale 178 milionë lekë, ose 79% e planit vjetor përfundimtar. Nga kjo shumë:

- Prokuroria e Posaçme ka realizuar shpenzime në vlerën 176.5 milionë lekë;
- Byroja Kombëtare e Hetimit ka realizuar shpenzime në vlerën 1.6 milionë lekë.

Niveli i realizimit të shpenzimeve tregon një menaxhim të kujdesshëm dhe racional të fondeve buxhetore. Këto shpenzime kanë mbuluar nevoja të domosdoshme utilitare, procedurale dhe operationale, të cilat sigurojnë funksionimin normal dhe të pandërprerë të institucionit, në përputhje të plotë me parashikimet e miratuara në Regjistrin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në totalin e likuidimeve të realizuara janë përfshirë, ndër të tjera, shpenzime për:

- mirëmbajtjen e sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- rinovimin dhe përditësimin e programeve ekzaminuese dhe analitike;
- pagesa për shërbime kadastrale dhe shërbime të tjera teknike mbështetëse;
- honorare për ekspertë të fushave të ndryshme, avokatë dhe përkthyes, të angazhuar në kuadër të procedimeve hetimore;
- furnizimin me materiale kancelarie për nevojat e përditshme të zyrave të institucionit;
- shpenzime për karburant, shërbime utilitare, si dhe për udhëtime dhe dieta brenda dhe jashtë vendit;
- shpenzime të tjera të nevojshme për garantimin e funksionimit administrativ dhe operacional të institucionit.

Këto zëra zënë peshën më të madhe në strukturën e këtyre shpenzimeve duke garantuar sigurinë, vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, vjen si pasojë e rritjes së ndjeshme të volumit të procedurave hetimore, shtimit të hetimeve komplekse dhe përdorimit më të gjerë të mjeteve teknologjike dhe ekspertizave të specializuara. Një faktor shtesë që ka ndikuar në këtë rritje është edhe shtimi i numrit të stafit, i cili ka sjellë rritje të drejtpërdrejtë të nevojave për mbështetje logjistike, shërbime utilitare dhe furnizime administrative.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë veprime për rialokimin e burimeve buxhetore, ku është realizuar një pakësim në shumën totale prej 1.8 milion lekë nga llogaria 602 dhe shtesë në llogarinë 605.

Në vijim, bazuar në **ndryshimet ligjore të miratuara gjatë vitit 2025**, dhe në mbështetje të deklarimeve të tepricave të fondeve buxhetore, është miratuar një pakësim i fondeve në shumën totale prej 21 milionë lekë, për zërin “*Mallra dhe shërbime*” nga Byroja Kombëtare e Hetimit.

Fondet nga Granti (Eurojust)

Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përfutur financim në formën e grantit, në shumën totale 664 mijë lekë, në kuadër të *Programit të financimit të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore (EPH) të Eurojust/Crimjust*.

Ky financim ka pasur si qëllim mbështetjen e aktiviteteve hetimore ndërkombëtare dhe është përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjes përkatëse, duke mbuluar shpenzime të natyrës mbështetëse si udhëtimet, akomodimin, përkthimin, interpretimin, si dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin e EPH-ve.

Për zërin “Mallra dhe shërbime”, shpenzimet e kryera nga fondi i akorduar në formë granti janë realizuar në vlerën totale të financimit, duke rezultuar në një nivel realizimi 100%. Ky tregues dëshmon një përdorim efektiv dhe të qëllimshëm të fondeve të grantit, në funksion të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rritjes së eficiencës së veprimtarisë hetimore të Prokurorisë së Posaçme.

Tabela nr.5: Shpenzime të kryera nga fondi i Grantit - kap. 6 (Eurojust-Crimjust)

Kap.6	Nënlogaria ekonomike	Emërtimi	Granti i akorduar	Shuma e shpenzuar
6	602	Shpenzime per Prokurorinë e Posacme	664,205	664,205
6	602	Shpenzime për Byronë Kombëtare të Hetimit	-	-
Total			664,205	664,205

1.3.3 Transferta për Korrente të Huaja

Shpenzimet për **Transferta të huaja (llogaria ekonomike 605)** për vitin 2025, bazuar në rialokimin e fondeve buxhetore të miratuara, paraqiten me një shtesë në shumën 1.8 milionë lekë për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Ky rialokim është realizuar në mbështetje të *Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Qendrës së Zbatimit të Ligjit të Europës Juglindore (SELEC)*, me nr. 527/23, datë 16.12.2024, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për pagesën e kontributit vjetor të anëtarësimit në këtë organizatë ndërkombëtare. Kuota e anëtarësimit për BKH përcaktohet në masën 3% të kontributit total, në përputhje me aktet rregulluese të SELEC.

Për vitin 2025, realizimi faktik 12-mujor për këtë zë shpenzimesh është në shumën 1.8 milion lekë, duke shënuar një nivel realizimi 100% në raport me planin buxhetor me ndryshime.

1.3.4 Transferta për buxhete familjare

Për vitin buxhetor 2025, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “*Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë*”, i ndryshuar, është planifikuar **Fondi i Veçantë (Ilogaria ekonomike 606)** për mbulimin e rasteve të fatkeqësive. Fondi fillestar i miratuar për këtë zë ka qenë në shumën 350 mijë lekë. Gjatë procesit të rishikimit buxhetor, në funksion të nevojave reale dhe të evidentuara gjatë zbatimit të buxhetit, fondi përkatës është rishikuar në shumën 2.1 milionë lekë. Nga ky fond janë shpenzuar gjithsej 1.9 milionë lekë, çka përfaqëson rreth 91% të planit vjetor përfundimtar.

Në ndarjen institucionale të shpenzimeve, Prokuroria ka realizuar shpenzime në vlerën 1.2 milionë lekë, ndërsa Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) ka shpenzuar shumën 649 mijë lekë. Këto shpenzime lidhen drejtpërdrejt me përballimin e situatave të paparashikuara, në përputhje me qëllimin e fondit të veçantë.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë veprime konkrete për alokimin e burimeve financiare, si dhe është paraqitur kërkesë për fond shtesë në shumën totale prej 1.7 milionë lekë, e argumentuar nga rritja e nevojave faktike dhe domosdoshmëria për garantimin e funksionimit normal të institucioneve përkatëse.

1.3.5 Shpenzime për Investime Kapitale

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2024 “*Për buxhetin e vitit 2025*”, fondi i miratuar fillimisht për zërin **Investime Kapitale (Ilogaria ekonomike 231)** ka qenë në shumën 700 milionë lekë. Si rezultat i shtesave dhe pakësimeve buxhetore të reflektuara gjatë procesit të miratimit dhe rishikimit të buxhetit, plani i rishikuar për këtë zë është përcaktuar në shumën 358 milionë lekë.

Gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2025, shpenzimet faktike për investimet kapitale kanë arritur vlerën 293 milionë lekë, ose rreth 82% të planit vjetor përfundimtar.

Realizimi i investimeve kapitale gjatë vitit 2025 ka rezultuar në nivele më të ulëta krahasuar me planifikimin fillestar, fakt i cili lidhet ngushtësisht me ecurinë e punimeve për rikonstruksionin e godinës së re të marrë në administrim nga Prokuroria e Posaçme. Ky proces përfshin ndërhyrje të thelluara dhe komplekse, të cilat kërkojnë kohë të konsiderueshme për projektim, zbatim dhe kolaudim.

Rikonstruksioni i godinës nuk kufizohet vetëm në ndërhyrje fizike mbi strukturën ekzistuese, por shoqërohet edhe me investime të ndërlidhura, si instalime teknike, sisteme infrastrukturore

moderne, pajisje sigurie dhe elementë funksionalë, të domosdoshëm për garantimin e standardeve të sigurisë, cilësisë dhe jetëgjatësisë së projektit. Këta faktorë kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e realizimit të shpenzimeve kapitale gjatë vitit raportues.

Tabela nr.6: Projektet e shpenzimeve kapitale

Kodi produktit	Projekti/Produkti	Plani vjetor	Plani i rishikuar	Fakti 2025	Diferenca Plan/Fakt	% e realizimit
Projekti Pajisje Administrative		197,830,570	113,931,080	99,863,480	14,067,600	88%
19AA603	Blerje Paisje Zyre	93,293,570	56,106,600	42,039,000	14,067,600	75%
19AA604	Blerje Automjete	35,000,000	24,152,000	24,152,000	-	100%
19AA605	Blerje Paisje Elektronike	60,537,000	33,672,480	33,672,480	-	100%
19AA606	Blerje pajisje operationale dhe te teknikes operative	9,000,000	-	-	-	-
Projekti Ndërtim muri rrethues		2,686,700	2,647,902	2,641,067	6,835	100%
23AB901	Ndërtim muri rrethues	1,850,000	1,850,000	1,843,261	6,739	100%
23AB903	Supervizim lidhur me projektin e murit	136,000	136,000	135,906	94	100%
23AB904	Kolaudim lidhur me projektin e murit	50,000	11,202	11,202	-	100%
23AB905	Shpronësim truall për murin rrethues	650,700	650,700	650,698	2	100%
Projekti Punime rikonstruksioni Godina e re dhe ndërtimi urë komunikuese midis dy godinave:		464,482,730	232,274,078	190,214,248	42,059,830	82%
23AC302	Punime rikonstruksioni Godina e Re dhëndërtimi ure komunikimi midis dy godinave	459,002,730	230,297,629	188,426,023	41,871,606	82%
23AC304	Supervizim	4,680,000	1,976,449	1,788,225	188,224	90%
23AC305	Kolaudim	800,000	-	-	-	-
Projektet e reja		35,000,000	9,680,940	-	9,680,940	0%
24AH801	Panele diellore për prodhim energji elektrike në funksion të institucionit të SPAK	11,000,000	9,680,940	-	9,680,940	0%
24AH901	Kosto për sisteme dhe infrastrukturë TIK (siguria kibernetike)	24,000,000	-	-	-	0%
Total		700,000,000	358,534,000	292,718,795	65,815,205	82%

Si një strukturë ligjzbatuese, SPAK paraqet nevoja specifike infrastrukturore, të cilat përfshijnë ndërtimin dhe rikonstruksionin e ambienteve të sigurta dhe funksionale, pajisjen me teknologji të avancuar për hetimin dhe analizën e të dhënave, si dhe krijimin e sistemeve të integruara për menaxhimin e informacionit dhe bazave të të dhënave. Përdorimi i mjeteve të sofistikuara të përgjimit, analizës së informacionit dhe inteligjencës digjitale është jetik për përmbushjen e misionit të institucionit, ndërsa investimet në sigurinë kibernetike mbeten një prioritet strategjik për garantimin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe të dhënave sensitive.

Me Aktin Normativ nr. 11, datë 19.12.2025, “Për ndryshimin e ligjit nr. 115/2024 Për buxhetin e vitit 2025”, bazuar në deklarin e tepricave të fondeve buxhetore të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është miratuar pakësimi i fondeve buxhetore në shumën 341 milion lekë për zërin përkatës.

Si rrjedhojë, fondet e papërdorura janë evidentuar dhe deklaruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke çuar në rishikimin përkatës të buxhetit dhe në pakësimin e fondeve të miratuara për këtë zë. Një pjesë e pakësimit të fondeve ka ardhur si pasoje e kursimit të fondeve buxhetore si rrjedhojë e zhvillimit të procedurave të prokurimit

Grante Kapitale

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për financimin e dy projekteve, Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka marrë Vendimin nr. 188 datë 09.06.2025 “Mbi financimin e projekteve të SPAK nga Fondi i Posaçëm ” si më poshtë;

- Pajisje teknologjike për qëllime operative – IMSI Catcher”. Çmimi i vlerësuar 1.8 milionë Euro.
- Upgrade i sistemit të përgjimit. (Përmirësim të sistemit në versionin më të fundit MC22, Shtim të modulit IP Data (MPD), Rritje të memories së brendshme (Data Storage). 3.3 milionë Euro

Gjatë vitit 2025, është paraqitur nevoja për shtesë financimi në vlerën 121 milion lekë, me qëllim mbulimin e plotë të TVSH-së për dy projekte me rëndësi të veçantë operative. Kjo shtesë financimi është miratuar me Vendimin e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar nr. 215, datë 06.11.2025.

Projekte të cilat priten të realizohen gjatë vitit 2026.

1.4 Performanca e monitorimit

Gjatë vitit buxhetor 2025 nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar janë kryer monitorimet e performancës financiare të shpenzimeve, analizës së zbatimit të buxhetit çdo 4-mujor/ 8-mujor/ 12-mujor. Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA. Raportet e monitorimit të buxhetit janë publikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar dhe udhëzimin në zbatim të tij, qëndrueshmëria financiare e institucionit dhe ndjekja me rigorozitet e procedurave të menaxhimit financiar publik, kanë udhëhequr veprimtarinë administrative të institucionit në përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njesisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nga analizat e pyetësorëve të vetëvlerësimit dhe kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave, për vitit 2023, u arrit në konkluzionin se sistemi i kontrollit të brendshëm financiar në Prokurorinë e Posaçme funksionon në mënyrë efektive dhe në përputhje me parimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Ky vlerësim pasqyron një nivel të kënaqshëm të zbatimit të procedurave të kontrollit, si dhe një angazhim të strukturave përgjegjëse për forcimin e qeverisjes dhe transparencës financiare.

Zhvillimi i këtij procesi ka pasur një impakt të drejtpërdrejtë dhe pozitiv në përmirësimin e planifikimit, identifikimit dhe dokumentimit të risqeve, duke kontribuar në konsolidimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të strukturuar të menaxhimit të riskut, në funksion të arritjes së objektivave institucionale dhe minimizimit të pasigurive në veprimtarinë financiare.

Gjatë vitit 2025, nuk është ushtruar kontroll nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, ndërkohë që institucionit i është dashur të mbështetet në mekanizmat e brendshëm të kontrollit dhe në vazhdimësinë e praktikave të vendosura më herët, të cilat kanë siguruar funksionimin normal dhe të kontrolluar të proceseve financiare.

2. Prokurimet Publike

Prokurimi publik përbën një nga fushat kryesore të veprimtarisë shtetërore dhe një nga proceset më të rëndësishme në menaxhimin e financave publike. Në këtë kuadër, raporti paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna statistikore dhe analitike lidhur me funksionimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi, përfshirë edhe përdorimin dhe eficiencën e sistemit elektronik të prokurimit.

Spektori i Prokurimeve Publike pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) kryen veprime administrative që konsistojnë në planifikimin, realizimin, ndjekjen dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), udhëzimet përkatëse në zbatim të tyre, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen dhe administrohen në mënyrë elektronike, përmes sistemit të prokurimit elektronik, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, [ëëë.app.gov.al](http://ee.app.gov.al), duke garantuar transparencë, trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe respektimin e parimeve themelore të prokurimit publik.

2.1 Analiza statistikore mbi procedurat e prokurimit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Autoriteti Kontraktor ka zbatuar procedura prokurimi në përputhje me fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, si dhe nga grantet e akorduara (grant nga AAPSK), me qëllim përmbushjen e nevojave funksionale dhe operacionale të institucionit, si dhe garantimin e vijimësisë së veprimtarisë së tij.

Statistikat lidhur me procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 paraqiten sipas ndarjes përkatëse të llogarive ekonomike, në përputhje me planifikimin buxhetor dhe programimin e miratuar për vitin ushtrimor.

Konkretisht, detajimi i elementeve të planifikuara pasqyrohet në Regjistrin e Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit, ku janë parashikuar gjithsej 36 (tridhjetë e gjashtë) procedura prokurimi, nga të cilat:

26 (njëzet e gjashtë) procedura prokurimi për zërin Shpenzime për Mallra dhe Shërbime dhe 11 (njëmbëdhjetë) procedura prokurimi për zërin Investime Kapitale.

Gjatë vitit buxhetor 2025, Regjistri i Parashikimeve ka pësuar ndryshime, të diktuar nga nevojat operative, rishpërndarja e fondeve dhe përditësimi i prioriteteve institucionale. Këto ndryshime janë reflektuar dhe raportuar pranë Degës së Thesarit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2.2 Analiza sipas llojit të procedurës së prokurimit

Bazuar në të dhënat e realizimit për vitin 2025, procedurat e prokurimit janë zhvilluar përmes formave të ndryshme të prokurimit, në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit dhe nevojat specifike të institucionit.

Në këtë kuadër, janë aplikuar:

- procedura me vlerë të vogël, kryesisht për mallra dhe shërbime me vlerë të ulët, të domosdoshme për funksionimin e përditshëm të institucionit;
- procedura të hapura mbi kufirin e lartë monetar, për kontrata me vlerë dhe kompleksitet më të lartë;
- procedura të hapura të thjeshtuara, për blerjen e mallrave dhe shërbimeve standarde;
- procedura me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, të përdorura në raste të veçanta, kryesisht për rinovime licencash dhe shërbime të specializuara teknike;
- minikontrata, të aplikuara kryesisht në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve kuadër;
- procedura përmes Sistemit Dinamik të Blerjes së Biletave, për blerjen e biletave të transportit ajror.

Rezulton se përdorimi i procedurave me vlerë të vogël ka qenë dominues në numër, për shkak të nevojave të shpeshta dhe të vazhdueshme operative, ndërsa procedurat e hapura mbi kufirin e lartë monetar dhe procedurat me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës janë përdorur për kontrata me ndikim të konsiderueshëm buxhetor dhe me karakter teknik të specializuar.

2.3 Analiza sipas statusit të procedurave

Sa i përket statusit të procedurave të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025, rezulton se:

- pjesa më e madhe e procedurave janë **arkivuar**, pasi procesi i prokurimit është përfunduar dhe kontratat përkatëse janë lidhur;
- një numër i kufizuar procedurash rezultojnë të **mbyllura**, kryesisht procedura komplekse me afate shumëvjeçare zbatimi, për të cilat lidhja e kontratës shënon fillimin e fazës së zbatimit afatgjatë.

Ky raportim pasqyron një nivel të lartë realizimi të procedurave të planifikuara brenda vitit buxhetor.

2.4 Procedurat me ndikimin më të lartë financiar

Gjatë vitit 2025, procedurat e prokurimit me peshën më të madhe financiare kanë qenë të përqendruara kryesisht në:

- blerjen e pajisjeve të zyrës;
- blerjen e pajisjeve elektronike, të zhvilluara nëpërmjet procedurave me lote;
- blerjen e automjeteve;
- rinovimin e licencave për pajisjet dhe programet ekzaminuese të Sektorit të Ekspertizës;
- shërbimin për mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë dhe rinovimin e licencave;
- shërbimin për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit;
- blerjen e tonerave dhe shërbimin e internetit.

Këto procedura përbëjnë pjesën më të madhe të angazhimit financiar të institucionit për vitin 2025 dhe kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin e funksionimit normal, sigurisë operacionale dhe përmbushjes së misionit institucional.

2.5 Realizime gjatë vitit 2025 nga Marrëveshjet Kuadër të vitit 2024

Nga Marrëveshjet Kuadër të lidhura gjatë vitit 2024, gjatë vitit 2025 janë realizuar 7 (shtatë) procedura prokurimi, nga të cilat janë lidhur gjithsej 35 (tridhjetë e pese) kontrata/minikontrata, me vlerë totale 22,988,381 lekë me TVSH.

Këto realizime kanë përfshirë kryesisht:

- produkte dhe solucione pastrimi;
- karburante (naftë dhe benzinë);
- materiale kancelarie dhe materiale në funksion të arkivës, protokollit dhe zyrës së regjistrit;
- letër;
- blerje tonera
- shërbime mirëmbajtjeje për mjetet e transportit;
- shërbime mirëmbajtjeje për sistemet e kondicionimit dhe aspirimit.

Zbatimi i këtyre marrëveshjeve ka kontribuar në sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe furnizimeve bazë, si dhe në rritjen e eficiencës së proceseve të prokurimit përmes përdorimit të instrumenteve të konsoliduara kontraktuale.



2.6 Analiza e procedurave të prokurimit për investime kapitale (Ilog. 231)

Për vitin 2025, në kuadër të zërit buxhetor Investime Kapitale (Ilogaria 231), janë planifikuar gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) procedura prokurimi, me një fond total të parashikuar prej 297,589,990 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH. Nga këto procedura, bazuar në nevojat e rishikuara dhe prioritetet institucionale gjatë vitit buxhetor, janë zhvilluar 6 (gjashtë) procedura prokurimi, ndërsa procedurat e tjera nuk janë realizuar për shkak të ndryshimeve në planifikimin e investimeve.

Tabela nr.7: Procedurat e Investimeve kapitale

Përmbledhese Investimet 2025									
Nr	Procedura	Tipi i Kontratës (mall/shërbim)	Fondi i parashikuar pa tvsh	Fondi Limit UP	Operatori Fitues	Kontrata Nr	Kontrata Vlera pa TVSH	Kontrata Vlera Me TVSH	Likuiduar
1	Blerje pajisje zyre	Mall	77,744,641	76,934,441	Ro Al	1	45,189,500	54,227,400	42,039,000
2	Blerje pajisje elektronike	Mall	50,447,500	34,994,417	Atom/Rikon	3	28,060,400	33,672,480	33,672,480
3	Blerje Automjetesh	Mall	29,000,000	27,251,881	Porsh albania	2	22,320,000	24,152,000	24,152,000
4	Blerje pajisje operacionale dhe te teknikes operative (e klasifikuar)	Mall	7,500,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
5	Kolaudim per objektin "Nderim muri rrethues per godinen e re te SPAK"	Mall	41,666	41,666	G & L CONSTRUCTION	1	9,335	11,202	11,202
6	Kolaudim per objektin "Nderim dhe rikonstruksion per godinen e re te SPAK"	shërbim	666,666	procedura nuk eshte zhvilluar					
7	Siguria kibernetike	Shërbim	20,000,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
8	Blerje Panele diellore	Mall	9,166,666	8,067,450	Alb Power & AlbaVia	1	8,011,000	9,613,200	-
9	Shërbim raport auditimi per eficensen e energjise	Shërbim	1,600,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
10	Blerje psjisje dhe sisteme te teknikes operative AAPSK	shërbim	101,072,851	procedura nuk eshte zhvilluar					
11	Blerje F.V dere antipanik duralumin dhe mentesha dritare	Mall	350,000	350,000	EM-EA Construction	1	250,000	300,000	300,000
Total Kontrata 2025			297,589,990	147,639,855	-	9	103,840,235	121,976,282	100,174,682

Struktura e Investimeve Kapitale 2025
(Vlera kontraktuale pa TVSH)



Si rezultat i zhvillimit dhe përfundimit të këtyre procedurave të prokurimit, nga fondi limit i miratuar prej 147,639,855 lekë pa TVSH, janë lidhur gjithsej 9 (nëntë) kontrata, me një vlerë totale kontraktuale prej 103,840,235 lekë pa TVSH.

Diferenca ndërmjet fondit limit dhe vlerës kontraktuale përfundimtare ka sjellë një kursim financiar në vlerën 43,799,620 lekë pa TVSH, ose rreth 29.7% të fondit limit të miratuar, çka dëshmon një përdorim efikas të fondeve publike dhe një proces prokurimi konkurrues, transparent dhe të kontrolluar.

Në aspektin e menaxhimit

financiar, gjatë vitit 2025, për kontratat e nënshkruara është likuiduar shuma 100,174,682 lekë, e cila përfaqëson rreth 80.4% të vlerës totale të kontratave me TVSH. Likuidimet janë kryer kryesisht për kontrata në proces ose të përfunduara, si blerja e pajisjeve të zyrës, blerja e pajisjeve elektronike, blerja e automjeteve, kolaudimi për murin rrethues të godinës së re të SPAK, si dhe blerja e dyerve antipanic.

Në përfundim, prokurimet e realizuara në kuadër të Investimeve Kapitale (llogaria 231) për vitin 2025 karakterizohen nga një planifikim i kujdesshëm, disiplinë buxhetore, respektim i fazave procedurale dhe një menaxhim financiar i përgjegjshëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Zbatimi i procedurave ka mundur realizimin e investimeve prioritare të institucionit, përdorimin efikas të fondeve publike, si dhe sigurimin e transparencës, konkurrencës dhe kontrollit të shpenzimeve, duke garantuar përmbushjen e nevojave funksionale dhe operative brenda kufijve të fondeve të miratuara për vitin buxhetor 2025.

2.7 Analiza e procedurave të prokurimit për shpenzime për mallra dhe shërbime (llogaria 602)


Për vitin 2025, për shpenzime për mallra dhe shërbime, janë parashikuar gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) procedura prokurimi, me një fond total të parashikuar prej 93,050,000 lekë pa TVSH. Nga këto, bazuar në nevojat dhe prioritetet institucionale gjatë vitit buxhetor, janë zhvilluar 22 (njëzet e dy) procedura prokurimi, ndërsa procedurat e tjera nuk janë realizuar për shkak të ndryshimeve në planifikimin dhe rishikimin e nevojave operative.

Tabela nr.8: Procedurat e vitit 2025

Permbledhese Procedura 2025									
Nr	Procedura	Tipi i Kontratës (mall/shërbim)	Fondi i parashikuar ne regjister pa tvsh 2025	Fondi limit UP	Operatori Fitues	Mini Kontrata Nr	Mini Kontrata Vlera pa TVSH	Mini Kontrata Vlera Me TVSH	Likujduar
1	Blerje Materiale Pastrimi	Mall	3,089,389	3,089,462	Besim Kamberi	0	-	-	-
2	Blerje Tonera	Mall	9,575,519	9,575,519	Erison	1	2,999,285	3,599,142	3,599,142
3	Blerje sherbim siguracioni per automjetet e SPAK	Sherbim	1,900,001	1,900,001	Eurosig	9	1,401,254	1,401,254	1,401,254
4	Blerje Sherbime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	Sherbim	377,900	377,900	Auto manoku	1	64,463	77,355	77,355
5	Blerje Sherbime per mirembajtjen e mjeteve te transportit lotet e anuluar	Sherbim	15,864,150	15,864,150	Auto manoku	1	1,211,650	1,453,980	-
6	Blerje Sherbime mirembajtje per njetet e reja qe do blihen	Sherbim	1,641,863	1,608,368	Porche	0	-	-	-
7	Blerje Sherbim Interneti	Sherbim	2,500,000	2,169,166	Vodafone	1	138,000	165,600	138,000
8	Blerje karburant Diesel & Gazoil	Mall	9,999,999	8,780,083	Kastrati	2	2,986,144	3,583,373	3,583,373
9	Blerje kuti dhe dosje arkive per ruajtje te perfershme	Mall	1,000,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
10	Mirembajtje e programit Alfa	Sherbim	99,999	99,999	Devpos/IMB	2	99,999	119,999	119,998
11	Blerje goma dhe bateri	Mall	1,000,000	1,000,000	Besnik Meci/Andi Hamo/Teknolux/GS provider/Marjo Mondit/Goma/Besnik Meci	7	683,300	819,960	819,960
12	Sherbim me qera per centralin telefonik	Sherbim	99,999	99,999	Enetcom	1	79,000	94,800	94,800
13	Sherbim per larje automjete	Sherbim	900,001	900,001	Mara INT	1	378,125	453,750	453,750
14	Sherbime profilaktike për mirëmbajtjen e gjeneratorit	Sherbim	99,999	99,999	AON shpk	1	58,000	69,600	69,600
15	Blerje bileta transporti ajror nderkombetar	Sherbim	1,000,000	1,000,000	Kelvin,Spirit,spirit,2 Feleqi,Globe Travel	5	187,116	187,116	187,116
16	Sherbime per mirembajtjen fotokopje - printer	Sherbim	1,000,000	1,000,000	BNT elektronik	1	990,000	1,188,000	1,188,000
17	Blerje uje i pijshem	Mall	700,000	700,000	Qafshatama	1	626,833	752,200	752,200
18	Blerje Program software ne permbushje te nevojave hetimore	Sherbim	6,000,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
19	Blerje Sherbim rinovimi per celulatet motorola	Sherbim	2,300,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
20	Sherbim per rinovimin e licensave per mirembajtjen e pajisjeve te Sektorit te Ekspertizes	Sherbim	18,000,000	16,461,745	Cellectrite/Insig	2	16,429,603	19,715,523	15,200,000
21	Blerje suvenire ne kuader te takimeve zyrtare	Mall	500,000	500,000	Glama	1	410,000	492,000	492,000
22	Blerje Materiale Pune	Mall	400,000	procedura nuk eshte zhvilluar					
23	Sherbime perkthimi	Sherbim	300,000	300,000	Rezarta Gjyla	1	66,679	66,679	66,679
24	Blerje Mallra konsumi kafe ne kuader te takimeve zyrtare	Mall	500,000	500,000	Klar&coffee/Lefter Bizhga	2	223,917	268,700	268,700
25	Blerje te tjera	Mall	100,000	100,000	Joan Rustemi/Albania motor	2	97,295	116,754	116,754
26	Sherbim për mirëmbajtjen e sistemeve te sigurise	Sherbim	14,100,000	14,062,000	Axians	1	12,818,905	15,382,686	-
26	Total kontrata 2025		93,048,819	80,188,393	-	43	41,949,567	50,008,471	28,628,681

Vlera fituese e procedurave të zhvilluara rezulton në 68,473,600 lekë pa TVSH, çka përfaqëson

Shpërndarja e fondit për Mallra dhe Shërbime – Viti 2025



një ulje prej rreth 26.3% krahasuar me fondin total të parashikuar, si rezultat i konkurrencës në procedurat e prokurimit dhe përdorimit efikas të fondeve publike. Diferenca ndërmjet fondit të parashikuar dhe vlerës së kontraktuar përfaqëson një kursim buxhetor të konsiderueshëm, i cili dëshmon për konkurrencë dhe eficiencë në përdorimin e fondeve publike në kuadër të zërit 602. Si pasojë e këtyre procedurave, janë

nënshkruar 35 (tridhjetë e pesë) kontrata dhe/ose minikontrata, me një vlerë totale prej 50,008,471 lekë me TVSH.

Në aspektin e menaxhimit financiar, gjatë vitit 2025 është likuiduar shuma 28,628,681 lekë, e cila përbën rreth 57% të vlerës totale të kontratave me TVSH. Likuidimet janë kryer për shërbime dhe mallra të realizuara plotësisht, si dhe për minikontratat e nënshkruara, bazuar në nevojat reale dhe prioritetet operative të institucionit, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjet kuadër.

Në përfundim, procedurat e prokurimit të realizuara gjatë vitit 2025 për shpenzime për mallra dhe shërbime (llogaria 602) dëshmojnë një proces të qëndrueshëm planifikimi, zbatim korrekt të kuadrit ligjor dhe një menaxhim financiar të përgjegjshëm. Zhvillimi i shumicës së procedurave të planifikuara, niveli i konsiderueshëm i kursimit buxhetor të arritur, si dhe lidhja e kontratave dhe minikontratave në përputhje me nevojat reale të institucionit, kanë mundësuar përdorimin efikas të fondeve publike dhe sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe furnizimeve të nevojshme për funksionimin e institucionit. Likuidimet e kryera reflektojnë një ndjekje të kujdesshme të zbatimit kontraktual dhe respektim të afateve financiare, duke garantuar transparencë, kontroll dhe disiplinë buxhetore në administrimin e fondeve për vitin buxhetor 2025.

2.8 Ecuria e zbatimit financiar dhe kontraktual për kontratat në kuadër të zërit 602 (kontrata sekrete) gjatë vitit 2025

Për vitin 2025, në kuadër të zërit buxhetor 602 – Mallra dhe Shërbime, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vijuar zbatimin e kontratave të lidhura për periudhat 2024–2026 dhe 2025–2026, të cilat mbulojnë shërbime kritike dhe të specializuara për funksionimin e sistemeve operative, informatike dhe të sigurisë së institucionit.

Në kuadër të kontratës për shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit të përgjimit të Prokurorisë së Posaçme (e klasifikuar), është likuiduar kontrata përkatëse në vlerë 29,700,000 lekë me TVSH.

3. Financa

Spektori i financës ka patur një performancë të qëndrueshme, duke mbështetur operacionet e përgjithshme të institucionit e duke siguruar qëndrueshmëri financiare. Fokusi i kësaj analize 12-

mujore financiare është pasqyrimi i performancës financiare në këndvështrimin e menaxhimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, në evidentimin e shpenzimeve të kryera, menaxhimit të asetëve duke krijuar një panoramë të përgjithshme të rezultateve. Kontrolli i brendshëm financiar i kryer nga sektori i financës ka përfshirë të gjitha aktivitetet që lidhen me të ardhurat, shpenzimet, aktivitetet dhe detyrimeve të institucionit.

3.1 Analiza e shpenzimeve


Gjatë vitit 2025 janë përpiluar dhe regjistruar në sistemin informatik SIFQ (AFMIS):

- 827 Urdhër Shpenzime.
- 18 Urdhër Blerje (vetëm kontrata të lidhura që plotësojnë kriterin e vlerës mbi 1.2 milionë).
- 15 Urdhër Kërkesë Blerje (urdhëra prokurimi për procedura të tenderuara përgjatë 2025).

Për të gjitha transaksionet e sipërpërmendura nuk është konstatuar asnjë vonesë përtej afateve të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit, pavarësisht proceseve të kontrollit, hartimit dhe ekzekutimit të tyre, të cilat janë kryer brenda afateve ligjore.

Nga analiza e likuidimeve të ekzekutuara për shpenzime korrente rezulton se peshën më të madhe e zënë shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemeve të përgjimit dhe të ekspertizës, të ndjekura nga shpenzimet procedurale dhe shpenzimet për shërbime utilitare (energji elektrike, ujë, telefon, internet, etj). Në kuadër të shpenzimeve operative janë kryer gjithashtu shpenzime për blerje materiale të ndryshme kancelarie, materiale pastrimi, karburant, shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, si dhe shpenzime për mirëmbajtjen e godinës.

Grafik nr. 4: Peshë që zënë shpenzimet operative sipas llojit të tyre.




Në zbatim të Programit të Udhëtimeve dhe Vizitave të Punës, në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale të Institucionit, gjatë vitit 2025 janë trajtuar financiarisht 36 programe udhëtimi në monedhën euro, në vlerën totale prej 11,153 Euro.

Shpenzimet operative të mbuluara nga financimet e EUROJUST lidhen me shpenzime procedurale që kanë të bëjnë me çështje të skuadrave të përbashkëta hetimore. EUROJUST rimburson deri në 95% të shpenzimeve të kryera në kuadër të këtyre procedimeve penale, kryesisht për shërbime përkthimi të akteve, akomodim dhe udhëtim.


Në përmbledhje grafike sipas peshës që zënë në totalin e zërit për investime, vërehet se shpenzimet për rikonstruksionin e godinës së re të SPAK zënë peshën më të madhe, rreth 66%.

Grafik nr. 5: Peshë që zënë shpenzimet kapitale sipas llojit të tyre.



Nga grafiku vërehet se shpenzimet për rikonstruksionin e godinës së re të SPAK zënë peshën më të madhe rreth 66%.

Grafiku nr. 6: Tendencë e shpenzimeve operative dhe investimeve të vitit kalendarik:



Nga shqyrtimi i ecures së shpenzimeve korrente dhe kapitale për periudhën janar-dhjetor 2025, ato rezultojnë të jenë në nivelin më të ulët në muajin janar dhe shtator me 4.4% dhe në nivelin më të lartë në muajin dhjetor me 30% të totalit.

3.2 Analiza e të ardhurave

Burimet kryesore të të ardhurave ndahen në tre kategori:

- Të ardhurat e realizuara nga Institucioni** – përfshijnë kryesisht tarifat për shpenzimet procedurale (fotokopje, skanime, CD, gjoba gjyqësore), bazuar në Udhëzimin e Prokurorisë së Posaçme Nr. 613, datë 15.09.2023 “Për shpenzimet procedurale të Prokurorisë”. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit në përfundim të vitit.
- Të ardhurat nga Grante** – përbëhen nga fonde të siguruar nga AAPSK, të destinuar për investime në funksion të Institucionit, si dhe fonde nga EUROJUST për kompensimin e shpenzimeve operative lidhur me çështje të skuadrave të përbashkëta hetimore.
- Të ardhurat nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit** – të ardhura mbi ekzekutimet e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore.

Tabela nr.9: Për vitin 2025 të ardhurat e realizuara

Kodi institucionit	Llogaria ekonomike	Përshkrimi i të Ardhurave	Shuma e arkëtuar progresive	Derdhur në buxhet
1041001	7111008	Të ardhura nga fotokopje	925,403	925,403
	7115401	Gjoha gjyqësore	971,948	971,948
	7115600	Sekuestre dhe zhdëmtime	-	-
	7190990	Të tjera jo tatimore	174,360	174,360
	7207011	Sponsor nga subjekte shtetërore ose publike	-	-
	7211100	Grante nga organizata ndërkombëtare	664,205	-
Totali			2,735,916	2,071,711

3.3 Aktive nga donatorë të huaj

Gjatë vitit 2025, në kuadër të bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë, Institucioni ka përfituar asete të dhuruara nga organizata të ndryshme, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e sistemeve dhe pajisjeve IT. Konkretisht, këtë vit janë pranuar akt-dhurime nga EU4LEA, OSCE dhe National Crime Agency. Këto donacione kanë sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në kapacitetin operacional të Institucionit. Ky bashkëpunim i vazhdueshëm demonstroi rëndësinë e partneriteteve strategjike për avancimin e kapaciteteve të Institucionit pa rritur shpenzimet nga buxheti i shtetit.

Tabela nr.10: Donacionet e huaja

Nr	Donatori	Lloji i donacionit	Vlera e dhuruar në lekë
1	EU4LEA	Software/Licensa informatike	3,513,391
2	OSCE	Paisje Elektronike(Laptopë)	2,838,516
3	OSCE	Printer portabël	1,078,678
4	National Crime Agency	Paisje Elektronike(Laptopë& printer portabël)	9,348,752
5	National Crime Agency	Paisje Elektronike(Workstation)	1,107,808
Totali i donacioneve			17,887,145

4.Plani Vjetor viti 2026-2028

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili pasqyron shpërndarjen e burimeve buxhetore për një periudhë trevjeçare, në përputhje me rregullat, procedurat dhe afatet e përcaktuara në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka qenë e angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në administrimin dhe hartimin e kërkesave buxhetore. Janë përgatitur dhe paraqitur Raportet e Programit Buxhetor Afatmesëm për të tre fazat e procesit, përkatësisht fazën strategjike, fazën teknike dhe fazën përfundimtare, në përputhje me tavanet buxhetore të miratuara. Ky proces është realizuar nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP), duke garantuar koherencë ndërmjet dokumentacionit shoqërues dhe të dhënave elektronike, si dhe rritjen e transparencës.

4.1 Analiza e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028

Në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të institucionit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në fuqi për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028, janë hartuar kërkesat buxhetore për politikat ekzistuese dhe politikat e reja të planifikuara.

Me ligjin nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, buxheti i miratuar për Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) është në vlerën 2,116 milion lekë. Ky buxhet është ndarë sipas zërave buxhetorë, në funksion të mbulimit të shpenzimeve korrente dhe

kapitale, si dhe të financimit të programeve buxhetore, duke reflektuar prioritetet institucionale dhe nevojat operacionale për vitin 2026.

Tabela nr.11: Struktura e programit “Veprimtaria SPAK” për vitin 2026-2028

000/lekë

Art.	Emërtimi	Plani i miratuar Vjetor 2026	Struktura e shpenzimeve	Plani i miratuar Vjetor 2027	Struktura e shpenzimeve	Plani i miratuar Vjetor 2028	Struktura e shpenzimeve
1	2	3		4		5	
600	Paga	1,405,496	66%	1,408,200	67%	1,415,800	67%
601	Sigurime Shoqërore	163,000	8%	164,000	8%	165,000	8%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	328,117	16%	330,103	16%	330,065	16%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ						
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	1,896,613	90%	1,902,303	90%	1,910,865	90%
231	Kapitale të Trupëzuara	220,000	10%	210,000	10%	210,000	10%
Nën -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	220,000	10%	210,000	10%	210,000	10%
Totali (korrente + kapitale)		2,116,613	100%	2,112,303.0	100%	2,120,865	100%

Në tabelën mësipërm është kryer shpërndarja sipas llogarive ekonomike për vitet 2026-2028. Sic vërehet plani vjetor i miratuar në vitin 2026 është në shumën totale 2,116 milionë lekë.

- Shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve janë planifikuar në vlerën rreth 1,568 milionë lekë, ose 74% të buxhetit të miratuar për vitin përkatës. Ky nivel shpenzimesh është përcaktuar në përputhje me strukturën e miratuar organizative për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Në strukturën e personelit përfshihen kategori me përgjegjësi dhe ngarkesë të lartë pune, si magjistratë, hetues financiarë, hetues të BKH-së dhe ekspertë, për të cilët natyra e veçantë e funksioneve hetimore kërkon angazhim të vazhdueshëm profesional, shpesh edhe përtej orarit zyrtar të punës.

- Shpenzimet operative janë planifikuar në vlerën rreth 328 milionë lekë, ose afërsisht 16% të buxhetit të miratuar për vitin 2026.

Për periudhën afatmesme 2026–2028, parashikohet një rritje graduale e shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve mbështetëse për këto sisteme. Shpenzimet operative mbulojnë, ndër të tjera, shërbime teknike, logjistike, mbështetëse dhe administrative, të cilat janë thelbësore për funksionimin normal të strukturave hetimore dhe mbështetëse.

Siç është trajtuar edhe në analizën e treguesve të realizuar për vitin 2025, SPAK, për shkak të natyrës së veçantë të punës, disponon teknologji të specializuar dhe sisteme IT të avancuara, të cilat funksionojnë brenda ambienteve të institucionit dhe kërkojnë operim të pandërprerë. Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe periodike e këtyre sistemeve është një domosdoshmëri për garantimin e funksionalitetit, sigurisë dhe integritetit të të dhënave, si dhe për shmangien e risqeve të dëmtimeve teknike apo ndërprerjeve në proceset hetimore.

- Shpenzimet për investime kapitale janë planifikuar në vlerën 220 milionë lekë, ose rreth 10% të buxhetit të miratuar. Këto fonde janë parashikuar për mbështetjen e nevojave prioritare të institucionit, në veçanti në kushtet e emergjencës për përshtatjen e godinës së re në funksion të kërkesave operative dhe organizative të Strukturs së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).

Në këtë kuadër, fondet e parashikuara për investime kapitale do të përdoren për realizimin e investimeve në punime ndërtimi dhe rikonstruksioni për godinën e re, instalime teknike dhe infrastrukture, pajisje elektronike dhe zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit (IT).

5. Ndryshimet në Buxhetin e vitit 2025

Për vitin 2025, rrjedhojë e ndryshimeve të akteve ligjore/nënligjore, i referohemi;

- Me shkresën nr. 3067/1, datë 19.02.2025 në zërin shpenzime korrente si rezultat i detajimit të fondit të veçantë është miratuar vlera prej 350 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 6054/1, datë 14.04.2025 si rezultat i kërkesës shtesë të fondit të veçantë është miratuar vlera e shtuar prej 649 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 42995, datë 16.12.2025 si rezultat i kërkesës shtesë të fondit të veçantë është miratuar vlera e shtuar prej 1,112 milionë lekë.
- Me aktin normative Nr. 6, datë 11.06.2025 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”* janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 20 milionë lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Qershor.
- Me aktin normative Nr. 10, datë 08.10.2025 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”* janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 466 milionë lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Tetor.
- Me aktin normative Nr. 11, datë 19.12.2025 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”* janë reflektuar ndryshime në buxhet, konkretisht pakësime në zërat buxhetor me vlerë totale 405 milionë lekë. Detajimet përkatëse janë reflektuar në muajin Dhjetor.